

DITURIA ISLAME

REVISTE MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE • Nr. 403 • QERSHOR 2024



HAXHI DHE FRYMA E UNITETIT
E ASPIRUAR TE MYSLIMANËT

KURBANI – URTËSITË
DHE DISPOZITAT E TIJ

REAGIMET E SUNDIMTARËVE NDAJ
LETRAVE TË PEJGAMBERIT MUHAMED A.S.

DUAJA MË E MIRË NË DITËN E ARAFATIT

I dërguari i Allahut, Muhamedi, a.s., ka thënë:

“Lutja më e mirë është lutja që bëhet në ditën e Arafatit, dhe lutja më e mirë që e kam thënë unë dhe profetët para meje është:

**La ilahe il-la Allahu vahdehu la sherike lehu, lehul-mulku
ve lehul-hamdu ve huve ala kul-li shejin kadiir”.**

“Nuk ka Zot tjetër që meriton adhurime përveç Allahut, i Vetmi që nuk ka ortak, atij i takon sundimi i plotë dhe Atij i takon hamdi (Falënderimi, Lavdërimi) dhe Ai është i plotfuqishëm për çdo gjë”.



EDITORIAL

- 4 "Lamtumira" e paharruar nga Arafati

FETARE

- 5 Kaptina Ihlas – atributet e Zotit
Dr. Valmire Batatina – Krasniqi

- 8 Haxhi dhe fryma e unitetit e aspiruar te myslimanët
Ervin Qylafku

- 12 Ihrami, nocioni dhe normat e tij
Dr. Muhamed Stublla

- 16 Vaxhibet dhe lehtësimet e tolerueshme të haxhit
Nehat Shehu

- 19 Vizito vendet ku shërohen plagët
Hfz. Emine Sopi

- 22 Vështrim i shkurtër i librave të veçantë të haxhit në medhhebin hanefi
Mr. Hazir Selmani

- 26 Kurbani – urtësitë dhe dispozitat e tij
Mr. Ekrem Maqedonci

- 29 Pejgamberi ynë, alejhi selam – ky frymëzues i botës mbarë
Mr. Besim Krasniqi

- 31 Trëndafil - i dashuri i zemrave
Artan Sadiku



KULTURË

- 33 Festimi i festave islame te shqiptarët
Besar Thaqi

- 35 Arabizmat në përkthimin e Kuranit famëlartë
Mulaim Shehu

INTERVISTË

- 39 "Ëndrra ime më e madhe është të bëhem hafëze..."

FAMILJE & EDUKIM

- 41 Dhuna në familje dhe interpretimet boshe rreth kësaj problematike
Emine A. Vezaj – Ciroka

HISTORI

- 44 Reagimet e sundimtarëve ndaj letrave të Pejgamberit Muhamed a.s.
Mimoza Sinani


- 48 Plani për organizimin ushtarak të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit
Msc. Drin Aliu

PERSONALITETE

- 50 Abdumexhid ez Zindani
Mr. Arton Musliu

AKTIVITETE

- 58 Fakulteti i Studimeve Islame promovoi programin e ri "Akademia – Studime Islame dhe Lidership"



DITURIA ISLAME

Revistë mujore fetare, shkencore e kulturore

Nr. 403 • viti 37 • Qershor 2024
• Dhul-Ka'de 1- Dhul-Hixhe 1445
• çmimi 1 €

Boton

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë

Redaksia

Kryeredaktor: Mr. Driton Arifi
Anëtarë:
Dr. Ejup Haziri, Merita Boroci,
Mr. Muharrem Tërnavë,
Mr. Vedat Shabani.

Sekretar & lektor: Bajram Zeqiri
Redaktor artistik & teknik:
Bashkim Mehani

Adresa

"Dituria Islame",
rr. "Bajram Kelmendi" nr. 182,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +384 38 224 024
E-mail: redaksia@dituriaislame.net
www.dituriaislame.net

Shtypi:
"IliriPrint", Prishtinë



*“Me të vërtetë gjaku
juaj, pasuria juaj
janë të shenjta për ju,
derisa të takoheni me
Krijuesin tuaj, ashtu
siç është e shenjtë kjo
ditë në këtë muaj dhe
në këtë vend.”*

(Muhamedi, a.s.)

“Lamtumira” e paharruar nga Arafati

Po të shikohen deklaratat më të fuqishme dhe fjalimet më të famshme që kanë mbajtur liderët botërorë, gjithandej nëpër botë, dhe atë gjatë gjithë historisë njerëzore, doemos se do të vërehen pashmangshëm nuancat individualiste dhe tendencat për përvetësim të vlerave e attributeve glorifikuese nga ana e tyre. Të to do të gjejmë edhe dëshirën e flaktë për protagonizëm, dhe eventualisht intencën për arsyetim të gabimeve, sado fatale që kanë qenë ato gjatë rrugëtimit jetësor të tyre.

Dallim esencial në këtë rrafsh ka shënuar i Dërguari ynë i fundit, Muhamedi a.s., i cili në fjalimin e tij lamtumirës, në haxhin e tij të vetëm të jetës të vitit të 10-të h., në kodrën e Arafatit, zgjodhi porosi universaliste, humane, si dhe përjetësuese të parimeve të larta morale. Ai, në asnjë porosi të atij fjalimi nuk shfaqti ndonjë brengosje e as shqetësim për fatin e tij personal, të ardhmen e vet, apo për ndonjë nga familjarët a të afërmit e tij. Këto ishin brenga liderësh e njerëzish të rëndomtë, e ai nuk ishte i tillë. Ai ishte lajmëtari dhe Pejgamberi i fundit i Zotit në tokë, andaj s’mund të ishte si të gjithë të tjerët.

Edhe pse gjendej përballë njerëzve që i kishin besuar, në disa prej thirrjeve të tij fisnike iu drejtua atyre me thirrjen: “O ju besimtarë!”, e në disa prej porosive, iu drejtohej me thirrjen: “O ju njerëz!”, sikur për të rrëfyer se ai nuk u fliste vetëm ithtarëve apo pasuesëve besnikë të tij. Ai, nga kodra e Arafatit, në fqinjësi të Shtëpisë së Shenjtë – Qabesë, i fliste njerëzimit mbarë, pa dallim race, gjuhe, kombi a etnie. Në këto mesazhe sikur vërtetonte maksimën kuranore: “E Ne të dërguam ty (Muhamedi) vetëm si mëshirë për mbarë borërat – të gjitha krijesat.” (El Enbija, 107).

Nga aty, Muhamedi a.s., rikonfirmoi shenjtërinë e jetës, gjakut, pasurisë e dinjitetit të njeriut, kur tha: “O ju njerëz! Frikësojuni Allahut dhe respektojeni Atë. Bëhuni të njerëzishëm e të drejtë ndaj vetës e ndaj të tjerëve... Me të vërtetë gjaku juaj, pasuria juaj janë të shenjta për ju, derisa të takoheni me Krijuesin tuaj, ashtu siç është e shenjtë kjo ditë në këtë muaj dhe në këtë vend.”

Aty i shpalli luftë pa kompromis pabesisë, mashtrimit, dhunës, injorancës dhe traditave të epokës së errët, që për shekuj me radhë kishin ngulfatur njerëzimin dhe e kishin fundosur çdo parim të humanizmit. Më qartësisht s’do mund të glorifikoheshin as raportet ndërbashkëshortore se me fjalët e tij ku tha: “Besnikërisht përmbushni detyrat dhe silluni mirë me bashkëshortet tuaja.”

Asnjëra prej porosive të atij fjalimi nuk është vjetërsuar, as nuk ka humbur vlerën që kishte dikur, ani pse kanë kaluar mbi 14 shekuj që kur ato u janë drejtuar njerëzimit.

Siç do të thoshte edhe njëri nga dijetarët bashkëkohorë: “Fjalimi – hytbeja lamtumirëse, të cilën e mbajti i Dërguari i fundit, Muhamedi a.s. në haxhin e tij të jetës, llogaritet dokumenti më madhështor nëpërmes të cilit janë vendosur themelet e shoqërisë islame të porsaformuar. Ato porosi mbesin si një fanar ndriçues, nga shkëndijat e të cilit do të ndriçohen myslimanët në paqe e në luftë. Prej aty, njerëzit do t’i merrnin vlerat e larta morale dhe parimet e sjelljeve ideale. Ajo deklaratë mbetet e skajshme në elokuencën e saj dhe përmbledhëse e principeve të shëndosha juridike, politike, ekonomike, familjare, morale dhe rregulluese e të gjitha raporteve ndërnjerëzore.”

I Dërguari a.s. nuk jetoi gjatë pas këtij fjalimi historik e pas asaj “lamtumirë” të paharruar. Tre muaj më pas ai, ia dorëzoi shpirtin e tij të dëlirë Zotit të vet, duke shkuar tek Ai i qetë se e kishte përmbyllur e përmbushur misionin me të cilin ishte ngarkuar. Kaloi nga kjo botë, vetëm pasi la shembullin e papërsëritshëm të një njeriu që tërë veprat, fjalimet madje dhe heshtjet e tij ia dedikoi fisnikërimit të njeriut, mirëqenies dhe paqes së tij në dy botët.

Kaptina Ihlas

– atributet e Zotit

Dr. Valmire Batatina – Krasniqi

Gjatë historisë njerëzore, popuj të ndryshëm ndoqën forma të llojllojshme të besimit dhe adhurimit ndaj Zotit. Disa prej tyre e besuan Atë duke e përngjasuar me gjëra të tjera në gjithësi, si me gurë, drurë, diell dhe krijesa të tjera ekzistuese; disa të tjerë duke ia përshkruar Atij atributet e njeriut; e disa të tjerë shkuan aq larg duke e përshkruar si një gjallesë të jashtëzakonshme. Ndërsa Islami, porositi që të besohet Zoti Një, Krijues i kësaj gjithësie, Zot të cilit i nënshtrohet çdo gjë në gjithësi, cilësitë e të Cilit janë të përhershme, pa fillim dhe pa mbarim, janë të pa zhdukura, kurse cilësitë e njerëzve janë të krijuara sikurse edhe vetë ata. Pra është Ai që nuk i përngjan askujt dhe askush nuk i përngjan Atij. Kjo është forma e duhur dhe e drejtë e besimit ndaj Krijuesit dhe në këtë mënyrë të besimit, kishin thirrur të gjithë pejgamberët, duke filluar nga Ademi a.s., e deri te Muhamedi a.s.. Një ndër kaptinat kuranore, e ndërthurur me shprehje tejet koncize dhe të mrekullueshme, që përshkruan cilësitë e larta të Zotit Një, është edhe kaptina El Ihlas, kaptinë kjo e zbritur në Meke¹ dhe e cila përbëhet vetëm nga katër ajete.

EMËRTIMI DHE SHKAKU I ZBRITJES SË KAPTINËS IHLAS

Kjo kaptinë është emërtuar me disa emra si: “Suretu’l-Ihlasi” – kaptina e pastërtisë, e të kulluarit, e sinqeritetit, e thjeshtësisë, ngase kjo kaptinë pastron besimin prej gjërave të kota, kullon bindjet prej kotësive (ose besëtytnive), thjeshtëson besimin e drejtë prej ngatërresave të futura nga injorantët, ndihmon drejt një besimi të sinqertë ndaj Atij që e meriton. Edhe pse ky emërtim është më i njohuri, mufesiri Razi, rendit njëzet emra të tjerë të saj dhe thekson se të gjithë ata për nga kuptimi janë në përpjesëtim me karakterin dhe përmbajtjen e kaptinës. Andaj kjo kaptinë njihet edhe si “Surja e Teuhidit (kaptina e monoteizmit)”, “Surja e Tefridit” (kaptina e njëshmërisë), “Surja e Texhridit” (kaptina e

veçimit), “Surja e Nexhatit” (kaptina e shpëtimit), “Surja e Uelajetit” (kaptina e autoritetit), “Surja e Ma’rifetit” (kaptina e njohjes).² Po ashtu kjo kaptinë njihet si “Surja Samed” dhe “Surja Muauidh”³, “Surja Mani’a” (ndalesë, mburojë), “Surja Nur” (kaptina dritë), kurse së bashku me kaptinën Kafirun, për shkak se të dyja vërtetojnë monoteizmin dhe mohojnë çdo formë të politeizmit janë emërtuar të dyja si “**suret Ihlasajn**”.⁴

Sa i përket sebebi nuzulit – shkakut të zbritjes së kësaj kaptine, transmetohet se disa idhujtarë e pyetën Pejgamberin a.s., duke i thënë: “O Muhamed, na trego prej çka është ai Zoti yt, a është prej ari, argjendi, diamanti etj.?” Atëherë si përgjigje u shpall kjo kaptinë, ku u përshkruan cilësitë e Zotit të Madhëruar, duke thënë se Allahu është Një, nuk ka të dytë, është i vetmi, nuk ka shok, është Një i Vetmi Sundues. Allahu është caku, synimi, qëllimi i çdo krijese, sepse çdo krijesë ka nevojë për Të, kurse Ai nuk ka nevojë për asgjë. Allahu nuk pati fëmijë, sepse fëmijët do të duhej të kenë cilësi të babait, e Ai është i Përhjetshëm, pa fillim dhe pa mbarim. Uzejri nuk ishte djalë i Tij, sikurse thanë jehuditë, e as Isai, siç thanë të krishterët, po as engjëjt nuk janë bija të Zotit, siç menduan disa idhujtarë.⁵



Sipas Muhamed Abduhu, nuk ishte e nevojshme që dikush ta pyeste të Dërguarin a.s., për origjinën dhe përshkrimin e Zotit e që kjo kaptinë të shpallej si përgjigje ndaj tyre, porse gjendja e popullit arab dhe e mbarë njerëzimit, vetvetiu solli deri te misioni i të Dërguarit të Allahut a.s. dhe në shpalljen e një kaptine si kjo për t'i thirrur edhe mushrikët edhe ithtarët e librit (hebrenjtë, krishterët) të besojnë në një Zot, po ashtu edhe t'ua definojë nocionin e Zotit në mënyrë sa më të shkurtër dhe më të qartë.⁶

LIDHMËRIA E KËSAJ KAPTINE ME KAPTINAT E TJERA

Kjo kaptinë për nga përmbajtja ka një lidhmëri të ngushtë me katër kaptinat kuranore, që zënë vend para saj në renditjen kuranore: Mesed, Nasr, Kafirun dhe Keuther. Duke u nisur nga fakti se në kaptinën Keuther qortohen politeistët ngase përçmonin të Dërguarin e Zotit kur i vdisnin djemtë – me urtësinë e Zotit të Madhërishëm – duke thënë se ai ishte farë e sosur, në kaptinën Ihlas ata qortohen për atribuimin e fëmijëve që ia bënë Zotit të Lartësuar.⁷ Përveç kësaj, përderisa në kaptinën Kafirun flitet për shpëtimin e çdo lloj lidhjeje mes atyre që adhurojnë idhuj dhe besimtarëve që adhurojnë të vetmin Zot Krijues, në kaptinën Nasr, shprehet shpëtimi i besimtarëve nga kjo gjendje poshtëruese dhe përgëzimin për Pejgamberin a.s., se do ta çlirojë Mekën dhe në kaptinën Mesed, lajmërimi dhe përgëzimi i besimtarëve me vërtetimin se armiku më i ashpër i Islamit, Ebu Lehebi dhe bashkëshortja e tij e cila bartte fjalë, bënte intriga dhe bartte ferra dhe i hidhte në rrugën nga kalonte Pejgamberi a.s., do të jenë banues të zjarrit, në renditjen kuranore zë vend kaptina Ihlas, e cila konsiderohet esenca e teuhidit që shpie në shpëtim,⁸ duke plotësuar kështu kuptimin e këtyre kaptinave në mënyrë të mrekullueshme.

ATRIBUTET E ZOTIT TË PËRMENDURA NË KËTË KAPTINË

Kaptina Ihlas i adresohet Pejgamberit a.s., si mesazh për gjithë njerëzimin me frazën: “Thuaj: Ai, Allahu është Një!” duke dëshmuar kështu faktin që Allahu i Lartësuar me emrat, veçoritë dhe atributet e Tij është një, pa shok dhe i pazëvendësueshëm. Prandaj adhurimi i përket vetëm Atij dhe asgjëje tjetër. Pra në çdo formë dhe mënyrë Allahu është Një dhe i Vetëm, Ai është dhe do të jetë, dhe me të nuk

ka dhe sdo të ketë asgjë. Mufesiri Razi, gjatë interpretimit të këtij ajeti kuranor, thekson se çdo gjë që ekziston ia detyron ekzistencën Allahut të Madhërishëm, ngase ekzistenca e çdo gjëje varet nga vullneti i Tij. Ai është që krijoi ata dhe përfundimi i tyre është në kompetencën e Tij, pra Ai është burimi i vetëm i vetëmjaftueshëm i të gjitha qenieve. Me fjalë të tjera, gjithçka në univers ndodh brenda kornizës së rregullave të vendosura prej Tij. Prandaj, universi mbijeton falë atributit të Tij të “Kajjunit”.⁹

Sa i përket shprehjes “Ehad” ka kuptimin “Një, i Vetëm” e që është atribut i përhershëm i Zotit xh.sh.. Sado që duket sikur emri **Ehad** (Një i vetëm) mbart të njëjtin kuptim me emrin **Uahid** (një), në mes tyre ekziston një nuancë e imtë ndryshimi në kuptim. Fjala “**Ehad**” është shprehje më e fuqishme elokuede e njëshmërisë. Kurse fjala Uahid mund të mbartë kuptim relativ si dhe konvencional, po ashtu ka një kuptim numerik. Fjala “Ehad”, nuk pranon ndarjen nga të qenët një në asnjë formë, si një i vërtetë që në asnjë mënyrë nuk lë mundësinë e të qenët dy ose një të dyti, pra është gjithherë një.¹⁰ Si rrjedhojë, Ai është Krijuesi, natyrën e plotë të të Cilit gjuha është e mangët që ta përshkruajë dhe mendja e paaftë ta perceptojë.

Ky është një ajet madhështor i Kuranit të ndershëm për shkak të përmbajtjes së tij prej çështjeve madhështore dhe attributeve të larta të Allahut të Madhëruar, si dhe paraqitjes mbi adhurimin dhe reflektimin mbi konceptin e Zotit në besimin islam. Njashtu thekson faktin që Allahu nuk është i të njëjtit lloj me ato që Ai ka krijuar, prandaj Ai qëndron përtej të gjitha përfytyrimeve njerëzore rreth Tij. Prandaj Ai nuk ka shokë, asgjë nuk i ngjason Atij, Ai as nuk lind e as nuk ka lindur prej ndokujt. Asgjë, qoftë lëndë, hapësirë ose kohë, nuk mund ta kufizojë ose ta pengojë Atë. Kjo është arsyeja përse cilësitë e Tij absolute qëndrojnë përtej gjithçkaje që njeriu mund ta perceptojë.

Dhe nga veçimi i Tij i plotë me këto cilësi është edhe ajo se Ai është “Es Samed”, Ai i Cili duhet të jetë caku, synimi, qëllimi i çdo krijese, sepse çdo krijesë ka nevojë për Të, kurse Ai nuk ka nevojë për asgjë: “Allahu është Ai, që çdo krijesë i drejtohet (i mbështetet) për çdo nevojë.” Zoti Absolut dhe Madhështor, që nuk ka mbetur ndonjë cilësi përsosmërie veçse Ai është përshkruar me të, madje me gradën më të lartë të asaj cilësie dhe me kulmin e saj. Krijesat nuk mund të imagjinojnë

Kaptina Ihlas i adresohet Pejgamberit a.s., si mesazh për gjithë njerëzimin me frazën: “Thuaj: Ai, Allahu është Një!” duke dëshmuar kështu faktin që Allahu i Lartësuar me emrat, veçoritë dhe atributet e Tij është një, pa shok dhe i pazëvendësueshëm. Prandaj adhurimi i përket vetëm Atij dhe asgjëje tjetër.

dot asnjë pjesë të Cilësive të Tij të Larta dhe, nuk mund t'i përshkruajnë dot ato me gjuhët e tyre. Prandaj të gjitha krijesat janë nevojtare për Të, për ardhjen e tyre në ekzistencë, për rregullimin e jetës së tyre dhe për vazhdimësinë e saj dhe i drejtohen për çdo nevojë, kërkesë, gjendje dhe vështirësi: “Atij i drejtohet me lutje kush është në qiej e në tokë, dhe Ai në çdo moment është i angazhuar në çështje të reja.”¹¹ Ibën Kethir në interpretimin e këtij ajeti kuranor shton se Atij i përgjërohet gjithçka në amshim, tek Ai përfundon Zotërimi i gjithçkaje.¹²

Në këtë kaptinë madhështore vazhdohet me sqarimin se Zoti xh.sh. nuk ka nevojë për asgjë dhe se çdo gjë ka nevojë për Të kur thuhet se: “As s’ka lindur kënd, as nuk është i lindur.” Pra përmes aludimit (kinaje), theksohet se Zoti nuk është origjinë (prind) dhe as anëtar (fëmijë/vajzë-djalë) që rrjedh nga ndonjë origjinë.¹³ Ai është i Përjetshëm, pa fillim dhe pa mbarim. Allahu nuk është as baba e nënë që lind dhe as fëmijë i lindur. Sepse krijesat janë të lindura prej njëra-tjetrës, dhe njëra është prind dhe tjetra e lindur, dhe çdo krijesë është krijuar prej një lënde, ndërsa Zoti i Lartmadhëruar është i Pastër nga përngjasimi me ta në këtë aspekt, ashtu siç është i pastër nga përngjasimi me krijesat edhe në çdo cilësi tjetër. Allahu i Lartësuar thotë: *Ata thonë: “I Gjithëmëshirshmi ka një bir”. Keni thënë diçka vërtet të tmerrshme! Qiejt gati sa nuk copëtohen prej kësaj; Toka gati sa shqahet e malet sa s’rëzohen të thërrmuara, ngaqë ata i veshin një bir të Gjithëmëshirshmit. Kurrë nuk i shkon (madhërisë së) të Gjithëmëshirshmit të ketë një bir. S’ka krijesë që gjendet në qiej dhe në Tokë e që të mos vijë si rob para të Gjithëmëshirshmit. Sigurisht që Ai e njeh mirë gjithsecilin prej tyre dhe i ka numëruar të gjithë saktësisht. Çdonjëri prej tyre, në Ditën e Kiametit, do të dalë fill i vetëm para Tij.”*¹⁴

Njëkohësisht ky ajat hedh poshtë pretendimet e shtrembëruara të hebrenjve: “E jehuditë thanë: Uzejri është djali i Allahut.”¹⁵, të krishterëve: “E të krishterët thanë: Mesihu është djalë i Allahut.”¹⁶ dhe të politeistëve të Mekës: “Ata i përshkruajnë Allahut vajza.”¹⁷ të cilët i përshkruan Zotit diçka që nuk i përkon. Në këtë kontekst në një hadith kudsij thuhet se Profeti a.s. ka thënë: “Allahu i Lartësuar ka thënë: “Më përgënjeshtroi biri i Ademit dhe nuk i takonte ta bënte këtë. Më ofendoi biri i Ademit dhe nuk i takonte ta bënte këtë. Sa i përket përgënjeshtërimit, është fjala e tij: Zoti nuk do më

Zoti i Madhërishëm e përkreu këtë pastrim duke mohuar të gjitha llojet e politeizmit dhe mosbesimit me fjalët: “Dhe Atij askush nuk i është i barabartë.” Pra as në emrat e Tij, as në cilësitë e Tij, as në veprat e Tij e as në të gjitha të drejtat e Tij absolute me të cilat Ai është veçuar nuk ka të ngjashëm, as shembull, e as të barabartë

kthejë (ringjallë) ashtu siç isha më parë dhe se rikthimi (i krijimit) nuk është më i lehtë për Mua se fillimi i tij. Sa i përket ofendimit, qëndron te fjala e tij: Allahu ka fëmijë, ndërkohë që unë jam Allahu, Një dhe i Vetëm! Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim. Ai as nuk lind, as nuk është i lindur. Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Atë!”¹⁸

Zoti i Madhërishëm e përkreu këtë pastrim duke mohuar të gjitha llojet e politeizmit dhe mosbesimit me fjalët: “Dhe Atij askush nuk i është i barabartë.” Pra as në emrat e Tij, as në cilësitë e Tij, as në veprat e Tij e as në të gjitha të drejtat e Tij absolute me të cilat Ai është veçuar nuk ka të ngjashëm, as shembull, e as të barabartë siç pretendonin politeistët kurejshë me adhurimin e idhujve.¹⁹ Ky ajat thekson ndryshimin absolut midis Krijuesit dhe krijesave. Në shenjë të përlësisë dhe ndjenjës së varësisë para Krijuesit të tyre, besimtarët duhet të shprehin përkushtimin e tyre ndaj Zotit me besim të thellë në mëshirën dhe fuqinë e Tij absolute. Prandaj një kaptinë si kjo me përmbledhje madhështore dhe koncize padyshim që mund të llogaritet me një të tretën e Kuranit, ngase të gjithë emrat e bukur të Allahut dhe cilësitë e Tij të larta të përmendura nëpër kaptinat e tjera në Kuran janë shtjellim më i gjerë i emrave dhe cilësive të përmendura në këtë kaptinë. Me një sqarim të saktë të konceptit dhe attributeve të Zotit në besimin Islam, kjo kaptinë vërteton pasaktësinë e perceptimit të Zotit në fetë e tjera.

1 Ekziston edhe një mendim që kjo kaptinë është e zbritur në Medine.

2 Razi, *Mefatihul 'l-Gajb*, XXXII/357-358.

3 Nesai, *Istiadhe I, Musned III*, 417; IV 144, 153.

4 Alusi, *Ruhu 'l-Meani*, XXX/266.

5 Sujuti, *Durru 'l-Menthur*, VIII, 670.

6 Abduhu, Tefsiri i xhazit Amme, 47.

7 Razi, *Mefatihul 'l-Gajb*, XXXII/357.

8 El Bikai, *Nazmu 'd-Durer*, XXII/327.

9 Razi, *Mefatihul 'l-Gajb*, XXXII/359.

10 Maturidi, *Tevilat*, XVII/377.

11 Rrahman, 54/29.

12 Ibën Kethiri, *Tefsiru 'l-Kur 'ani 'l-Adhim*, v. IV/570.

13 Ibën Ashuri, *Et Tahrir ve 'l-Tenvir*, XXX/619.

14 Merjem, 19/88-95.

15 Teube, 9/30.

16 Teube, 9/30.

17 Nahl, 16/57.

18 Buhari, nr. 4974.

19 Razi, *Mefatihul 'l-gajb*, XXXII/366.

Haxhi dhe fryma e unitetit e aspiruar te myslimanët

Ervin Qylafku

Çështja e haxhit konsiderohet një obligim i madh dhe i rëndësishëm islam, dhe është një nga detyrat dhe ritualet më të rëndësishme fetare, është një nga veprat më të mira për t'iu afruar Zotit të Madhërishëm. Nëse ky detyrim kolektiv kryhet në mënyrë korrekte dhe përdoret në mënyrë e duhur fetare, ai mund të bëhet burim vitaliteti dhe unifikimi i shoqërive myslimane.

RËNDËSIA E HAXHIT

Haxhi është një nga pesë shtyllat e Islamit, dhe si i tillë është një detyrim fetar që duhet të kryhet të paktën një herë në jetën e të gjithë myslimanëve të rritur, të cilët janë fizikisht dhe financiarisht të aftë për të ndërmarrë udhëtimin, dhe që mund të mbështesin familjet e tyre gjatë mungesës së tyre. Allahu në Kuranin famëlartë thotë: *“Shtëpia (xhamia) e parë e ndërtuar për njerëz është ajo që u ngrit në Bekë (Meke), e dobishme, udhërrëfyese për mbarë njerëzimin. Aty ka shenja të qarta, vendi i Ibrahimit dhe kush hyn në të ai është i sigurt. Për hir të Allahut xh.sh., vizita e shtëpisë (Qabesë) është obligim për ata që kanë mundësi udhëtimi tek ajo, e kush nuk e beson (ai nuk e viziton), Allahu xh.sh. nuk është i nevojshëm për (adhurimin që e bëjnë) njerëzit.”* (Ali Imran, 96-97).

Këto dy ajete argumentojnë qartë mbi rëndësinë dhe obligueshmërinë e haxhit që për shkak të realitetit të tij, i cili është i një lloji xhihadi fizik dhe financiar, kryhet ndërkohë që kemi plotësuar aftësinë materiale dhe shëndetësore, vetëm një herë në jetë, kjo bazuar në fjalën e Pejgamberit a.s., i cili thotë: *“Haxhi është një herë në jetë, e kush e përsëritë bën punë të mirë.”*¹ Gjithashtu kryerja e këtij adhurimi të madh nuk duhet vonuar, sepse Pejgamberi a.s., ka thënë: *“Shpejtoni për në haxh, se askush nga ju nuk di se çka mund t'i ndodhë.”*²

Haxhi është bërë farz në vitin e nëntë të hixhretit.

Pejgamberi a.s., ka thënë: *“Shpejtoni për në haxh, se askush nga ju nuk di se çka mund t'i ndodhë.”*

ÇFARË SIMBOLIZON HAXHI?

Haxhi është një manifestim i barazisë dhe një simbol i shfuqizimit të të gjitha formave të diferencimit midis robërve të Zotit. Ritet dhe ritualet e haxhit janë ndër ato adhurime të përbashkëta, që njeriu i fillon duke shmangur çdo gjë përveç rrobave që vesh, duke simbolizuar në këtë rast shkëputjen e të gjitha lidhjeve me materien, përveç asaj që është e domosdoshme. Në ritualet e haxhit, shfuqizimi i dallimeve natyrore janë shpresa dhe ambicia e njerëzve që të vijë dita kur të arrihet drejtësia midis njerëzve dhe të gjitha

format e diskriminimit dhe dallimet midis ngjyrave dhe elementëve dallues mes tyre, si pamja, pasuria, raca, gjuha. Të gjithë janë të ngjashëm në qëndrimin para Zotit dhe njeriu i nënshtrohet faktit se të gjithë njerëzit janë të barabartë para Tij. Ritualet e haxhit janë ibadete që synojnë arrijtjen e këtij qëllimi, gjë që i shtyn njerëzit të kuptojnë se besimi është





arsyeja e vetme që bën dallimin mes tyre, e jo privilegjet, dallimet klasore e shoqërore.

Gjëja më e rëndësishme që zbulon të vërtetën dhe thelbin e haxhit është se ky ritual i shenjtë është një shpërngulje e madhe dhe një udhëtim shpirtëror me kënaqësi dhe bukuri të tejskajshme, sepse është një përgatitje për xhihadin më të madh, luftën me nefsin.

Ritualet e haxhit janë, në fakt, një formë adhurimi që kujton përkushtimin e thellë ndaj Zotit dhe habinë e vetëmohimit dhe altruizmit të madh, të përfaqësuar nga profeti Ibrahim, djali i tij Ismaili dhe gruaja e tij Haxherja.

Ritualet e haxhilerëve janë të përziera me këto ngjarje të mrekullueshme, dhe nëse do të donim të studionim sekretet e haxhit dhe të hulumtonim të vërtetën për veprimet e tij, pa i kushtuar vëmendje këtyre ngjarjeve të ndritshme nga jeta e pejgamberit Ibrahim a.s., këto rituale do të humbitnin shumë nga shkëlqimi dhe bukuria e tyre do të zhdukej.

Kur ne vijmë në tokën e Minës, kujtojmë sakrificën e profetit Ibrahim dhe jetojmë me të momentet e vetëmohimit dhe nënshtrimit që ai jetoj me Zotin e Lartësuar. Kur shprehu gatishmërinë për të sakrifikuar djalin e tij, frytin e jetës së tij që e priste prej kohësh, në emër të Zotit dhe në bindje ndaj urdhrit të Tij dhe duke ofruar gjënë më të çmuar që zotëronte si ofertë Zotit. Ky akt më vonë u bë një ritual për flijim në Mina, i frymëzuar nga ajo histori e mrekullueshme. Kjo histori na thërret të kërkojmë filozofinë e goditjes së gurëve të xhemeratit, të cilat janë tre shtyllat e veçanta në të cilat haxhiu duhet të hedhë shtatë guralecë. Në këtë veprim në mënyrë specifike, kujtojmë luftën e profetit Ibrahim a.s., heroi i monoteizmit, me cytjetet djallëzore.

Në atë kohë, shejtani iu shfaq tri herë në rrugën e tij, i cili u përpoq ta pengonte Ibrahimin që të mbante premtimin ndaj Zotit dhe kur e goditi me guralecë e largoi nga rruga e tij. Kur shkojmë në mëngjes në kodrat Safa dhe Merva, shohim se haxhilerët po vrapojnë tufa dhe pasi të arrijnë te njëra prej tyre, kthehen atje ku kanë filluar. Historia e kësaj përpjekjeje shkon prapa në kohë në përpjekjet e asaj besimtareje, Haxheres dhe luftës së saj të hidhur për mbijetesën e djalit të saj të mitur, i cili u vra nga etja në një

tokë djerrë. Na kujton lutjen e saj për ujë dhe se si Zoti i Plotfuqishëm pati dhembshuri për të dhe djalin e saj të mitur dhe bëri që burimi i Zemzemit të shpërthejë nga poshtë këmbës së tij. Nga kjo ne nxjerrim përfundimin se ecja në rrugën e Zotit është e kotë pa mundim.

DIMENSIONET E ADHURIMIT TË HAXHIT

Forcimi i rregullave të sinqeritetit dhe devotshmërisë, edukimi i shpirtave, forcimi i moralit dhe forcimi i lidhjeve të devotshmërisë janë aspekti themelor i filozofisë së haxhit dhe fesë në tërësi. Dimensioni moral dhe i ai adhurimit, të cilat janë dy shtyllat bazë për kristalizimin e filozofisë së haxhit, janë evidente në rafinimin dhe edukimin e shpirtave, ndërtimin e moralit dhe forcimin e lidhjeve të devotshmërisë dhe sinqeritetit. Hadithet e njohura shprehin gjendjen e pastërtisë nga mëkatet që e karakterizojnë haxhiun pas kryerjes së ritualeve të haxhit, siç thotë transmetimi: “Ai del nga mëkatet e tij ashtu siç ishte në ditën që e lindi nëna e tij.”³ Kjo është dëshmi e ndikimit të thellë që krijon haxhi i madh në shpirtin e njeriut, që është pastrimi i qenies së tij të brendshme nga të gjitha mëkatet, shkeljet dhe gjërat e liga që kanë marrë nën kontroll zemrën e tij dhe kanë banuar në të. Pa dyshim, kjo është një nga përfitimet më të mëdha të haxhit për vizitorët e Shtëpisë së Shenjtë të Zotit.

Haxhi është një lindje dhe një jetë e re. Sa herë që besimtarët bëjnë një hap përpara, ata i afrohen Zotit të Madhëruar gjithnjë e më shumë, siguria e tyre rritet se Zoti i vërtetë dhe i dashur është i pranishëm në jetën e re njerëzore të haxhiut. Ai kupton me gjithë qenien e tij dimensionet morale dhe efektet e vërteta shpirtërore të ritualit të haxhit, ato efekte dhe dimensione të mrekullueshme do të vazhdojnë të qëndrojnë në shpirtat dhe zemrat e tyre deri në fund të jetës. Ndoshta ky është një nga sekretet që qëndron pas obligimit të haxhit një herë në jetën e njeriut.

DIMENSIONET ETIKE TË RITUALEVE TË HAXHIT

Transformimi moral është gjëja më e rëndësishme që e dallon filozofinë e haxhit dhe natyrën e tij të vërtetë, i cili buron nga thellësia e personit dhe rrjedh në të. Ritualet e

ihramit e zhveshin plotësisht njeriun nga kufijtë materiale dhe dallimet sipërfaqësore, pavarësisht nëse ka të bëjë me veshjen, ngjyrën, elegancën apo dekorimin, duke ia ndaluar kënaqësitë dhe duke filluar të krijojë dhe ndërtojë veten, që është një nga detyrat e njerëzve. Haxhiu i veshur me ihram e izolon veten dhe e ndalon nga bota materiale dhe e hedh në botën e dritës, qetësisë dhe shpirtërores. Ndërsa njeriun në kohën tjetër e gjen, ashtu siç jeton jetën e tij, duke duruar ngjyra të rënda të dallimeve formale klasore apo të tjera. Gjatë haxhit gjen ndryshe nga ajo që përjeton në përditshmërinë e tij, ai ndjen barazi dhe zhdukjen e të gjitha dallimeve, përveç ndjenjës së rehatisë dhe qetësisë. Kjo është për shkak se veshja e haxhit nxjerr në pah të gjitha format e arrogancës dhe vetëvlërësimit nga thellësia e një personi duke i flakur ato tutje dhe ushqen thellë brenda tij një mësim për përlulësi, sinjeritet dhe altruizëm.

PËRPIEKJA ME VETVETEN

Nuk ka dyshim se ritualet e adhurimit të praktikuar nga haxhilerët sfidojnë njeriun përballë dëshirave të veta dhe rrënjosin në të shpirtin e përpjekjes dhe përballjes me pëshpëritjet e shejtanit dhe grackave të tij. Sa më e paktë është vështirësia e këtyre ritualeve, aq më i dobët është niveli i vetëluftimit dhe përpjekjes. Por kur vështirësia dhe lodhja është më e madhe, niveli i luftimit me vetveten është gjithnjë e më i fortë, dhe pëshpëritjet e shejtanit janë më të mëdha dhe më insistuese. Këtu është fusha e vetëluftimit dhe në këtë fushë shquhen robërit e Zotit dhe besimi i tyre bëhet më i qartë dhe më i fortë. Kjo shtrirje nxjerr në pah rëndësinë dhe rolin e edukimit në haxh dhe ndikimin e ritualeve të tij në shpirtin e tyre.

PËRFITIMET POLITIKE TË HAXHIT

Uniteti i ymetit islam është njëri ndër qëllimet më thelbësore të obligimit të haxhit, është domosdoshmëria e mbështetjes dhe forcimit të unitetit dhe kohezimit në këtë kauzë të rëndësishme. Haxhi është një faktor në përballje me fanatizmin kombëtar, etnik dhe sektar.

Disa transmetime e kanë shprehur haxhin si xhihadin e të dobëtëve, ndërkohë që Pejgamberit a.s. iu ankua një burrë i dobët fizikisht, ai i tha: “Ejani për te xhihadi, i cili nuk ka vështirësi, në haxh.”⁴ Është një përpjekje në të cilin marrin pjesë burra të moshuar dhe gra të pafuqishme, pasi prania e tyre në ritualet e haxhit përbën një element

fuqie dhe madhështie për ymetin myslimanë, për lutjen e unifikuar në të cilën marrin pjesë të gjithë myslimanët. Prej këtej del në pah madhësia dhe roli i haxhit në unitetin e myslimanëve, si dhe forca e madhështia e Islamit.

Haxhit është konferenca, lidhja më e madhe si dhe më e rëndësishme për myslimanët për të komunikuar dhe njohur njëri-tjetrin.

Kur Islami vendosi ligjet dhe bëri thirrje që konferenca vjetore e haxhit të mbahej në tokën e shenjtë të Mekës garantoj kështu mbijetesën, përjetësinë dhe sigurinë e kësaj feje fisnike dhe sigurisht, kjo konferencë do të ketë një ndikim të madh, sepse do të shërbejë si model në shumë takime në mes myslimanëve.

Islami e trajtoi rëndësinë e këtij rituali dhe rolin e tij katërmëdhjetë shekuj më parë dhe i ekspozoi rezultatet e rëndësishme të këtyre ritualeve shumë kohë më parë. Për mendimtarët islamë që do të kontribuojnë dhe do të marrin pjesë në këtë forum dhe takim të shenjtë, gjëja më e madhe është që ata të trajtojnë dhe paraqesin zhvillimet më të fundit në arenën islame dhe të diskutojnë për natyrën e ndryshimeve

në botën islame e më pas përpiqen të përmirësojnë gjendjen e myslimanëve, të ndihmojnë në përparimin dhe zhvillimin e botës islame në të gjitha fushat.

A ka ndonjë tubim apo forum më të dobishëm se haxhi dhe frytet më të mira që myslimanët mund të korrrin nga ky lloj komunikimi dhe njohjeje ndërmjet myslimanëve në botë dhe secilit prej udhëheqësve të tyre duke u informuar për situatat dhe problemet e tjetrit?

Prandaj, konferenca e madhe vjetore e haxhit gjithmonë frymëzon në shumë aspekte dhe luan një rol të madh në përballje me padrejtësinë, korrupsionin dhe shumë nuanca të padrejtësisë të kryera në adresë të bijve të Islamit.

Prandaj, takimi i madh islam gjatë haxhit është një proces i konsolidimit dhe stabilizimit të rregullave dhe parimeve të Islamit të vërtetë dhe është një rritje e forcës dhe kohezionit të myslimanëve në fusha të ndryshme intelektuale, kulturore, shoqërore, përveç asaj shpirtërore.

HAXHI ËSHTË NJË ELEMENT THELBËSOR KUNDËR ARROGANCËS DHE TIRANISË

Një grup ritualesh që karakterizohen me ndikim masiv dhe të gjerë dhe që përmbajnë

Takimi i madh islam gjatë haxhit është një proces i konsolidimit dhe stabilizimit të rregullave dhe parimeve të Islamit të vërtetë dhe është një rritje e forcës dhe kohezionit të myslimanëve në fusha të ndryshme intelektuale, kulturore, shoqërore, përveç asaj shpirtërore.

shumë motive morale rrallëherë përputhen në jetën e kësaj bote, por fatkeqësisht myslimanët nuk e kuptojnë fuqinë e madhe të haxhit dhe nuk investojmë për të përfituar nga dobia e madhe e tij. Përndryshe, ata do të mund t'i ofrojnë Islamit një shërbim më të mirë dhe më të madh çdo vit, për rrjedhojë, ata do t'i japin një goditje fatale themeleve të mosbesimit dhe të tiranisë.

FRYTET EKONOMIKE TË HAXHIT DHE DOMOSDOSHMERIA E PËRFITIMIT EKONOMIK NDËRMJET VENDEVE ISLAME

Mbështetja e mekanizmave ekonomike të vendeve islame është ndër strategjitë bazë për fuqizimin, krenarinë dhe dinjitetin e popujve dhe vendeve, prandaj tubimi i madh i haxhit mund të luajë një rol të madh në arritjen e fuqisë dhe cilësisë së ekonomisë së vendeve islame si dhe mirëqenien e myslimanëve, gjë që kërkon ndërgjegjësim, vigjilencë dhe mendjemprehtësi të atyre vendeve dhe udhëheqësve të tyre. Por fatkeqësisht deri më tani, për shkak të neglizhencës së vendeve islame si dhe situatës ku ato gjenden, filozofia ekonomike e haxhit, është bërë diçka e harruar dhe ato vende janë krejtësisht indiferente ndaj pasojave të asaj neglizhence katastrofike.

Ndryshe nga sa mendojnë disa njerëz, konsiderimi i konferencës së madhe të haxhit një faktor i rëndësishëm në mbështetjen e rregullave dhe themeleve ekonomike të vendeve, jo vetëm që nuk bie ndesh me frymën dhe filozofinë e haxhit, por në dritën e transmetimeve të nderuara, ajo është një prej tyre sekretet, synimet dhe objektivat e haxhit. Ajetet e Kuranit famëlartë nuk privojnë nga përfitimi i të mirave të kësaj bote përgjatë ritualeve të haxhit. Ato synojnë që ky adhurim i madh të mos jetë i zhvlerësuar totalisht nga qëllimi i afrimit me Zotin, e qëllimi kryesor të jetë përfitimi i kësaj jete. Por ndërkohë që qëllimi i haxhit, krahas adhurimit të Zotit, është edhe konsolidimi i së ardhmes ekonomike të vendeve islame, e ky qëllim merr përmasa të konsiderueshme nga Zoti i gjithësisë. Prandaj, çfarë i pengon myslimanët që të krijojnë një treg të përbashkët islamik për shkëmbim tregtar ndërmjet vendeve të tyre ashtu sikundër kanë edhe vendet perëndimore!

Prandaj, myslimanët udhëtojnë nga vende të ndryshme të botës drejt Shtëpisë së Shenjtë duke formuar kështu një takim që i përngjet një forumi ndërkombëtar që mund të krijojë një transformim ekonomik të mrekullueshëm dhe të rëndësishëm, që është në interes të përgjithshëm të myslimanëve në shoqëritë e ndryshme islame.

DIMENSIONET SOCIALE TË HAXHIT

Ndër efektet e bekuara të haxhit është forcimi i lidhjeve shoqërore përmes ritualeve unike të këtij adhurimi që burojnë nga vlerat islame. Adhurimet në fenë islame përmbajnë sekrete nga të cilat përfitojnë drejtpërdrejt praktikuesi i atij adhurimi ose shoqëria në të cilën ai jeton. Por një prej këtyre ibadeteve më të rëndësishme që përfshin

një aspekt dhe dimension të madh shoqëror është rituali i haxhit.

Nuk ka dyshim se Islami është një fe shoqërore, prandaj shoqëria konsiderohet origjina dhe individët janë dega, pasi ata duhet të shpërbëhen dhe të përzihen në atë shoqëri. Për këtë arsye, ne gjejmë se shumica e lutjeve të namazit janë përmendur në shumës, jo në njëjës: “Dhe na udhëzo në rrugën e drejtë!” etj., shembuj të ngjashëm.

PAJTIMI DHE PËRQAFIMI I ZEMRAVE TË SHOQËRIVE TË NDRYSHME ISLAME

Çështjet sociale, në atë dritë që i sheh Islami janë të një rëndësie të tillë, sa që çdo çështje është e dobishme për unitetin e myslimanëve dhe ndihmon në pajtimin mes tyre, dhe çdo çështje që shkakton mosmarrëveshje mes myslimanëve është e ndaluar. Që këtu, uniteti, konsensusi dhe pajtimi ndërmjet njerëzve u konsideruan të një shkalle të lartë rëndësie derisa u bë sinonim i xhihadit në rreshtin e parë të fushëbetjes.

Në dritën e këtyre të dhënave dhe interpretimeve, Islami e konsideron shoqërinë si themel dhe bazë për individët që rriten në përqaftimin e kësaj shoqërie. Ritualet dhe adhurimet në Islam zhvillohen në mënyrë kolektive dhe jo në mënyrë të izoluar e individualiste.

Islami është përpjekur që individët e kësaj shoqërie t'i mbajë të bashkuar e t'i ruajë nga çdo shkak që sjell përçarjen. Për këtë arsye ka vendosur që njerëzit t'i ndërtojnë marrëdhëniet e tyre mbi një kod moral, por njëkohësisht i dënon thashethemet, përgojimet dhe të ngjashmet e këtyre antivlerave që këputin lidhjet e shoqërisë. Ndërsa pajtimi, bashkëpunimi dhe bashkërendimi i vazhdueshëm ndërmjet anëtarëve të shoqërisë dhe plotësimi i nevojave të njerëzve janë gjëra të dëshirueshme dhe të parapëlqyera, sepse këto çojnë në forcimin e atyre lidhjeve dhe zhvillimin e tyre.

Si përfundim, duhet thënë se përveç kujdesit për trupin e adhurimit, veprimet fizike, duhet pasur kujdes edhe për shpirtin e tij. Kjo është për shkak se ata që kujdesen për trupin dhe formën e adhurimit dhe nuk kujdesen për shpirtin dhe përmbajtjen e adhurimit gabojnë. Shëmbëlltyra dhe forma e jashtme e haxhit është ihram është qëndrimi në këmbë në Arafat, në Qabenë e Shenjtë, kryerja e adhurimeve të Minasë, tavafit dhe të ngjashme me to. Ndërsa shpirti dhe thellësia e haxhit konsiston në faktin kur njeriu bëhet sikur sapo ka lindur, gjendje që i përngjan dëlirësisë të porsalindurve, të cilët janë të gatshëm për të bashkëvepruar me rrethin e tyre shoqëror e për të kontribuar me të tjerët në saje të pastërtisë së tij.

- 1 Sulejman ibën Eshath, *Sunen Ebi Davud*, Damask, Muesesetu Risaleh, 2009, 1721.
- 2 Ahmed ibën Hanbel, *Musned Ahmed*, Kajro, Darul Hadith, 1995, 2869.
- 3 Muhamed ibën Ismail, *Sahihul Buhari*, Darul Fejha, Damask, 1999, 1521.
- 4 Zekijudin el Mundhiri, *Tergib ve Terhib*, Daru Ibni Kethir, Damask, 1996, 2/16

Ihrami, nocioni dhe normat e tij

Dr. Muhamed Stublla

Adhurimet për nga koha dhe vendi janë të përcaktuara prej Allahu xh.sh.. Meka, vendlindja e Muhamed Mustafasë a.s., është vendi në të cilin gjendet Qabeja e bekuar, vend ky në të cilin bëhet umreja dhe pjesa qendrore e ritualit të haxhit. Pavarësisht cilin nga këto adhurime dëshironi t'i bëni, ju duhet të pajiseni me ihram. Me ihram kuptojmë *nijetin me shprehje të caktuara, në vend dhe kohë të caktuar, me një veshje të veçantë për meshkujt, me qëllim të kryerjes së ritualit të haxhit apo umres.*

Sikurse edhe veprimet plotësuese të adhurimeve të tjera, njashtu edhe ihrami, si kusht plotësues i haxhit apo umres, përbëhet prej kushteve, gjërave të preferuara para, gjatë dhe pas hyrjes në të.

PËRGATITJA PËR IHRAM

Veprat para hyrjes në ihram janë të rëndësishme, ato përgatisin besimtarin, fizikisht, psikikisht dhe emocionalisht, që ky adhurim të jetë sa më i lehtë dhe të ndikojë edhe në gjendjen shpirtërore, individuale dhe shoqërore.

Andaj, besimtari para se të hyjë në ihram, preferohet që të shkurtojë dhe rruaj qimet e tij, të bëjë prerjen e thonjve, të pastrohet me shampon apo sapun, të lirohet nga ndikimi intim bashkëshortor nëse është i martuar, të zhvishet nga çdo rrobë¹ dhe preferohet të

Besimtari para se të hyjë në ihram, preferohet që të shkurtojë dhe rruaj qimet e tij, të bëjë prerjen e thonjve, të pastrohet me shampon apo sapun, të lirohet nga ndikimi intim bashkëshortor nëse është i martuar, të zhvishet nga çdo rrobë dhe preferohet të parfumohet

parfumohet etj., vepra këto të cilat janë të ndaluar pasi që haxhiu apo umrexhiu (personi që bën umren) të hyjë në ihram.

Që përkushtimin e besimtarit të mos e pengojë pjesa emocionale dhe fizike, paraprakisht preferohet të lirohet nga çdo gjë që mund të atakojë përkushtimin e tij shpirtëror. Zhveshja nga rrobat e zakonshme dhe veshja e petkut të bardhë, do të ndikojë apo stimulojë që besimtari të distancohet nga çdo gjë që e dëmton bardhtësinë e shpirtit. Përmes ihramit, shfaqet varfëria, barazia dhe dorëzimi absolut para krijesave, por edhe nevoja jonë e barabartë për mëshirën e Mëshiruesit.

HYRJA NË IHRAM

Forma e hyrjes në ihram mësohet nga definicioni i ihramit. Paraprakisht duhet që të hiqen të gjitha veshjet dhe mbathjet e zakonshme, pastaj burrat të veshim rrobën apo petkun e ihramit, i cili është një lloj çarçafi apo bezi i bardhë i përbërë nga dy pjesë të ngjashme, njëra mbulon pjesën e avritit, nga beli e poshtë dhe pjesa tjetër vendoset krahëve dhe arrin deri nën bel. Pasi që besimtari është pastruar dhe ka veshur petkun e ihramit, falë dy rekate sunet të ihramit në xhaminë apo vendin e caktuar. Në fund të dy rekateve të ihramit, i drejtuar nga kibla, pa lëvizur nga vendi, me zemrën dhe gjuhën e tij, bën nijet

hyrjen në ihram, duke e potencuar ihramin për umre apo për haxhin që dëshiron ai. Fjalët apo shprehjet e hyrjes në ihram mund të jenë të ndryshme, por me rëndësi është të përfshijnë qëllimin e ihramit dhe duanë-lutjen drejtuar Allahut xh.sh., që t'i pranojë dhe ndihmojë, si p.sh.: *O Zot, për Madhërinë Tënde vendosa të hyjë në ihram për të bërë umre-haxh, të lutem o Zot, lehtësoje dhe pranoje nga unë!*

Më pas, preferohet të lexohet shprehja, telbija madhëruese ndaj Allahut xh.sh., të cilën na e ka mësuar Muhamedi a.s.:

لَبَّيْكَ اللَّهُمَّ لَبَّيْكَ، لَبَّيْكَ لَا شَرِيكَ لَكَ لَبَّيْكَ،
إِنَّ الْحَمْدَ وَالنَّعْمَةَ لَكَ وَالْمُلْكُ، لَا شَرِيكَ لَكَ

(Lebejk Allahume lebejk, lebejke la sherike leke lebejk. Innel Hamde ve niëmeteh leke vel Mulk la sherike lek).²

Kuptimi i së cilës është: Të përgjigjemi o Allah, të përgjigjemi, të përgjigjemi sepse Ti nuk ke ortak (shok). Pa dyshim se falënderimi, dhuntia dhe i tërë pushteti, të takon vetëm Ty, Ti nuk ke ortak!

Nga ky moment, fillon leximi i telbijes, e cila për ihramin e umres përfundon me fillimin e tavafit, ndërsa për ihramin e haxhit përfundon me fillimin e gjuajtjes së guralecëve të parë.³ Pas telbijes, që është dëshmi e njëshmërisë dhe madhërimit të Zotit xh.sh., preferohet thënia e salavateve për Pejgamberin, Muhamed Mustafanë a.s., dhe të luteni çfarëdo që dëshironi, për vete, familjen dhe besimtarët, kështu vepronin dhe shtonin lutjet e tyre shokët e Muhamedit a.s..⁴

Normat juridike islame që ndërlidhen me ihramin

Normat juridike të çdo vepre, ashtu edhe të ihramit, janë të ndryshme, kategorizohen në shkallë të ndryshme, filluar nga ato pa të cilat nuk konsiderohet fare vepra, që ne i quajmë farze, e në ihram farzi i vetëm është nijeti i ihramit, i cili plotësohet me shprehjen e caktuar.

Pastaj pasojnë, vaxhibet, të cilat ndërlidhen me thelbin e veprës. Vepra pranohet pa vaxhibe, por shpërblimi i saj është i mangët, rrjedhimisht edhe ndikimi i asaj vepre në jetën e besimtarit do të jetë i cinguar. Sunetet i plotësojnë vaxhibet, respektivisht, plotësojnë jetësimin dhe shpërblimin e veprës. Ndërsa mekruhet janë e kundërta e suneteve. Mustehabet perfeksionojnë veprën, ato ndikojnë në absorbimin e tërë shpërblimit të veprës, njëkohësisht pamundësojnë dëmtimin e saj. Ndërsa, mubahatet janë gjëra që lejohen të veprohen, veprimi apo largimi nga ato, nuk dëmton dhe as nuk e shpërblen më shumë vepruesin e tyre. Andaj normat juridike që ndërlidhen me ihramin janë:

Farzi i ihramit, që është nijeti, i cili plotësohet me shprehjen e caktuar e cila përcakton qëllimin e ihramit.

Në ihram farzi
i vetëm është
nijeti i ihramit,
i cili
plotësohet me
shprehjen e
caktuar.

VAXHIBET E IHRAMIT

Të jetë nga mikatet - vendvëshjet e ihramit, vende këto të cilat nuk lejohen të kalohen pa ihram, për të gjithë ata që synojnë Mekën. Në rast të kalimit të këtyre stacioneve, të cilat janë kufiri apo mundësia e fundit e pranuar për veshjen e ihramit, duhet të kthehemi dhe të pajisemi me ihram.

Kufijtë në të cilët nuk lejohet të kalohen pa ihram, na i ka treguar Muhamedi a.s.,⁵ e të cilët janë:

Dhul Hilejfeh, nga drejtimi i Medinës, 450 km larg Mekës,

El Xhuhfetu, nga drejtimi i Shamit, 183 km larg Mekës,

Karnul Menazil, nga drejtimi i Nexhdit, 75 km larg Mekës,

Jelemlem, nga drejtimi i Jemenit, 92 km larg Mekës,

Dhate Irk, nga drejtimi i Irakut, 94 km larg Mekës⁶,

Distancimi nga gjërat të cilat nuk duhet të veprohen gjatë të qenët në ihram:

Ndalohet në ihram intimiteti bashkëshortor, dhe çdo vepër apo fjalë e cila konsiderohet si parapërgatitje intime,

Veshja e ihramit pas kalimit të mikateve-vendvëshjeve,

Shkulja e qimeve, pavarësisht formës së eliminimit, përmes shkurtimit, rruajtjes, nxjerrjes etj.,



Veshja apo mbathjet në formën e zakonshme të veshjes. Ndërsa hedhja e batanijeve, pëlhurave apo rrobave mbi trup, duke mos i veshur si zakonisht, p.sh.: duke mos i vendosur duart në mangët e setrës, por duke e hedhur atë mbi krah, një gjë e tillë lejohet, sepse kjo është bartje apo mbulim dhe jo veshje.⁷

Pejgamberi a.s. ka thënë: “Mos vishni këmisha, çallma, pantallona, kapela, meste, përveç nëse nuk gjeni shapka, le të mbathë këpucët apo meste, mirëpo t’i pres ato deri poshtë kyçeve të këmbëve dhe mos vishni rroba që janë parfumosura me zafran dhe as me parfume me ngjyrë.”⁸

Ndalohet mbulimi i fytyrës dhe kokës,

Ndalimi i çdo parfumosje. Gjithashtu ndalohet lyerja e panevojshme me vajra apo kremra pas hyrjes në ihram,

Gjuajtja e gjahut të tokës, dhe çdo ndihmë që i ofrohet gjahtarit për gjah,

Prerja e pemëve të Haremit, shkulja e tyre etj..⁹

SUNETET E IHRAMIT

Sunetet e ihramit sigurojnë dhe plotësojnë veprën. Lënia e suneteve pa arsye është e papëlqyer, por nëse lënia e tyre ndodh për ndonjë arsye, nuk konsiderohet fare që ka ndodhur ndonjë lëshim. Prej gjërave që preferohen, që janë sunet veprimet e tyre në ihram do të veçojmë:

Preferohet që haxhilerët të hyjnë në ihram gjatë muajve të haxhit, respektivisht, prej ditës së Fitër Bajramit.

Veshja e ihramit nga vendlindja, nëse vendi i lindjes është përtej vendveshjes – mikateve.

Gusli apo larja e tërë trupit para veshjes së ihramit.

Veshja e rrobës së ihramit të përbëhet nga dy pjesë për burrat, ndërsa gratë veshin rrobat e zakonshme,

Parfumosja dhe lyerja me aroma para veshjes së ihramit, mirëpo duke mos mbetur shenjat e parfumit apo vajit gjatë të qëndruarit në ihram ose që ndikimi i tyre të jetë i pa theksuar.

Falja e dy rekateve namaz nafile të ihramit.

Vazhdueshmëria e këndimit të telbijeve të transmetuara në hadithe, cilado që këndohet, preferohet që të përsëritet tri herë, burrat të këndojnë telbijet me zë të lart, ndërsa gratë nuk e ngrenë zërin.¹⁰

MEKRUHET E IHRAMIT

Mekruhatet e lehta të ihramit, konsiderohen ato vepra të cilat nuk preferohen të bëhen gjatë të qenët në ihram. Mekruhet e dëmtojnë nivelin e shpërblimit të ihramit, nëse bëhen qëllimisht, por nuk e obligojnë therjen e kurbanit, dhe as nuk kërkohet ndonjë shpagim material si kompensim i lëshimeve të tilla. Ndër mekruhatet e ihramit veçojmë:



Mos praktikimi i suneteve, lënia e suneteve qëllimisht është e papëlqyer, mekruh,

Eliminimi i papastërtive pas veshjes së ihramit, pastërtive të cilat nuk ndikojnë në saktësinë e adhurimeve,

Larja e kokës, mjekrës dhe trupit me shampoon apo sapun pa nevojë, edhe nëse janë pa aromë,

Krehja e flokëve, pasi që gjatë krehjes është shumë evidente këputja apo shkulja flokëve,

Kruarja e flokëve dhe trupit me forcë, si rezultat i së cilës mund të ketë këputje të qimeve,

Veshja e ihramit të parfumosur, ndikimi apo shfaqja e të cilit parfum vazhdon edhe pas hyrjes në ihram,

Mbulimi i mjekrës, hundës dhe fytyrës në forma të ndryshme.¹¹

MUSTEHABET E IHRAMIT

Mustehabet, janë ato vepra të cilat janë të dëshiruara veprimi i tyre. Lëshimi i mustehabeve nuk shkakton pasojë në mangësi të adhurimit. Mustehabatet apo veprat e pëlqyera gjatë ihramit janë shumë, do të veçojmë disa prej tyre:

Eliminimi i papastërtisë para pastrimit të tërë trupit, si p.sh. pastrimi i papastërtive nën thonj,

Veshja e ihramit të përbërë prej dy pjesëve të reja dhe të bardha, ose të paktën të lara mirë,

Bërja nijet për guslin e ihramit, gusli është sunet, ndërsa nijeti për gusël është mustehab,

Mbathja e çapkave, me kusht që të mos mbulojnë ashtin e shputës së këmbës,

Bërja nijet për hyrjen në ihramin e haxhit apo umres, menjëherë pas kryerjes së namazit të ihramit.

MUBAHATET E IHRAMIT

Mubahate janë të gjitha veprat të cilat nuk preferohen të lihen dhe as të veprohen gjatë të qenët në ihram, si p.sh.:

Larja me ujë të natyrshëm, por edhe me sapun që nuk ka aromë, me qëllim të eliminimit të pluhurit apo freskisë,

Larja e rrobës së ihramit për të pastruar nga ndyrësit,

Veshja e unazës, orës, syzave etj.,

Përdorja e rripit për të vendosur në bel, me qëllim të sigurimit të ihramit,

Qëndrimi nën hije, pavarësisht a është hijja nga objekti, tenda, çadra etj., me kusht që ajo të mos e prek kokën.

Lyerja e plagëve të trupit.

Shitja apo blerja e produkteve të ndryshme, lejohet lidhja e çdo kontratë.¹²

SHPAGIMET E GABIMEVE NË IHRAM

Kur njeriu hynë në ihram, përkushtohet në pjesën shpirtërore, zhvishet nga çdo gjë materiale dhe shpenzon nga pasuria e tij. Pasi që vishet me petkun e devotshmërisë, e dorëzon vetën dhe pasurinë e tij, zotohet që do të jetë qytetar paqësor.

Butësia dhe mirësia e tij do të sigurojë jetën, krenarinë dhe gjendjen e çdo njeriu, por edhe ekzistencën e çdo kafshe dhe bime. Megjithatë, njeriu prapë mund të gaboj, andaj, Allahu xh.sh. ka mundësuar përmirësimin e gabimit. Kështu që, nëse gjatë ihramit bëhen këto gabime duhet që në proporcion me nivelin e tyre të jetë edhe shpagimi.

Tejkalimi i vendveshjeve pa hyrë në ihram, duhet të kthehemi në vendin përkatës, përndryshe kërkohet therja e një kurbanit, (dele apo dhi),¹³

Nëse gjatë të qenit në ihram prehen apo rruhen rreth ¼ ose më shumë e flokëve obligohet me therje të kurbanit. Ndërsa sasia e rruajtjes apo prerjes së flokëve është më pak se ¼ dhurohet sadakë - lëmoshë, objektiva e vlerës të së cilës është sa ushqimi i një njeriu të varfër,

Nëse prehen pesë thonjtë, obligohet therja e kurbanit të vogël,

Veshja e rrobave të rëndomta, në interval kohor, për një ditë apo natë të plotë, e të cilat rroba janë të qepura për

gjymtyrë të trupit, duhet të prehet kurban, nëse ato vishen dhe nuk qëndrojnë gjatë, atëherë dhurohet sadaka,¹⁴

Parfumosja e trupit, apo një gjymtyrë, me parfume, kremra dhe vajra që nuk përdoren për shërim, obligojnë prerjen e kurbanit,

Gjatë ihramit ndalohet çdo lloj aktiviteti apo edhe shqetësimi të gjahut, pavarësisht a është prej kafshëve apo shpezëve. Shpagimi për mbytjen apo lëndimin e gjahut gjatë ihramit është në proporcion me vlerën e tij apo të lëndimit që i është shkaktuar gjahut. Nëse gjahu ka qenë pronë e ndokujt, pronarit i kompensohet vlera e gjahut, dhe njëkohësisht, edhe jepet sadaka vlera e gjahut, kjo pasi që është vrarë apo lënduar pabesisht në vendin e besës dhe paqes. Andaj, ai gjah paguhet dy herë.¹⁵

Lirimi nga ihrami i haxhit

Varësisht prej adhurimit dhe fazës në të cilën gjendemi, kemi dy lloj lirimesh nga ihrami:

Lirimi i vogël, nëse haxhiu vepron të paktën dy nga këto vepra, gjuan guralecët në ditën e parë, therë kurbanin ose rruan apo shkurton flokët, lirohet nga të gjitha ndalesat e ihramit, me përjashtim të intimitetit bashkëshortor.

Lirimi i plotë nga ihrami. Realizohet kur haxhiu kryen veprat e lartcekura dhe tavafin e haxhit, Ez Zijarah.¹⁶

- 1 Ebu el Haxh, prof, dr. Sallah, *El Minhaxh el Vexhiz fi Fikh ez Zekah ve el Haxh*, (Jordan, Amman, Dar el Faruk, 2016), f. 97, 98.
- 2 Imam Buhariu, Muhamed bin Ismail, *Sahihun i Buhariut*, recensent Muhamed Zuhejr bin Nasir en Nasir, (Turuk en Nexhah, 1422 h.) nr. 1549, vëll. 2, f. 831.
- 3 Esh Shejbani, Muhamed ibën el Hasen, *El Asel, el Maruf bi el Mabsut*, recensoi: Ebu el Vefa el Afgani, (Pakistan, Keratshi, Idaratu el Kuran Vel Ulum el Islamiye), 2/367.
- 4 Imam Muslimi bin el Haxhaxhi, Ebu el Hasan el Kushejri, *Sahihu i Muslimit*, recensent Muhamed Fuad Abdulkaki, (Liban, Bejrut, Ihjau et Turath, 1954), nr. 1184, vëll. 2, f. 148.
- 5 Sahih Muslim, nr. 1183, 2/841.
- 6 Musallari, Rushit, *Fikhu Praktik*, (Shqipëri, Tiranë, bot. Shoqata kulturore "Ardhmëria", 2016) f.516.
- 7 El Musilij, Abdullah bin Mahmud, *El Ihtijar et Talil el Muhtar*, recensoi: shejh Shuajb Arranauti dhe Abdulatif Hirzallah, (Bejrut, Dar err Risale el Alemijeh, 2009), 1/449.
- 8 Sahih Muslim, nr.1177, 2/834.
- 9 Ebu el Haxh, *El Minhaxh el Vexhiz fi Fikh ez Zekah ve el Haxh*, 106-108.
- 10 Burimi paraprak, 101-102.
- 11 Ebu el Haxh, *El Minhaxh el Vexhiz fi Fikh ez Zekah ve el Haxh*, 108-109.
- 12 Burimi paraprak, 103-104.
- 13 Ibën Mazah, Burhanudin Mahmud, *El Muhit el Burhani fi el Fikhi en Numani*, Fikh el Imam Ebu Hanifeh r.a., recensoi: Abdulkarim Sami el Xhundij, (Liban, Bejrut, Dar el Kutub el Ilmijeh, 2004), 2/436.
- 14 El Musilij, *El Ihtijar et Talil Eel Muhtar*, 1/502.
- 15 Arifi dhe Maqedonci, Driton dhe Ekrem, *Fikhu* 2, (Prishtinë, Printing Press, 2020) f.160, 163.
- 16 El Xhesas, Ahmed bin Alij, *Sherh Muhtesar et Tahavij*, (Bejrut, Dar el Beshair el Islamiyeh dhe Dar es Seraxh, 2010), 2/537.

Vaxhibet dhe lehtësimet e tolerueshme të haxhit

Nehat Shehu

Haxhi, udhëtimi jetësor, i cili është synim i secilit mysliman, është ëndërr e secilit besimtar, ngase ai ngërthen burimin e devotshmërisë, ndërlidhjen mes të kaluarës dhe të tashmes, mësimin dhe jetësimin e Islamit tonë madhështor. Duke vështuar e medituuar ato vende, besimtari jo vetëm që pastrohet nga mëkatet, por edhe reflekton në mënyrën e perceptimit të jetës pas haxhit, fakt ky që e bën akoma më madhështor këtë udhëtim. Andaj në rast mundësie të udhëtimit për në tokat e shenjta, secili haxhi dëshiron ta kryejë këtë udhëtim të jetës në mënyrën më të mirë të mundshme, ashtu që të bëj pjesë në hadithin e Muhamedit a.s., në të cilin ai i bekuar ka thënë: *“Haxhi i pranuar nuk ka shpërblim tjetër pos Xhenetit”*. Andaj padyshim se pjesë e kësaj përgatitjeje është edhe informimi rreth gjërave të cilat na obligohen gjatë haxhit.

Në këtë shkrim do të mundohemi të sqarojmë rreth vaxhibeve të haxhit dhe lehtësimeve të tolerueshme në haxh; se cilat janë obligimet e haxhiut që duhet t'i kryej, dhe se a kemi raste ku për një apo arsyen tjetër, haxhiu ka lehtësime të tolerueshme.

Vaxhibet e haxhit janë rituale të obliguara për haxhilerët, e në rast të moskryerjes së tyre, ato kompensohen me therje të kurbanit. Dijetarët kanë diskutuar rreth tyre, por ne do të mundohemi t'i përmendim ato që janë më të rëndësishmet, e të cilat janë:

1. Sa'ji – vrapimi apo ecja e përshpejtuar mes Safasë dhe Merves (dy kodrinave);
2. Qëndrimi në Muzdelife;

Vaxhibet e haxhit janë rituale të obliguara për haxhilerët, e në rast të moskryerjes së tyre, ato kompensohen me therje të kurbanit.

3. Gjuajtja e guralecëve te xhemeratet (për tri ditë radhazi);

4. Therja e kurbanit për haxhilerët që kryejnë haxhin “Temetu” ose haxhin “Kiran”;

5. Shkurtimi ose rruajtja e flokëve;

6. Tavafi lamtumirës (Tavaful veda);¹

7. Qëndrimi në Arafat deri në perëndim të diellit;²

8. Fillimi i sajit nga Safa;

9. Braktisja e gjërave të ndaluara gjatë kohës sa është në ihram si: parfumimi, mbulimi i fytyrës dhe kokës te meshkujt, mbulimi i fytyrës dhe vendosja e dorezave te femra, prerja e thonjeve, përleshja, fjalosja, veshja e rrobave të qepura te burrat, gjuetia.³

1. Sa'ji – vrapimi mes Safasë dhe Merves

Pas kryerjes së tavaful zijares (tavafi i vizitës), haxhilerët kanë vaxhib të bëjnë sa'jin



mes Safasë dhe Mervës. Sa'ji është ajo ecje e përshpejtuar, e cila duhet të bëhet nga çdo haxhi. Numri i vrapimeve apo ecjeve me nxitim të cilat obligohen është shtatë. Kështu është transmetuar nga Pejgamberi a.s.

2. Qëndrimi në Muzdelife

Pasi që të perëndojë dielli në ditën e Arafatit, haxhilerët vazhdojnë rrugën e tyre për në Muzdelife, duke përmendur Allahun, duke kënduar telbije e duke ecur me qetësi, vetëm nëse gjejnë hapësirë atëherë shpejtojnë, duke u kujdesur të mos shkaktojë dëm, sidomos në ditët e sotme. Qëndrimi në Muzdelife është çlodhje e prehje për haxhilerët pas një ditë të ngarkuar e të mundimshme në Arafat. Është vaxhib qe ky qëndrim të bëhet nga hyrja e namazit të sabahut e deri në lindje të diellit.⁴

3. Gjuajtja e guralecëve te xhemeratet (për tri ditë radhazi)

Gjuajtja e guralecëve është një gjuajtje, e cila simbolizon gjuajtjen e djallit të mallkuar. Kjo gjuajtje bëhet në vendet e quajtura xhemerate, të cilat gjenden në Mira dhe të cilat janë tri.

Dita e parë e gjuajtjes është dita e Kurban Bajramit (dita e dhjetë e muajit dhul-hixhxhe). Në këtë ditë gjuhen shtatë guralecë të xhemreja e madhe. Gurët duhen gjuajtur një nga një dhe nëse gjuhen së bashku llogaritet një gjuajtje. Koha e gjuajtjes është nga lindja e diellit deri në perëndimin e tij, por preferohet të bëhet pas lindjes së diellit.

Dita e dytë e gjuajtjes është dita e njëmbëdhjetë e dhul-hixhxhes. Në këtë ditë gjuhen në të tri xhemeratet nga shtatë guralecë. Koha e gjuajtjes është pas daljes së diellit në zenit deri në perëndimin e tij.

Dita e tretë e gjuajtjes është dita e dymbëdhjetë e dhul-hixhxhes dhe është e njëjta procedurë e gjuajtjes së gurëve sikur në ditën e dytë (njëmbëdhjetë dhul-hixhxhe), gjuhen nga shtatë guralecë në tri xhemeratet. Koha e gjuajtjes është e njëjtë sikur ditën paraprake, mirëpo nëse ndodh që haxhiu të mbetet në Mina deri pas perëndimit të diellit, atëherë i gjuan guralecët ditën vijuese, pra ditën e katërt apo trembëdhjetë të dhul-hixhxhes.

4. Therja e kurbanit për haxhilerët që kryejnë haxhin “Temetu” ose haxhin “Kiran”

Nëse haxhiu e ka kryer haxhin “Temetu” ose atë “Kiran”, atëherë ai e ka vaxhib të bëjë therjen e kurbanit, i cili është obligim të theret në Meke (respektivisht brenda territorit të haremit), pra therja e tij jashtë këtij territori nuk lejohet. Kurbanit i cili theret është kurban i vogël (dele, dash e të ngjashme). Nëse nuk mund ta therë atë, atëherë duhet të agjërojë tri ditë gjatë haxhit (ditë që duhet agjëruar patjetër

Prej vaxhibeve të haxhit është edhe shkurtimi apo rruajtja e flokëve. Kjo bëhet në ditën e dhjetë të dhul-hixhxhes, pas gjuajtjes së guralecëve në xhemerat.

para ditës së Arafatit) dhe shtatë ditë të tjera pasi të jetë kthyer në shtëpinë e tij.⁵

5. Shkurtimi apo rruajtja e flokëve

Prej vaxhibeve të haxhit është edhe shkurtimi apo rruajtja e flokëve. Kjo bëhet në ditën e dhjetë të dhul-hixhxhes, pas gjuajtjes së guralecëve në xhemerat. Natyrisht se rruajtja e tërësishme e flokëve është më e preferuar te meshkujt, por edhe me shkurtimin e tyre vaxhibi kryhet, ndërsa për gjininë femërore është e mjaftueshme vetëm shkurtimi i majave të flokëve, qoftë dhe sa majat e gishtërinjve.⁶

6. Taravi i lamtumirës (Tavaful veda)

Pasi që haxhiu t'i ketë përfunduar të gjitha ritualet e haxhit, ai bën edhe tavafin e lamtumirës, tavaf ky që bëhet para se të largohet nga Meka. Është një lloj përhëndetjeje apo lamtumire që haxhiu e

bën para se të largohet. Norma e këtij tavafi te dijetarët hanefitë është vaxhib. Nëse haxhiu e lë dhe nuk e kryen, atëherë ka obligim therjen e kurbanit. Tavafi kryhet njësoj si tavafi i vizitës, pra shtatë rrotullime duke filluar nga Haxhrul Esvedi (guri i zi). Nëse haxhiu bën katër rrotullime, është i pranuar, mirëpo jepet sadaka, nëse bën më pak se katër, nuk pranohet dhe duhet përsëritur.⁷

7. Qëndrimi në Arafat deri në perëndim të diellit

Njëri nga vaxhibet e haxhit është edhe qëndrimi në Arafat deri në perëndimin e diellit, siç është transmetuar nga Pejgamberi a.s., se ai ka qëndruar në këmbë derisa ka perënduar dielli në atë ditë. Nëse haxhiu largohet nga Arafati para perëndimit të diellit, duhet të kthehet e të qëndrojë aty natën, nëse nuk e bën edhe këtë, atëherë obligohet me therje të kurbanit, sepse ka lënë një nga vaxhibet e haxhit, e që është të qëndruarit deri në perëndim të diellit.

8. Fillimi i saj'it nga Safa

Më lartë sqaruam se sa'ji mes Safasë dhe Mervës është nga vaxhibet e haxhit që haxhiu duhet ta kryej. Ky vaxhib është doemos të fillojë nga Safa e të mbarojë në Merva, ngase këtë formë na e mësoi Pejgamberi a.s., kur bëri saj'in e tij, duke filluar në Safa dhe duke mbaruar në Merva. Transmetohet se nga Xhabiri r.a., se Pejgamberi a.s., ka thënë: “Fillo me atë që ka filluar Allahu (Safanë).”⁸

9. Braktisja e gjërave të ndaluara gjatë kohës sa është në ihram

Gjatë kohës sa haxhiu është në ihram, në rast se vjen me ndonjë vepër si: parfumimi, veshja e rrobave të qepura, mbulimi i kokës apo fytyrës te meshkujt, apo mbulimi i fytyrës dhe vendosja e dorëzave te femra, prerja e thonjve, rruajtja apo shkurtimi i qimeve, gjuetia etj., në këtë rast haxhiu obligohet me therjen e kurbanit.



LEHTËSIMET E HAXHIT

Kur jemi te kjo pjesë, doemos duhet përmendim që Islami asnjëherë nuk vije me ndonjë obligim që është mbi kapacitetin e besimtarit. Kur na flet Allahu xh.sh. për këtë gjë thotë: “Allahu nuk e ngarkon askënd përtej mundësisë së tij.” (El Bekare, 286), ndërsa Pejgamberi a.s. ka thënë: “Feja është lehtësim.”⁹

Duke u nisur nga këto parime dhe nga vlera e besimtarëve tek Allahu, edhe në haxh kemi lehtësime, të cilat mund t'i theksojmë si në vijim:

1. Veshja e ihramit nga vendnisja e haxhiut

Esenca e veshjes së ihramit është në mikatet (vendveshjet) e ihramit, të cilat haxhiu nuk bën t'i kalojë pa ihram, sepse kalimi i tyre pa ihram obligon prerjen e kurbanit të vogël. Sipas dijetarëve lejohet që haxhiu ta vendos ihramin nga vendi i tij, madje kjo është edhe e preferuar të bëhet, nga ajo që transmetojnë dy sahabët e nderuar, Aliu r.a. dhe Abdullah bin Mesudi r.a..¹⁰

2. Lejimi i bartjes së haxhiut, i cili nuk mund të ecë gjatë saj'it

Ndër lehtësimet e haxhit është që u lejohet të sëmureve dhe atyre që janë të dobët shkuarja në Mina nga Muzdelifja para shumicës së njerëzve të tjerë.

Ecja e nxituar apo vrapimi mes Safasë dhe Merves është nga vaxhibet e haxhit që medoemos duhet kryer. Ai i cili është në gjendje të mirë, e bën këtë ecje, por ai i cili është i sëmure, lejohet që të bartet me karrocë apo të ngjashme në mënyrë që të kryej saj'in.

3. Kalimi i të dobëtëve dhe të sëmureve nga Muzdelifja për në Mina para të tjerëve

Ndër lehtësimet e haxhit është që u lejohet të sëmureve dhe atyre që janë të dobët shkuarja në Mina nga Muzdelifja para shumicës së njerëzve të tjerë, sipas asaj që transmetohet nga Abdullah bin Omeri, i cili vepronte të njëjtën dhe thoshte se këtyre ua ka lehtësuar Pejgamberi a.s. këtë gjë.¹¹

4. Gjuajtja e guralecëve në xhemeratet për tjetrin në rast vështirësie

Në rast se haxhiu është i dobët apo i sëmure, ose është fëmijë dhe frikësohet për veten apo shëndetin e tij-saj, lejohet që për të t'i gjuaj guralecët dikush tjetër që është i aftë dhe i fortë. Ky lehtësim është i transmetuar nga Pejgamberi a.s..

5. Lejohet për gratë me të përmuajshme që të mos e kryejnë tavafin e lamtumirës (tavaful veda).

Siç u sqarua më lartë, tavafi i lamtumirës është nga vaxhibet e haxhit, të cilat duhet kryer. Pra, nëse gruaja është në ciklin e saj të përmuajshëm, lejohet që të largohet nga Meka pa e kryer këtë tavaf, sepse ka arsye të justifikueshme, madje për këtë nuk obligohet as me therje të kurbanit. Këtë lehtësim e marrim nga hadithi që e transmeton Ibën Abasi, ku Pejgamberi a.s., ka urdhëruar haxhilerët që të jetë tavafi i lamtumirës momenti i fundit i tyre me Qabenë e shenjtë, veçse ka liruar prej tij gruan me cikël menstrual.^{12 13}

1 Hasen bin Ammar esh Shurunbulali, *Nurul Idah ve nexhatul ervah*, f. 322.

2 Abdulganij el Gunejmi el Hanefij, *El Lubab fi sherh el kitab*, f. 181.

3 Abdullah bin Mahmud el Musilij el Hanefij, *El Ihtijar li talil el muhtar*, f. 239.

4 Mustafa el Buga, *El Fikh el Hanefij bi ediletihi*, f. 754.

5 Burhanudin el Merginani el Hanefij, *El Hidaje*, f. 114.

6 Abdullah bin Mahmud el Musilij el Hanefij, *El Ihtijar li talil el muhtar*, f. 249.

7 Mustafa el Buga, *El Fikh el Hanefij bi ediletihi*, f. 775.

8 Është përmendur më herët.

9 Muhamed bin Ismail el Buhari, *Sahih el Buhari*, 145.

10 Është përmendur më herët.

11 Burhanudin el Merginani el Hanefij, *El Hidaje*, f.105.

12 Muhamed Abdullah bin Muslim el Behlevij, *Ediletu el Hanefije min el ehadith en Nebevijeh*, f. 421.

13 Muhamed bin Ismail el Buhari, *Sahih el Buhari*, 1775.

Vizito vendet ku shërohen plagët

(HAXHI - KUSHTI I PESTË I ISLAMIT)

Hfz. Emine Sopi

Po e fillojmë këtë trajtesë modeste më fjalën më të lartë të Allahut xh.sh., e që s'ka fjalë më të ngritur dhe madhështore se fjala e Tij: *“Koha e haxhit është në muaj të caktuar, kush vendos të kryejë haxhin le të largohet nga marrëdhëniet (me gruan) grindjet, sharjet, ndërkaq çdo vepër të mirë që bëni Allahu xh.sh. e di. Pajisuni më gjërat që ju nevojiten për rrugë dhe dijeni se pajisja më e mirë është devotshmëria, prandaj kini frikë prej Meje, o njerëz të mençur.”* (El Bekare, 197).

Në bazë të ajetit kuranor, vërejmë që haxhi kryhet në muaj të caktuar, në kohë të caktuar, në vend të caktuar. Duhet të theksohet, sepse edhe njerëzit janë të caktuar që në këtë vit

do të jenë “miq të Zotit” (*Dujufu-Rrahman*). Po ashtu, kuptojmë që ata besimtarë që kanë vendosur ta kryejnë kushtin e pestë të Islamit - haxhin, të përgatitën shpirtërisht, materialisht dhe fizikisht.

Brendësinë e çdo robi e di vetëm Zoti i gjithësisë, prandaj për të kapur këtë rrugëtim na duhet paraprakisht një pendim i plotë, pendim i sinqertë të Krijuesi ynë.

Allahu i Madhëruar e vlerësoi jetën, e cila është një dhunti shumë e shtrenjtë dhe e rëndësishme, e qe jeta në fakt është vetë koha. Koha varet si shpenzohet, si kalohet në këtë botë, por pa dyshim se ne duhet të japim llogari për të. Allahu xh.sh. në Kuran thotë: **“Pasha kohën!”** (El Asr, 1).



Zoti i gjithësisë nuk u betua në gjëra pa vlerë. Besimtarë e dinë se obligimet, të cilat jemi të urdhëruar për t'i kryer ndaj Zotit janë të lidhura ngushtë me kohën.

Ato janë: Namazi në pesë kohë të caktuara; agjërimi në muajin Ramazan; haxhi në kohë të caktuar.

Haxhi si kushti i pestë i fesë islame i obligohet çdo besimtari myslimanë, qoftë mashkull apo femër, i shëndoshë dhe i pasur. Natyrisht, të varfrit janë të liruar nga ky obligim, edhe pse gjithashtu edhe të varfrit kanë zemrat e lidhura me dashurinë ndaj Qabesë së bekuar.

Unë qysh si studente kisha kureshtje të madhe për vendet e bekuara, por thënë të drejtën në atë kohë s'kishim informacione si është rrjedha e kryerjes së haxhit, s'kisha eksperiencë dhe e kisha mësuar vetëm si teori. Duke e falënderuar Allahun xh.sh., i Cili më mundësoi dhe mu realizua një ëndërr e kamotshme, në vitin 2005 u bëra nënë e një fëmije, kurse në vitin 2007 ishte hera e parë që mu mundësua ta kryej haxhin për vete dhe njëkohësisht të jem udhëheqëse e gjinisë femërore, e që isha femra e parë që kisha thyer barrierat, një udhëheqëse në vendet perëndimore, përkatësisht në Zvicër, nën ombrellën e Bashkësisë Islame të Zvicrës së asaj kohe.

Në rrugë e sipër kuptova gjithçka se sa e vështirë kishte qenë shkuarja në haxh pa një udhëheqëse për gjininë femërore, e sidomos për organizatorët që udhëhiqnin të dy gjinitë. Por, edhe pse nuk ishte e lehtë për mua si udhëheqëse, e përballoja me të gjitha vështirësitë, me kënaqësi që po udhëhiqja një grup motrash që po kryenin urdhrin e Allahut.

Haxhi që po kryhej nga ana e gjinisë femërore për vite me radhë, mori jehonë të madhe dhe po rritej numri i të interesuarve të të gjitha moshave, dhe kështu po shuhej miti i vjetër i pakuptimtë se femrat nuk kanë nevojë për të shkuar apo për ta kryer haxhin.

“Shpejtoni në atë që ua mundëson të fitoni faljen prej Zotit tuaj dhe xhenetin sa gjerësia e qiejve dhe etokës.” (El Hadid, 21).

Nga ky ajet kuranor kuptojmë që Allahu i Madhëruar na këshillon që të nxitojmë pas

Aisheja r.a. e pyeti Pejgamberin a.s.: “Përse të mos vijmë edhe ne gratë me ju në luftë o i Dërguari i Allahut?”
Pejgamberi a.s. i tha asaj: “O Aishe, një haxh i pranuar është Lufta më e madhe.”

veprave të hairit, duke mos i vonuar dhe neglizhuar, siç është çështja e haxhit. Pra, të mos presim t'i kryejmë të gjitha punët e dynjasë e pastaj të shkojmë në haxh. Edhe as të mos frikë që pasi të kthehemi nga haxhi, mos a thua vallë nuk do të arrijmë ta ruajmë atë që e kryem. E as nuk duhet vonuar kohën e shkuarjes në ato vende të bekuara me ndonjë pretext se jam e sëmurë (nëse nuk jemi në atë masë që nuk arrijmë të kryejmë si duhet atë) ose e shtyrë në moshë, sepse, kështu na ngelë pa e kryer obligimin tonë hyjnor.

Aisheja r.a. e pyeti Pejgamberin a.s.: “Përse të mos vijmë edhe ne gratë me ju në luftë o i Dërguari i Allahut?” Pejgamberi a.s. i tha asaj: “O Aishe, një haxh i pranuar është Lufta më e madhe.”¹

Duke qenë për nëntë herë shoqëruese dhe udhëzuese e haxhilerëve, në një karvan prej 300 të tillë nga Zvicra, 100 prej të cilëve ishin femra ndiej se kjo detyrë hyjnore ka filluar të mirëkuptohet edhe nga femrat myslimane shqiptare në nivel të mirë.

VIZITA E PARË DHE PAMJA E QABESË SË SHENJTË

Madhështia e ëndrrës që po realizohej ishte kur për herë të parë e pamë Qabenë e shenjtë me sytë tanë. Të gjitha ngelëm të shtangura me shikimet drejt saj. Duke na rrjedh lotët dhe duke mos i besuar vetvetes, se mos ndoshta është vetëm një ëndërr. Por ja që në fakt ajo ishte një realitet që nga ne po përjetohej. Pa mos e lënë pa e përmend *telbijjen* e haxhit të cilën e pëshpëritnim të mahnitura: “*Lebbejke Allahumme lebbejke, lebbejke la sherike leke lebbejk, in el hamde veniâmete leke vel mulk, la sherike leke*” (Të përgjigjem o Zot, të përgjigjem, Ti je i Vetmi i pa shoq, vetëm Ty të përgjigjem, falënderimi të takon vetëm Ty! Të gjitha begatitë dhe e tërë pasuria janë Tuaja, Ti je pa rival!”), e cila kumbonte gjithandej nëpër hapësirat e vendeve të bekuara deri në kthimin tonë.

Te Qabeja ndjeva Mëshirën e Zotit. Aty pash barazinë e njerëzimit, në mes të gjithë njerëzve, sado e ultë qoftë pozita e tyre shoqërore. Që të gjithë qëndronin të radhitur në një saf. Aty dëgjova lirinë e lutjeve në të gjitha gjuhët dhe të gjithë



besimtarët me një synim dhe një qëllim vetëm, që Krijuesi të jetë i kënaqur me ta.

SAFA DHE MERVA

Safa dhe Merva e kishim të mësuar si teori, si një ngjarje interesante që ngërthente në vete mëshirën e Allahut xh.sh. ndaj krijesës. Në mes të atyre dy kodrinave ishte Haxhereja ajo e cila i kaloi ato në përpjekje për të gjetur ujë, për ta shuar etjen e birit të saj të vogël – Ismailit.

Për herë të parë kryem *sa'jin* (vrapimin në mes të Safas dhe Mervës), realisht në mënyrë fizike, dhe këtu vërtetohej sfida e një nëne, e cila jep gjithçka vetëm për ta shpëtuar fëmijën e vet.

Haxheren, siç dimë nga historia islame e mëshiroi i Madhi Zot, ku me urdhër të Tij zbriti Xhibrili a.s. dhe e çau tokën nga ku buroi uji i zemzemit. Nga po ai burim me miliona haxhilerë nga e gjithë bota pinë prej atij uji të bekuar dhe natyrisht se ai kurrë njëherë nuk u shter.

DITA E ARAFATIT – FARZI KRYESOR I HAXHIT

Dite e Arafatit me të vërtetë i përngjanë Ditës së Ringjalljes. Aty, të gjithë haxhilerët meshkuj vishen me ihrame të bardhë, duke iu nënshtruar vullnetit të Zotit, përgjigjur urdhrit të Tij, duke iu përgjëruar Atij për çdo nevojë që ata kanë në jetën e tyre. Secili prej tyre e di që kodra e Arafatit është kodra e mëshirës, dhe se mëshira e Allahut për të falur është më afër se në çdo vend tjetër.

Kodra e Arafatit rrëfen për zanafillën e njerëzimit, ku Allahu i Madhëruar i mëshiroi Ademin a.s. dhe Havanë r.a., duke i takuar mes vete. Po aty në Arafat, zbriti edhe ajeti i fundit nga Kurani fisnik. Aty afërsisht u kompletua shpallja hyjnore.

Në vitin 2015, në njërën nga vizitat në haxh takova një grua dhe më pyeti se prej nga vijë, një myslimane që vinte nga Zelanda e Re. Më tregoi se kishte ardhur një grup prej 19 hanxhinjve. Mbete e stepur kur ajo më tha se a e dini ju se çfarë largësie kemi ardhur? Ne, më tha, kemi ardhur nga një vend ku ndahen dita edhe nata!

Të dashura motra, mos harroni se Allahu na urdhëron në ajetin kuranor, që i drejtohet Ibrahimit a.s. dhe i thotë: ***“Dhe thirr ndër njerëz për haxhin, se të vijnë ty këmbësorë e edhe kalorës me deve të rraskapitura që vijnë prej rrugëve të largëta.”*** (El Haxh, 27). Të gjithë myslimanët e myslimanet që kanë mundësi të kryejnë haxhin kur të dëgjojnë këtë thirrje fisnike, duhet me dashuri t'i përgjigjen Allahut – Krijuesit tonë Fuqiptotë. Ne edhe në realitet e shohim se ky ajet jetësohet, ku vijnë njerëz nga katër anët e globit në shenjë dashurie e nënshtrimi ndaj Allahut.

Në fund duhet thënë se që të përshkruash madhësinë e haxhit, respektivisht për eksperiencën atje, duhet të shkruhen libra të tëra e nuk mjaftojnë. Megjithatë, unë jam munduar që në pika të shkurtra t'i paraqes disa momente më kryesore nga eksperiencia ime personale.

Këtij shkrimi ja bashkëngjis lutjen dhe apelin motrave kudo që janë dhe që e ndiejnë vetën besimtare, të marrin guximin e të shprehin gatishmëri në suaza të mundësive të tyre e ta kryejnë haxhin. E lus Allahun që t'ua mundësoj të gjithë besimtarëve e besimtareve që t'i vizitojnë vendet e shenjta.

1 Evidenton Buhariu në Sahihun e tij.

Vështrim i shkurtër i librave të veçantë të haxhit në medhhebin hanefi

Mr. Hazir Selmani

HYRJJE

Në medhhebin hanefi gjejmë një shumëllojshmëri të madhe librash fikhor. Fillimisht u shkruan librat e llojit “Dhahiru’r rivajeh” (shq.: Transmetimet me komunikim masiv), “El Nevadir” ose “Nadiru’r rivajeh” (Transmetimet me komunikime të rralla), “El Emali” (shq.: diktimet). Pastaj në skenë dolën edhe dy lloje të tjerë librash: lloji i librave koleksion fetvash “El Vakiaat” (shq.: Vakitë) ose “El Fetava” (shq.: Fetfatë) si dhe lloji i librave “El Mutun” (shq.: doracakët ose manualët). Librat “El Mutun” me automatizëm

Autori i parë i kësaj fushe është vetë Ebu Hanifeja edhe pse për fatin e kësaj shkrese-diktimi nuk dihet gjë.

nxorën në skenë llojin e librave “El Shuruh” (shq.: komentet) dhe pastaj llojin tjetër që njihen si “El Havashi” (shq.: glosë ose mbikoment). Shumica e këtyre llojeve librash përfshijnë tërë kapitujt e fikhut, pra edhe vetë kapitullin e haxhit. Pastaj, me kalimin e kohës ishte më se e nevojshme që për disa kapituj të fikhut të shkruhen libra të posaçëm, ku do të trajtoheshin herë-herë më imtësisht e herë-herë të tjera më sipërfaqësisht. Për shembull libri “Munjetu’l-Musali” trajton vetëm kapitullin e pastërtisë dhe atë të namazit, libërthi i Mejdanit me titull “El Metalibu’l mustetaabeh” trajton të përmuajshmet e

grave, libri i Nabulusit me titull “Sad’hu’l hamameh” trajton vetëm shartet e imamllekut, libri i Birgiviut me titull “Muaddilu’s Salat” trajton meselenë e ta’dilit namazor (qetësisë së disa pjesëve namazore), etj.. Kështu në këtë formë shumë herët nisi edhe shkrimi i librave të veçantë për haxhin dhe ky zhanër librash si zakonisht njihet me emrin “El Menasik” (shq.: ritualet).

LIBRAT E VEÇANTË TË HAXHIT TE BREZAT E PARË TË DIJETARËVE HANEFI

Sajmeriu dhe Havarizmi shënojnë se kur u nis E’ameshi (vd. 148 hixhri) - dijetar shumë i madh - për në haxh, ai i kërkoi njërit prej nxënësve të Ebu Hanifes që të kthehej në qytet dhe t’i kërkonte Ebu Hanifes që t’ia shkruante E’ameshit “Menasik-ët” (ritualet e haxhit), e që Ebu Hanifeja ia diktoi ato dhe nxënësi në fjalë ia solli E’ameshit.¹ E pra, nga kjo del se autori i parë i kësaj fushe është vetë Ebu Hanifeja edhe pse



për fatin e kësaj shkresë-diktimi nuk dihet gjë. Vite më vonë, nxënësit e Ebu Hanifes, konkretisht Ebu Jusufi dhe Shejbani u kujdesën që fikhu i mësuesit të tyre të regjistrohej në letër. Shejbani shkroi një libër të posaçëm për këtë fushë me titullin “*El Menasik*”, i cili libër më vonë u kthye në njërin prej kapitujve të librit të madh *El Asël* (ose *El Mebsut*) të Shejbanit. Mirëpo, sot kapitulli *El Menasik* i veprës *El Asël* nuk i ka mbijetuar dot kohës. Fatmirësisht versioni i shkurtuar i këtij kapitulli ndodhet në gjitha dorëshkrimet e veprës monumentale “*El Kafi*” të Hakim Shehidit. Xhesasi në fillim të kapitullit të haxhit, gjersa komenton Muhtesarin e Tahaviut deklaroi se meseletë e këtij kapitulli edhe më detajisht i ka sqaruar në veprën “*Sherhu’l-menasik li’sh Shejbani*” (shq.: *Komenti i librit të Shejbanit mbi ritalet e haxhit*).² Në disa burime Shejbanit i atribuohet edhe libri “*Kitabu’l Haxh*” dhe cilësohet si një libër që në vete ngërthente shumë libra (kapituj) të tjerë dhe të cilin Shejbani e pati diktuar (publikuar) para medinasëve.³ Tani nuk është shumë e sigurt se a flitet për të njëjtin libër paraprak a jo, edhe pse Ibën Nedimi i numëron si dy libra! Hasafi (vdiq 261 hixhri) pati shkruar veprën e madhe “*El Menasik*”, që u zhduk në ditën e plaçkitjes së shtëpisë së tij.⁴ Ibën Thelxhi (vdiq 266 hixhri) shkroi librin e tij të madh “*El Menasik*” me mbi 60 pjesë.⁵ Tahaviu shkroi veprën me titull “*El Kiran*” (shq.: *Haxhi Kiran*) me rreth 1 mijë fletë, e që sipas Ijadic dhe Neveviut vlerësohet si libri më i madh i kësaj tematike.⁶ Këta ishin librat e veçantë të dijetarëve të hershëm hanefi rreth haxhit. Mjerisht, të gjitha veprat në fjalë llogariten të zhdukura. Ndërsa prej këtyre brezave të hershëm fatmirësisht tematika e haxhit ekziston si kapitull i inkorporuar me kapitujt e tjerë të fikhut, e trajtuar në *muhtesarët* e parë fikhor si ai i Tahaviut, Kerhit, Kuduriut, etj.. Pastaj në komentet e parë fikhor si ato të Xhesasit, Kuduriut, etj..

LIBRAT E VEÇANTË TË HAXHIT TE BREZAT E MËVONSHËM TË DIJETARËVE HANEFI

Pastaj dijetarët hanefi vijuan ta trajtojnë këtë temë herë bashkërisht me temat e tjera të fikhut e herë ndaras. Nga fundi i shekullit VI hixhri e këtej kemi një vrull të madh të këtij

zhanri librash të hanefive, si për nga numri, ashtu edhe për nga vëllimi. Ja disa prej tyre:

1. Merginani (vdiq 593 hixhri) autori i kryeveprës *El Hidaje*, shkroi një libër të zgjeruar rreth haxhit me titull “*Uddetu’n Nasik fi Iddeti’l menasik*”, për të cilin libër në *El Hidajeh* gjersa flet për lutjet në Arafat thotë se, detajet e tjera rreth këtyre lutjeve i ka shkruar në librin e sipërthënë. Ky libër tani për tani llogaritet i zhdukur.

2. Zejnudin Kermani (lexohet edhe Kirmani, vdiq 597 hixhri) shkroi të paktën dy libra të mëdhenj mbi këtë tematikë. Njëri mban titullin “*El Menahixh fi Menasiki’l Haxh*” dhe tjetri mban titullin “*El Mesalik fi’l Menasik*”, që nga autori cilësohet si *muhtesar* (shq.: *Përmbledhje e shkurtër*) dhe është botuar në afër 1400 faqe me gjithë shënimet e muhakikut. Kurashiu këtë librin e fundit e cilëson me fjalët: “*Një vëllim shumë i madh e me shumë dobi*”. Ndërsa, mulla Ali Lexuesi e cilëson: “*Libër njëvëllimësh me vlera të mëdha dhe shumë përfitime të çmuara*.”⁷

3. Shihabudin Fadlullah Turibishti (vdiq 661 hixhri) shkroi librin e tij me titull “*Metlebu’n Nasik fi ilmi’l Menasik*” në 40 kapituj me stil të librave të hadithit. Së fundmi është botuar në Britani në një vëllim të madh me afër 1 mijë faqe.

4. Shemsudin Serruxhi (vdiq 710 hixhri) shkroi një libër shumë të rëndësishëm me titull “*Menasik el Haxh*” prej të cilit citojnë shumë dijetarë. Fatmirësisht ekziston si dorëshkrim.⁸

5. Alaudin Farisiu (vdiq 739 hixhri dhe është nxënës i Serruxhit) rënditësi i Sahihut të Ibën Hibanit dhe Mu’xhemit të Taberaniut, i njohur më shumë si Ibën Belban, shkroi librin e tij të famshëm “*Umdetu’s-Salik fi’l-Menasik*” që nga Lekneviu cilësohet si një punim që ngërthen mesele të shumta.⁹ Së fundmi është botuar në Stamboll në 800 faqe. Ibën Belbani ynë nuk duhet ngatërruar me Ibën Belbanin e hanbelive, i cili po ashtu shkroi një libër me titull “*Menseku Ibën Belban*”.

6. Havarizmi (lexohet edhe Havarazmi dhe Harizmi¹⁰, vdiq 827 hixhri) shkroi librin “*Itharatu’t tergib ve’t teshvik ile’l mesaxhidi’t thelatheh ve’l Bejti’l atik*”, i njohur ndryshe si “*Menasiku’l Havarizmij*”. Libri ka rreth 440

Tahaviu shkroi veprën me titull “*El Kiran*” (shq.: *Haxhi Kiran*) me rreth 1 mijë fletë, e që sipas Ijadic dhe Neveviut vlerësohet si libri më i madh i kësaj tematike.



faqe dhe flet kryesisht mbi vlerën e vizitës së tri xhamive (Mekës, Medinës dhe Kudsit), ku në rreth 370 prej tyre flet mbi vizitën e Qabesë dhe Xhamisë së Pejgamberit salallahu alejhi ve selem, ku shumë bukur gërsheton edhe çështje fikhere dhe lutje të ndryshme që ndërliidhen me këta udhëtime.

7. Kadiu i shquar hanefi i Mekës, Ibën Dija Mekiu (vdiq 854 hixhri) në moshën 24 vjeçare¹¹ nisi me shkrimin e librit të tij të madh të haxhit me titull “*El Bahru’l Amik fi menasiki’l mu’temiri ve’l haaxhi ila Bejti’l Atiik*”. Tani për tani kjo vepër besohet si njëra ndër më të mëdhatë në medhhebin hanefi, si dhe më gjithëpërfshirëset e kësaj tematike. Para rreth një dekade është botuar (me gjitha shënimet e muhakikut) në 3 mijë e 300 faqe. Imagjino!

8. Fakihu i shquar hanefi, Ibën Emir Haxh Halebiu (vdiq 879 hixhri) shkroi librin “*Daaiju menari’l Bejan*”, i cili libër së fundmi është botuar në Angli në rreth 180 faqe.

9. Kutbudin Mekij Nehrali (vdiq 990 hixhri) fillimisht shkroi një libër të madh mbi haxhin dhe pastaj pas disa kërkesash ai nxori nga libri në fjalë një libër tjetër vetëm me duatë e haxhit-umres,¹² i cili është i botuar bashkërisht me *Mensek-un* e mulla Aliut. Ndërsa për librin e tij të madh të haxhit nuk dihet gjë se a ekziston më si dorëshkrim a jo!

10., 11. dhe 12. Rahmetullah Sindi (vdiq rreth vitit 993 hixhri dhe ishte mik i ngushtë i Muteki Hindiut) shkroi të paktën tre libra shumë të rëndësishëm e të njohur mbi haxhin. Në dy prej tyre trajtoi detajisht haxhin e sidomos meseletë që ndodhin shpeshherë dhe që ka nevojë për një përgjigje. Libri i madh i tij i haxhit quhet “*El Mensek el Kebir*” dhe “*Xhemu’l Menasik ve Nefu’n Nasik*”. Shkak këtij libri ai njihet si “Autori i Mensekut”. Këtë libër e përfundoi në Medine rreth vitit 950 hixhri. Pastaj, libri i mesëm i shkurtuar nga libri i parë dhe që është sa 1/3 e tij mban titullin “*El*

Menseku’l Mutevesit” ose “*Lubabu’l Menasik ve Ubabu’l Mesalik*”. Shkurt njihet si “*El Lubab*” dhe gëzoi kujdesin më të madh të dijetarëve me shkrimin e dhjetëra *muhtesar-e* dhe *shuruh-e*. Libri i tij i vogël mban titullin “*El Menseku’s Sagir*”. Libri i tij i madh i haxhit dhe ai i mesëm llogariten ndër më të mirët e kësaj fushe në medhhebin hanefi. Të tre veprat në fjalë janë të botuara, mirëpo me botim shumë të vjetër. Rahmetullah Sindi jetoi herë në Mekë dhe herë Medine edhe atë për shumë vite.

13. dhe 14. Pastaj, mulla Ali Lexuesi (vdiq 1014 hixhri) shkroi disa libra rreth kësaj tematike. Këtu do të flitet shkurtimisht për dy komentet e tij mbi librin e dytë (të mesëm) të Sindit dhe atë të vogël. Komentin e librit të mesëm e titulloi “*El Mesleku’l Mutekasit fi sherhi’l menseki’l mutevesit*” dhe llogaritet si njëri ndër librat më të mirë të kësaj fushe. Ndryshe njihet edhe si “*Menasik Mulla Ali*”. Ndërsa komentin 60 faqesh të librit të vogël të Sindit e titulloi “*Bidajetu’s Salik fi nihajeti’l mesalik*”.¹³ Ky vlerësim vjen për faktin se mulla Aliu ishte dijetar i madh hanefi në të gjitha shkencat islame, sidomos në fikh dhe hadith. Pastaj jetoi dhe veproi në Mekë, e që po të shikohen me vëmendje librat e haxhit të atyre dijetarëve që jetuan dhe vepruan në Mekë ose Medine janë më të zgjeruar dhe më të mirë për shumë arsye si: vënia në praktikë e haxhit pastaj takimi me shumë dijetarë të botës që vinin për haxh e umre, etj.. Fatmirësisht të dy librat në fjalë janë të botuar.

15. Ibën Imadi (vdiq 1008 hixhri) shkroi librin e tij “*El Musteta’ min’e’z zad li efkari’l ibad*”. Libër i vogël për nga vëllimi (rreth 100 faqe), mirëpo shumë i rëndësishëm për nga meseletë, të cilat mesele nuk gjendet edhe në shumë libra të zgjeruar fikhor, siç shprehet vetë autori.¹⁴

16. Nabulusiu (vdiq 1143 hixhri) shkroi librat: “*El Ibtihaxh fi Menasiki’l Haaxh*” mbi etapat dhe duatë e haxhit dhe zijaretit të Pejgamberit salallahu alejhi ve selem. “*Tuhfetu’n*



Nasik fi bejani'l Menasik” për hukmet që duhen ditur nga secili haxhi. Fatmirësisht të dy veprat ekzistojnë.

17. Gymyshhaneviu (vdiq 1311 hixhri) shkroi librin e tij të shkëlqyer mbi haxhin me titull “*Xhamiu'l menasik ala ahseni'l mesalik*”. Fatmirësisht është i botuar. Ka një gjuhë të lehtë fikhore.

LIBRAT E VEÇANTË TË HAXHIT TE DIJETARËT BASHKËKOHORË HANEFI

Disa prej dijetarëve bashkëkohorë hanefi që kanë shkruan libra të veçantë për haxhin janë: Abdulkadir Ed'hemij Tarabulusi (vdiq 1325 hixhri/1907 gregorian) shkroi librin “*Hedijetu'n Nasik ve Hidajetu's Salik*”; Muhamed Seid Burhanij (vdiq 1386 hixhri/1967 gregorian) shkroi librin e tij “*El Haxh*”, i biri i Ebu'l-Jusër Abidinit shejh Muhamedaziz Abidini (vdiq 1405 hixhri/1985) shkroi librin “*Irshadu's Salik li Ahkam'l Menasik*”, Kandihleviu ose Kandeheleviu (vdiq 1402 hixhri/1982 gregorian) shkroi librin e tij “*Haxhetu'l Veda'e*”, myfti Ibrahim Selkini (vdiq 1432 hixhri/2011 gregorian) shkroi librin “*Menasiku'l Haxhi ve'l umrati ve zijarati'n Nebij*”, shejh Gavoçi (vdiq 1434 hixhri/2013 gregorian) shkroi librin e tij “*El Haxhu ve ahkamuhu*”, imami i xhamisë Emevite të Damaskut, shejh Ešad Sagarxhiu (vdiq 1436 hixhri/2015 gregorian) shkroi librin “*El Haxhu ve'l Umratu ila Bejti'l Lahi'l haram*”, dr. Nurudin Itër (vdiq 1442 hixhri/2020 gregorian) shkroi librin e tij “*El Haxhu ve'l Umratu fi'l fikh'i'l islamij*”, dr. Ahmed el Haxhi el Kurdi shkroi librin “*El Duraru'l Hisan fi Ahkami'l Haxhi ve'l Umrati ala medhhebi'l imami Ebi Hanifete'n Nu'man*”, dr. Salah Ebu'l Haxh shkroi librin e tij “*Delilu menasiki'l umrati ala medhhebi'l hanefijeh*” etj..

Kjo ishte një pasqyrë fillestare që hedh pakëz dritë mbi një numër të konsiderueshëm librash hanefite të këtij zhanri të bukur fikhor.

Sipas hulumtimeve tona fillestare vetëm në arabisht numri i librave të veçantë të haxhit në fikhun hanefi shkon mbi 120. Ky numër sigurisht se është edhe më i madh. Në këtë hulumtim shkurtimisht u përmendën 36 libra të veçantë të fikhut hanefi për haxhin, ku 26 prej tyre ekzistojnë.

Falënderuar qoftë Allahu, ndërsa salavati qoftë për Pejgamberin a.s.!

- 1 Sajmeri, *Ehbaru Ebi Hanifeh ve es Habih*. (Rijad: Alemu'l-kutub, botimi i dytë, 1985), fq. 78; Ebu'l Muejjed Havarizmi, *Xhamiu'l mesaniid*. (Bejrut: Dki, pa vit botimi), vëll. 1, fq. 26.
- 2 Hazir Selmani, *Tre shekujt e parë të medhhebit hanefi (historiku, personalitetet dhe literatura)*. (Prishtinë: Fakulteti i Studimeve Islame, tezë masteri e pabotuar, 2024), fq. 102.
- 3 Shiko: Ibën el Nedim, *El Fihrist*. (Londër: Al Furqan Foundation, 2009), vol. 2, fq. 23; Katip Çelebi, *Keshfu'dh-Dhunun an esamij el kutubi ve'l funun*. (Bejrut: Daru ihjai't turathi'l arabij, pa vit botimi), vëll. 2, fq. 1411.
- 4 *Tre shekujt e parë të medhhebit hanefi (historiku, personalitetet dhe literatura)*, fq. 65.
- 5 Po aty, fq. 67.
- 6 Po aty, fq. 82.
- 7 Shiko: Zejnudin Kirmani, *El Mesalik fi'l Menasik*. (Bejrut: Daru'l beshair, botimi i parë, 2003), vëll. 1, fq. 148; Abdulkadir el Kurashi, *El Xhevahiru'l mudijeh fi Tabekati'l Hanefijeh*. (Rijad: Hexhr, botimi i dytë, 1993), vëll. 3, fq. 373; Ali Lexuesi, *El Ethmaru'l xhenijeh fi esmai'l hanefijeh*. (Bagdad: Divanu'l vakfi's-sunij, botimi i parë, 2009), vëll. 2, fq. 630.
- 8 Shiko: *El Ethmaru'l xhenijeh fi esmai'l hanefijeh*, vëll. 1, fq. 307-308; Grup autorësh, *Hyrja studimore e veprës El Gajeh fi sherhi'l Hidajeh* (Kuvejt: Esfar li'n neshri nefisi'l kutub, botimi i parë, 2021), fq. 82.
- 9 Abdulhax el Leknevi, *El Fevaudu'l Behijeh*. (Kajro: daru'l-kitabi'l-islamij, pa vit botimi), fq. 119.
- 10 Shiko: *El Ethmaru'l xhenijeh fi esmai'l hanefijeh*. Vëll. 2, fq. 739.
- 11 Ibën Dija Meki, *El Bahru'l Amik*. (Mekë: Muesetu'r rajan, botimi i dytë, 2011), vëll. 1, fq. 51.
- 12 Shiko: Kutbudin Hanefi Nehrauali. *Edijetu'l haxhi ve'l umrati*. (Mekë: Metbeatu't Terakij, botimi i parë, 1910, glosë i Mensek-ut të mulla Ali Lexuesit), fq. 3.
- 13 Komenti i vogël është botuar si *risaleja* nr. 40 në koleksionin “*Rasail Mulla Ali el Karij*” në vëllimin 3, fq. 455-519.
- 14 Shiko: Ibën el Imad, *El Musteta'e mine'z zad*. (Bulak: El Metbeatu'l emirijeh, botimi i dytë, 1895), fq. 3.

Kurbani – urtësitë dhe dispozitat e tij

Mr. Ekrem Maqedonci

Kurbani është një prej ibadeteve ose Kadhurimeve nëpërmes së cilit besimtarët synojnë ngritjen e devotshmërisë dhe afërsinë e tyre me Zotin xh.sh.. Kurbani ekziston që nga koha e Ademit dhe bijve të tij, por që nga koha e Ibrahimit merr tjetër tretman. Legjitimiteti i tij u përforcua edhe më shumë për Muhamedin a.s. dhe për pasuesit e tij, deri në Ditën e Gjykimit.

Nëse shikojmë ndodhinë e Ibrahimit a.s. me birin e tij Ismailin a.s., e kuptojmë se ai ishte në gjendje ta flijojë edhe djalë apo birin e tij, vetëm e vetëm për të shprehur gatishmërinë për sakrificë për hir të Zotit xh.sh., qoftë edhe me njeriun më të dashur të tij, birin e tij.

Rëndom Zoti xh.sh. nuk deshi një punë të tillë, sepse obligimet fetare nuk janë barrë që rëndojnë supet e peygamberëve dhe gjendjen e besimtarëve, por deshi që të na tregoi neve se peygamberët e Zotit, që ju besimin në ta e keni pjesë të imanit tuaj, e pasimin e tyre e keni pjesë të Islamit tuaj, marrjen e cilësive të tyre e keni pjesë të personalitetit tuaj, për të zbatuar urdhrat e Zotit kanë qenë në gjendje të sakrifikojnë edhe evladët e tyre, e lëre më gjërat materiale, vetëm për ta shprehur respektin maksimal për zbatimin e urdhrave të Zotit xh.sh..

Prandaj, edhe ne si besimtarë dhe pasues të profetëve, në asnjë mënyrë, nuk guxojmë ta vëmë në mëdyshje therjen e një shtaze për

Kurbani është një prej ibadeteve ose adhurimeve nëpërmes së cilit besimtarët synojnë ngritjen e devotshmërisë dhe afërsinë e tyre me Zotin xh.sh..

kurban, ngase kështu edhe ne shprehim gatishmërinë tonë për sakrificë për hir të Allahut të Madhërisë, ashtu si shprehën gatishmërinë edhe peygamberët tonë që ne i besojmë dhe i pasojmë.

Norma e therjes së kurbanit

Kurbani është obligim (vaxhib) për çdo besimtar mysliman, moshërritur, mentalisht i shëndoshë, dhe që ka mundësi materiale aq sa me prerjen e kurbanit nuk rrezikon buxhetin e nevojshëm të familjes së tij.¹ Allahu xh.sh. në Kuran thotë: **“Falu dhe therë kurban për hir të Zotit tënd!”** (El Kevther, 02).

Po ashtu edhe Peygamberi a.s. në hadithin e transmetuar nga Ebu Hurejreja r.a. kishte thënë: **“Kush ka mundësi për të ther kurban dhe nuk ther kurban, as Bajramin mos të vije për ta falur.”**²

Andaj, siç kuptohet nga ajeti dhe hadithi i lartpërmendur, therja e kurbanit mbetet një nga obligimet (vaxhibet) e besimtarit. Dhe rëndom, nëse dikush ka mundësi për të ther kurban dhe nuk e ther atë, ai bën mëkat, dhe konsiderohet se pa arsye ka anashkaluar respektimin e këtyre urdhrave nga Zoti dhe i Dërguari i Tij.

URTËSITË E THERJES SË KURBANIT

Edhe kurbani (ngjashëm si adhurimet e tjera), në vetvete ngërthen urtësi, të cilat



realizohen pas manifestimit të tij. Ndër ato urtësi që mund të theksojmë për kurbanin janë:

Falënderim për Zotin për begatitë dhe mirësitë e Tij. Sa herë që besimtari shpenzon diçka për hir të Zotit, apo sakrifikon diçka materiale për hir të Zotit, konsiderohet edhe falënderim për Të, ngase e ndien në shpirtin e tij se edhe ai duhet të bëjë mirë, pasi që Zoti i ka bërë mirë atij. E blerja e kurbanit, derdhja e gjakut të tij, pastaj shpërndarja e një pjese të mishit të tij, rëndom konsiderohet falënderim për Allahun xh.sh., për begatitë e dhuruara prej Tij.

Shpresa për faljen e mëkateve. Kjo urtësi konkludohet nga ajo që transmetohet nga Pejgamberi a.s., se i kishte thënë Fatimes r.a.: “Shko dhe prezanto kur të theret kurbanit yt, se vërtet me rënien e pikave të para të gjakut të kurbanit, të falen mëkatet e veprimeve tua.”³

Ringjallja e një sakrifice dhe simbolike të madhe që e ka bërë Ibrahim a.s.. Për një gjë të tillë, Pejgamberi a.s., i porosiste shokët e tij duke u thënë: “Preni kurban, se prerja e kurbanit është synet i prindit tuaj, Ibrahim a.s..”⁴

Përkujdesja për të varfrit në ato ditë të festës së Bajramit. Vërtet shpërndarja e një pjese të kurbanit për të varfrit dhe skamnorët në atë ditë, konsiderohet një prej veprave të çmuara për besimtarët. Përveç që kryejmë obligimin tonë para Zotit, kryejmë edhe një obligim ndaj atyre që sofrat e tyre janë të varfra në këtë ditë të bekuar.

KOHA E THERJES SË KURBANIT

Koha e therjes së kurbanit është pas faljes së namazit të Bajramit, dhe vazhdon deri në

fund të ditës së tretë të Bajramit. Lejohet prerja e kurbanit para faljes së Bajramit vetëm për ata persona, të cilët nuk mund të prezantojnë na namazin e Bajramit, (ose nuk e kanë obligim namazin e Bajramit) ngase prerja e kurbanit këta persona nuk i pengon nga përgatitja për namaz.

Kushtet që duhet t'i plotësoj shtaza për t'u pranuar për kurban

Për të qenë një kafshë e pranuar për kurban, patjetër që duhet të plotësohen disa kushte, e të cilat janë:

Që të jetë shtazë e butë shtëpiake. Kurban patjetër duhet të jetë një nga shtazët shtëpiake e të cilat mishin e kanë të lejuar për besimtarin. Në këtë kuadër hynë deveja, buallica, lopa, delja dhe dhia. Nuk lejohen shtazët e egra, si dhia e egër, dreri e të ngjashme, edhe nëse arrijmë t'i kapim ato në kohën e prerjes së kurbanit.

Që shtaza të ketë arritur moshën e caktuar. Deveja duhet t'i ketë së paku 5 vjet, lopa 2 vjet, dhia 1 vjet, dhe delja së paku 6 muaj nëse është e shëndoshë dhe nuk dallohet nga kopeja për nga zhvillimi fizik i saj.

Që shtaza të jetë pa të meta fizike. Kafsha e dedikuar për kurban nuk guxon të jetë e sëmurë ose me të meta të dukshme. Kështu që shtaza që është e verbët në një ose në dy sy, ajo që i mungon më shumë se gjysma e veshit, ose i mungon më shumë se gjysma e bishtit, ajo që i ka brirët e thyer, ajo që i ka të gjithë ose më shumë se gjysmën e dhëmbëve të rënë, ajo që është dukshëm e ligë, ajo që shqepon (që është e çalë), ajo që nuk mund të shkon deri te vendi i therjes me këmbët e veta, ajo që

Koha e therjes së kurbanit është pas faljes së namazit të Bajramit, dhe vazhdon deri në fund të ditës së tretë të Bajramit.

shihet dukshëm se është e sëmurë, e të ngjashme nuk bënë të prehen për kurban.⁵

Thënë më thjesht, sipas juristëve islamë, çdo e metë e cila ia ulë çmimin dhe vlerën shtazës në treg e bën atë shtazë të papranueshme për kurban, dhe çdo e metë e lehtë, e cila nuk ndikon në vlerën dhe uljen e çmimit të shtazës në treg, nuk është pengesë që ajo shtazë të bëhet nijet për kurban.

PËR SA PERSONA VLEN KURBANI

Kafshët e mëdha, siç janë devetë, buallicat dhe lopët, vlejnë deri për shtatë persona, me kusht që të gjithë ta kenë nijetin e kurbanit kur e therin atë shtazë. Lejohet të jenë më pak se shtatë nëse kanë mundësi dhe dëshirë për një kurban të tillë, por nuk lejohet që të jenë më shumë se shtatë pjesëmarrës në therjen e atij kurbanit.

Ndërsa kafshët e vogla, si delja dhe dhia, vlejnë vetëm për një person, ose për një familje nëse anëtarët e asaj familje nuk kanë mundësi të therin më shumë se një kurban. Transmetohet se Muhamedi a.s., kur kishte therur kurban kishte thënë: “O Zot, pranoje prej Muhamedit dhe familjes së Tij dhe prej gjithë besimtarëve!”⁶

SHPËRNDARJA E MISHIT TË KURBANIT

Preferohet që mishi i kurbanit të ndahet në tri pjesë: Një pjesë t’u shpërndahet familjeve të varfra apo skamnoreve, një pjesë t’u ndahet të afërmeve, fqinjëve dhe fafesisit, dhe një pjesë të lihet për familje në mënyrë që edhe familjarët të hanë nga mishi i atij kurbanit dhe ta përfetojnë gëzimin e prerjes së kurbanit.⁷ Allahu xh.sh. në Kuran thotë: “**Dhe hani prej mishit të tyre (të kurbanit) si dhe ushqeni nevojtarin e të varfrin!**” (El Haxh, 28). Po ashtu edhe Pejgamberi a.s., ka thënë në një hadith: “**Hani, ushqeni të tjerët dhe konservoni për vete.**”⁸

Autorizimi i institucionit të BIK-ut për therjen e kurbanit

Nëse besimtari për ndonjë arsye të tij nuk ka mundësi ta ther kurbanin, ose edhe ballafaqohet me vështirësi për një gjë të tillë, atëherë lejohet që t’i autorizojë organet e BIK-ut që ata ta bëjnë therjen e kurbanit dhe shpërndarjen e mishit të tij.

Në këtë rast, autorizimi që bëhet në Kryesinë e BIK-ut, apo në këshillat dhe xhamitë në teren, duke bërë pagesën e kurbanit, është një lehtësim shumë i madh për disa arsye:

Shumë prej qytetarëve sot banojnë brenda në qendra të qyteteve dhe në ndërtesa shumëkatëshe, e që qendrat dhe apartamentet e tilla e pamundësojnë një veprim të tillë.

Shumë prej qytetarëve sot, nuk kanë nevojë fare për mishin e kurbanit dhe as që e dëshirojnë atë, e një autorizim i tillë do t’ua mundësonte atyre ta kryejnë obligimin e tyre para Zotit në mënyrë më të lehtë të mundshme.

Me një pjesë të atij mishi do të ushqehen nxënësit e Medresesë, që në të ardhmen do jenë kuadro të cilët do t’i shërbejnë këtij vendi dhe kështu edhe do të forcohet institucioni ynë, i cili me përkushtim të madh i shërben popullit dhe besimtarëve të këtij vendi.

Në anën tjetër, BIK, me gjitha institucionet e saj ka një përvojë të madhe në prerjen e kurbanit. Nën ombrellën e saj funksionin edhe Shoqata Humanitare “Bereqeti”, e cila me besnikëri të madhe kryen amanetin nga qytetarët tanë.

DISA RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR PRERJEN E KURBANIT

Të përmendet emri i Allahut xh.sh. para therjes së kurbanit, duke thënë thuhet “**Bismillah, Allahu Ekber.**” Allahu xh.sh. ka thënë: “**Mos hani nga ajo që (para therjes) nuk është përmendur emri i Allahut xh.sh., sepse vërtet ajo është mëkat.**” (El Enam, 121).

Mos të përfitohet asgjë nga kurbanit, madje as nga lëkura e tij. Lëkura e kurbanit nuk duhet të shitet e as t’i jepet therësit si pagesë për punën e tij. Pejgamberi a.s. ka thënë: “**Kush e shet lëkurën e kurbanit, ai nuk ka kurban.**”⁹

Mundësisht mos të lihen mbeturinat e kurbanit (si stomaku, zorrët, gjaku) skaj rrugëve dhe vendeve publike, ku më pastaj kundërmimi i erës dha papastërtia do t’i pengonte banorët e atij vendi. Preferohet që gjaku dhe mbeturinat të futen në dhe, nëse ka mundësi, duke u mbështetur në argumentet e përgjithshme për ruajtjen e pastërtisë.

Të mprehët mjeti i therjes para therjes së kurbanit. Pejgamberi a.s. ka thënë: “**Kur ndokush dëshiron të ther kurban, le ta mpreh mirë shpatën e tij, e mos ta maltretoj shtazën e tij.**”¹⁰

Mundësisht mos të lihen mbeturinat e kurbanit (si stomaku, zorrët, gjaku) skaj rrugëve dhe vendeve publike, ku më pastaj kundërmimi i erës dha papastërtia do t’i pengonte banorët e atij vendi.

1 El Hidajeh sherh Bidajeh 4/351, Imam Merginani, Shtëpia Botuese “Erkam bin ebil Erkam”, Bejrut, pa vit botimi.

2 Transmeton Imam Ahmedi në Musned 2/321.

3 Transmeton Hakimi në “Mustedrek” 4/247.

4 Transmeton Hakimi në Mustedrek me nr. 5318.

5 Erkanul Islam 2/504-512, Vehbi Sulejman Gavoxhi, Darul Besheir el Islamiyeh, 2002, Bejrut.

6 Transmeton Imam Muslimi me nr. 3751.

7 Elubab fi Sherhil Kitab, Abdul Ganij el Mejdani, f. 594-598.

8 Transmetom Tirmidhiu me nr. 1510.

9 Transmeton Hakimi në Mustedrek me nr. 2/422.

10 Transmeton Imam Muslimi me nr. 1955.



Pejgamberi ynë, alejhi salam – ky frymëzues i botës mbarë

Mr. Besim Krasniqi

Nuk ka dyshim se e tërë jeta e Pejgamberit tonë, alejhi salam, është e mbushur me mësimet dhe urtësi. Madje, është një jetë e mbushur me begati, në të cilën gjen çka të marrë prej saj çdo njeri, sikur i pasuri, ashtu edhe i varfëri, sikur pushtetari, ashtu edhe çobani. Është jetë, që me mësimet e saj ngushëllohet jetimi dhe i sprovuari, por edhe këshillohet i famshmi dhe i begatuari. Këtë e gjejmë në Kuran, në ajetin, ku Allahu i tha drejtpërdrejt Pejgamberit, alejhi salam: “**E Ne të dërguam ty (Muhamed) vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat.**” (El Enbija, 107).

Edukata dhe morali i këtij njeriu që Allahu e dërgoi mëshirë për të gjitha botët, është shembullore, e shkëlqyer, ngase kështu e kishte edukuar dhe mësuar vetë Allahu i Madhërishëm, në mënyrë që ai të jetë pastaj shëmbëlltë për ymetin e tij deri në fundin e kësaj bote. Cilësitë e atij të bekuari ishin aq të bukura, saqë e fitonte admirimin e atij që rrinte me të një çast të vetëm.

Ata që nuk e besuan e cilësuan si poet, ngase retorika e shkëlqyer i mahniti të gjithë, por ajo ishte fjalë e Zotit nuk ishte poezi. Ata thanë: Nuk është tjetër, vetëm se një magjistari, ngase ai që rrinte një çast pranë tij magjepshej me të dhe bëhej ithtar i tij, e kjo nuk ka të bëjë fare me magji, por fuqia e besimit çlironte zemrat e tyre nga robëria e idhujtarisë.¹

Është jetë, që me mësimet e saj ngushëllohet jetimi dhe i sprovuari, por edhe këshillohet i famshmi dhe i begatuari.

Ndër cilësitë e tij ishte se për familjen e tij, pasuesit dhe shokët e tij ishte frymëzues, inspirues, i ngjallte zemrat e njerëzve, i dhuronte shpresë të pashpresëve dhe i nxiste e i shtynte në punë të mira çdokënd që e kishte afër vetes.

Të shikojmë pak në historinë e Pejgamberit, alejhi salam, t'i kënaqim zemrat tona me diçka prej jetës së tij dhe të frymëzohemi edhe ne nga fjalët e ëmbla të tij!

Të gjithë ne e njohim Ebu Bekrin dhe mahnitemi me veprat e mira të tij, dhe nuk ka dyshim se ai që e inspiroi në kryerjen e atyre punëve të mira dhe që e frymëzoi në ecjen e asaj rruge, saqë pas pejgamberëve ai llogaritet njeriu më i mirë që ka ecur mbi tokë, është vetë Pejgamberi, alejhi salam. Një herë, Pejgamberi, alejhi salam, kishte thënë para shokëve të tij: “*Sikur të e merrja dikë për mik pos Allahut, do ta merrja Ebu Bekrin!*”²

Ta mendojmë pak, si ndihej Ebu Bekri pas këtyre fjalëve! Sigurisht se këto fjalë kanë ndikuar tek Ebu Bekri, që ai të ecte pastaj në rrugën e mikut të tij dhe të punonte me mësimet e tij.

Ai i bekuar nuk e lejonte t'i kalonte asnjë mundësi, vetëm se t'i thoshte fjalë të ëmbla e inspiruese shokëve të tij, me anë të të cilave, ai e shfaqte afërsinë e tij, modestinë e tij dhe

respektin që e kishte për të tjerët edhe pse vetë ishte i dashuri dhe i zgjedhuri i Allahut.

Ta shikojmë Omerin, zemrën e të cilit Pejgamberi, alejhi selam, e mbushi me gëzim dhe shpresë dhe e mbjelli tek ai bindjen e plotë. Një prej këtyre rasteve është kur Pejgamberi, alejhi selam, u tregoi shokëve të tij një ëndërr, ku kishte parë vetën duke pirë qumësht dhe ata çka mbeti ia kishte dhënë Omer ibën Hattabit. Omerit, më shumë se ëndrra, i pëlqeu komentimi i saj kur Pejgamberi, alejhi selam, tha: *“Qumështin e komentova si dituri.”*³

Një herë tjetër, Pejgamberi, alejhi selam, ia kishte thënë Omerit një fjalë, që ia kishte ndriçuar jetën e tij. Transmetohet se kur Omeri kishte kërkuar leje nga Pejgamberi, alejhi selam, për ta kryer umren, Pejgamberi, alejhi selam, i kishte thënë: *“O vëllai im, mos na harro në lutjet e tua!”*⁴

Omeri, kur i dëgjoi këto fjalë, përjetoi një ndjenjë të mahnitshme, të cilat i përsëriste me kënaqësi e mallëngjim dhe për to thoshte: *“Fjalë që për to do ta jepja tërë botën!”*⁵

Pejgamberi, alejhi selam, e shfrytëzonte oratorinë e tij dhe fjalët inspiruese të tij edhe atëherë kur donte t’u mësonte shokëve të tij diçka të rëndësishme apo me vlerë. Transmetohet

se një herë i kishte thënë Muadhrit: *“O Muadh, pasha Allahun unë të dua ty! Andaj në fund të çdo namazi mos e le pa thënë: ‘Allahu im më ndihmo të të rikujtojë, të të falënderojë dhe të të adhurojë në formën më të mirë!’”*⁶

Sa fjalë e ëmbël kur Pejgamberi, alejhi selam, i thotë shokut të tij, madje duke iu betuar se njëmend e do atë! A thua, a ka lënë Muadhi ndonjë namaz pa e bërë atë lutje pas këtyre fjalëve?!

Fjalët e ëmbla të tij, Pejgamberi, alejhi selam, nuk i kurseu edhe në mesin e familjes së tij. Një herë, ai hyri te gruaja e tij Safija dhe e gjeti atë duke qarë. Kur e pyeti përse, ajo i tha se ka debatuar me Aishen dhe Hafsën dhe ato mes të tjerash kanë thënë se ne jemi më me vlerë, ngase jemi nga fisi i Pejgamberit, alejhi selam, e pastaj jemi bërë edhe gra të tij, e nuk jemi nga hebrejtë.

Pejgamberi, alejhi selam, duke fshirë lotët nga faqet e Safjes, ia mësoi disa fjalë, me anë të të cilave do të mbizotëronte në debat ndaj ortakeve të saj. Pejgamberi, alejhi selam, i tha: *“Thuaju, si mund të jeni më të mira se unë, kur babai im është Haruni, xhaxhai im është Musai, ndërsa burri im është Muhamedi?”*⁷

Pejgamberi, alejhi selam, ishte inspirues e frymëzues edhe me fëmijët e me të rinjtë. Njëri prej sahabëve që atëbotë ishte i ri, sa ishte Pejgamberi, alejhi selam gjallë, por me mallëngjim e kujtonte atë kohë thoshte: *“Nuk më ka parë Pejgamberi, alejhi selam asnjëherë përveçse ishte duke buzëqeshur!”*⁸

Ndërsa kur e merrte Hasanin – nipin e tij, në prehër, i fliste fjalë të mira, e mes të tjerash i thoshte: *“Ky biri im është zotëri, dhe shpresoj që me anë të tij Allahu t’i pajtojë dy grupe të mëdha nga mesi i besimtarëve!”*⁹

Kjo fjalë i mbeti në kokën e Hasanit, derisa pas sa viteve ai bëhet shkaktar që ta ndalë gjakderdhjen dhe luftën mes ushtrisë së tij dhe asaj të Muaviut.¹⁰

Ky ishte Pejgamberi ynë të nderuar lexues, i frymëzonte të gjithë ata që i kishte rreth vetes dhe i nxiste në punë të mira, e nga goja e tij nuk dilnin fjalë të tjera përveç fjalëve motivuese e me plot urtësi. Kjo ishte arsyeja se përse shoqëria e sahabëve u bë e suksesshme dhe arriti ta përçojë mesazhin islam nga Lindja deri në Perëndim, ngase u rritën, u edukuan dhe u frymëzuan nga Pejgamberi ynë, alejhi selam.



1 Mustafa Mahmud, *Njihe Lajmëtarin*, (Prishtinë, Sira, 2018), 5.

2 Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi.

3 Muttefakun alejhi, (Buhariu e Muslimi).

4 Buhariu, 1194.

5 Shiko: Aid el Karni, *Mulhim el alem*, (Rijad, Daar el hadarah, 2022), 14.

6 Transmetojnë Ahmedi, Ebu Davudi dhe Nesaiu. Hakimi e vlerëson si hadith të saktë – sahih.

7 Transmeton Tirmidhiu (3892).

8 Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi.

9 Transmeton Buhariu.

10 Aid el Karni, *Mulhim el alem*, 19.

Trëndafili - i dashuri i zemrave

Artan Sadiku

*“Çka iu tha trandofiles qi e bani me çelë,
Mu tha edhe mu,
e di prej kah vijmë ato fjalë.”
(Mevlana Xhelaluddin Rumi)*

Trëndafili apo gjyli, është ndër simbolet më të rëndësishme të kulturës dhe artit të kultivuar ndër shekuj në botën islame. Duke qenë i pranishëm në forma të ndryshme të jetës qysh nga koha e Pejgamberit Muhamed, trëndafili i dha aromë secilës shtëpi në forma e tradita të ndryshme.

Fillimisht, këtë vend të veçantë ia bën përmendja e trëndafilin në Kuran, për të përshkruar ngjyrën e qiellit në Ditën e Mbramë, në kaptinën e quajtur “I Gjithëmëshirshmi”, *“dhe kur të çahet qielli dhe të bëhet i kuq si trëndafili”* (Er Rrahman, 37). E vetë Pejgamberi Muhamed, me të çliruar Mekën, pastroi muret dhe dyshtemenë e Qabesë me ujë zemzemi dhe trëndafili, traditë e cila vazhdoi e arriti deri në ditët e sotshme.

Pejgamberi Muhamed i donte dhe i çmonte aromat e mira dhe parfumet kishin rëndësi të madhe në jetën dhe mësimet e tij. Ai kurrë nuk refuzoi kur dikush i dhuroi ndonjë parfum.¹ Ndër aromat më të dashura për Pejgamberin ishte edhe ajo e trëndafilin, që përdorej shumë në esenca të ndryshme të parfumeve. Familja dhe shokët e afërt të Pejgamberit tregojnë se në momentet kur pranonte shpalljen hyjnore, prej tij vinte erë miski, nga pikat e djersës që rridhnin prej ballit të tij si pika vese.²

Kështu, ngjyra dhe aroma e trëndafilin, përkujton në Pejgamberin Muhammed dhe ky asociim u forcua gjithnjë e më shumë. Kështu, letërsia islame e lëvruar ndër shekuj në gjuhë e gjeografi mjaft diverse, u mbush përplot me referenca të trëndafilin, duke simbolizuar vetë Pejgamberin Muhamed.

*“Ajo fytyrë e bukur si petal trëndafili
Djersa seç i lëshon aromë trëndafilin.”³*

Vetë Pejgamberi
Muhamed, me të
çliruar Mekën,
pastroi muret
dhe dyshtemenë e
Qabesë me ujë
zemzemi dhe
trëndafili, traditë
e cila vazhdoi e
arriti deri në
ditët e sotshme.

Vargje si këto të Hakanit (v. 1606), janë të shpeshta, ku trëndafili shndërrohet në lajtmotiv të gjuhës simbolike në letërsinë islame. Trëndafili u bë simbol i të dashurit të zemrave, si mbret i të gjitha luleve dhe burim i pashtershëm frymëzimi për poetët. Format, ngjyrat dhe pjesët e ndryshme të trëndafilin, simbolizojnë figura a gjendje të ndryshme shpirtërore.

Gonxhja e trëndafilin të paçelur ende, paraqet Njëshmërinë (Tevhid), si koncept qendror të mesazhit të Pejgamberit Muhamed. Gjithashtu ky unifikim i të gjitha petaleve në një pikë gonxheje simbolizon gjendjen e veçimit (halvet) të besimtarit,⁴ i cili rrugëton drejt Zotit. Ai është mbyllur si gonxhe, ka palosur të gjitha petalet dhe ruan fshehtësinë e tij përbrenda. Ngjashëm sikur njeriu, edhe gjyli, me të çelur shfaq të gjitha petalet e saj të fshehura, shumësinë e



manifestimit, për të cilën përdoren shprehje të ndryshme si: shqyerja e jakës, shfaqja e bukurisë së fshehur, etj.. Siç e shpreh këtë Hajaliu (1500-1557):

“Të fshehtën e ashkut si gonxhe kush e fshehtë,

Mbajti jakën të shtrënguar sikur gjyli kur nuk çelë.”⁵

Ngjyra e trëndafilut gjithashtu shpreh finesat e gjendjeve të ndryshme të dashurit. Më së shpeshti përmenden trëndafili i kuq, i bardhë dhe ai i verdhë, që përveç simbolikave të shumta, paraqesin edhe gjendjet e ndryshme shpirtërore përmes ngjyrës së fytyrës së të dashurit.

Siç e shpreh këtë poeti i madh Hafiz Shirazi (1325-1390):

“Eja, o Saki fytyrë-trëndafil, na sjell kupën me ngjyrë,

Se s’na sjell as ëndërrimi më të bukur se kjo fytyrë!”⁶

Një formë tjetër shumë e njohur është edhe binomi trëndafil-bilbil, ku trëndafili paraqet të dashurin, ndërsa bilbili të dashuruarin, i cili këndon këngën e tij përplot pikëllim, nga dashuria e malli për bukurinë e trëndafilut. Këtë e shpreh poeti i madh Feriduddin Attar, i cili që i pari që shkroi mbi këtë temë librin “Bylbylname” apo Libri i bilbilit. Kur bilbili rrëfen gjendjet e vet se si dashuria ka bërë që ai ta humb veten tërësisht në trëndafilin:

“Jo çdo zog mundet me ditë, se çka është ky siklet

Ah, këtë zemër veç trëndafil e din me kimet.

Aq më ka kaplu ashku si zhar sall për trëndafilin

Saqë s’kam haber për kurrkënd, besa as për bilbilin.”⁷

Të njëjtën dashuri në mes bilbilit e trëndafilut e shpreh një poet tjetër i madh i traditës islame, Junus Emre, i cili i drejtohet bilbilit duke i thënë:

“E shoh se je bërë ashik në trëndafilin,

si i vardisesh përreth,

dhe i pëshpërit kangët tua

gonxheve të saj...”⁸

Edhe në letërsinë shqipe, kjo dashuri është lëvruar nëpër poezi e këngë pa fund. Përmendim disa vargje të Nezim Frakullës (1680-1760), të cilat janë nga kryeveprat e letërsisë shqipe:

“Përmbi lulet trëndafil

Mbret që s’ka shoq,

Shumë bela hoqë bilbili

Me të sa u poq.”⁹

Edhe Naim Frashëri, shpesh i referohet trëndafilut, për të shprehur bukurinë hyjnore, në unison me frymën e traditës së poetëve të arealit islam:

Një formë tjetër shumë e njohur është edhe binomi trëndafil-bilbil, ku trëndafili paraqet të dashurin, ndërsa bilbili të dashuruarin, i cili këndon këngën e tij përplot pikëllim, nga dashuria e malli për bukurinë e trëndafilut.

“Tek hapetë trëndafil, atje ma ka ënda të jem,

Bashkë me shpest edhe unë t’ia thërres këngës e t’ia them.”¹⁰

Përveç letërsisë, edhe në kulturën tonë të përgjithshme, gjyli apo trëndafil ka një vend shumë të rëndësishëm. Vetë emri ‘trëndafil’ në shqip hyri nga greqishtja, (nga triantáphullon që do të thotë: tridhjetë gjethe), ndërsa emri ‘gjyl’ nga persishtja (gul) nëpërmjet osmanishtes (gül), u përhap edhe në gjuhë të ndryshme, e gjeti vend edhe në gjuhën shqipe.

Edhe oborret tipike të shumë qyteteve tona, gjithmonë përfshijnë bahçe me gjyla. Gjylat zbukurojnë edhe shumë oborre xhamish, rrugësh e kopshtesh të qyteteve tona. Nga petalet e trëndafilut, edhe sot e kësaj dite bëhet “shurupi i gjylave”, që përdoret si pije në stinët kur çelin trëndafilat, po edhe në raste të veçanta, si në tubimet e Mevludit, në të cilat

përkujtohet lindja e Pejgamberit Muhamed. Edhe tespihet që përdoren për përmendjen e Zotit, punohen nga druri i trëndafilut. Nga kjo dashuri, gjithçka që ka të bëjë me trëndafilin është bërë pjesë e jetës, është kandari me të cilin matim vlerën, por edhe ajo që e matim është trëndafil. Kështu po përmendim edhe vargjet e poezisë së Nesimit (1369-1419) të titulluar ‘Trandofili’, e cila u bë sebeb për këtë shkrim, me shpresën që të kujtojmë pak nga tradita e pasur e trëndafilishtës sonë.

“Prej gjylit e bojnë kendarin

Gjylin me gjyl kur e masin

Gjyla shesin gjyla marrin

Trandafil kan’ gjith pazarin.”¹¹

1 Transmeton Enes b. Malik, në Sunen el-Nasa’i, v. 8, f. 189.

2 Sahih-ul Buhari, Shpallja, vëllimi 1, libri 1, nr. 2.

3 Mehmet Bey Hakani, Hilye-i saadet, ed. İskender Pala (Istanbul: Kapı Yayınları, 2008), 70. Të gjitha përkthimet e vargjeve janë të autorit të shkrimit.

4 <https://islamansiklopedisi.org.tr/gul>

5 Cemal Kurnaz, *Hayâli Bey Divânı (Tahlili)*, Ankara 1987, f. 530-534.

6 Divan-i Hafez, Gazelijat, gazeli 149, vargu 3.

7 Feriduddin Attar, Kuvendimi i zogjve, (Pupëza, Prishtinë, 2019), përktheu: Artan Sadiku.

8 Yunus Emre Divani, 283, <https://yunus-divan.appspot.com/pages/index.html>, hapur me 29 mars 2024.

9 Nga dorëshkrimi i Bibliotekës Millet në Stamboll, Koleksioni i Ali Emirit, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2022. Përgatitën për botim: A. Hamiti dhe A. Rexhepi)

10 Naim Frashëri, Bagëti e bujqësia prej N.H.F. (Dritë, Bukuresht 1886)

11 <https://www.antoloji.com/bugun-ben-sahimi-gordum-2-siiri/?siralama=p> hapur me 29 mars 2024.

Festimi i festave islame te shqiptarët

Besar Thaqi

Allahu e krijoi njeriun në formën më të mirë, duke e dalluar prej të gjitha krijesave, e lartësoi dhe premtoi për të mirësi të shumta, nëse qëndron i bindur ndaj Tij. Intelkti është kjo cilësi që njeriun e bën të veçantë mes krijesave në këtë nën qiell, duke mos harruar ndjenjat e tij që përbëhen nga gëzimi dhe ndjenja e mërzi. Njeriu si krijesë ka momente që i dhurojnë gëzime ku prej tyre buron lumturia. Nëse kthehemi në fillimin e jetës së njeriut në këtë botë, vërejmë nevojën e tij për Zot. Njeriu përgjatë jetës së tij, u ballafaqua me sfida që në aspektin shpirtëror mbillnin mërzi e pikëllim, duke mos harruar edhe momentet që mbillnin gëzim e lumturi. Kjo na lë të kuptojmë se nevoja për festë, gëzim dhe lumturi është nevojë njerëzore, pjesë e natyrshmërisë sonë që këtë të vërtetë e përfshijnë gjatë festave tona, andaj për këtë nevojë, Islami, i ka ofruar edhe festat për t'ia përmbushur njeriut këtë zbrazëti.

Festat janë ditë të caktuara ose momente ku njeriu arrin të gëzohet dhe gëzimin e ndanë me të tjerë duke e përcjell me urata dhe dhurata të ndryshme. Prandaj festat i gjejmë edhe te popujt e ndryshëm, qofshin ato festa fetare apo kombëtare, apo të ndodhivë të ndryshme historike, ndërsa te shqiptarët festat luajtën një rol të rëndësishëm në aspektin fetar, kombëtar dhe social.

Ne jemi lindur në tokat shqiptare, ku dëshirojmë të

Festat janë ditë të caktuara ose momente ku njeriu arrin të gëzohet dhe gëzimin e ndanë me të tjerë duke e përcjell me urata dhe dhurata të ndryshme.



rritemi, edukohemi e të vdesim. Të gjithë jemi brenda një territori që përcakton nacionalitetin tonë, duke mos përjashtuar etni të tjera. Në këto toka u krijuan rregulla e norma ku ndërtohej raporti mes njerëzve, u formuan tradita të shumta, adete e zakone për të treguar identitetin tonë kombëtar. Si popull duhej të qëndronim stoik në ruajtjen e identitetit, përball ndikimeve kulturore të popujve që ishin më të fortë, por kjo nuk ishte e mundur përball forcës pushtuese kulturore, që si pasojë e së cilës lindën ideologji të shumta mes shqiptarëve. Ajo që për shqiptarët ishte e nevojshme për ruajtjen e identitetit të tyre ishte feja islame, që përshtatej me natyrën e virtyeteve të tyre, dhe e cila i dha siguri dhe jetëgjatësi identitetit dhe gjuhës shqipe përball rreziqeve që ofronte atëbotë koha dhe fuqitë e kohës. Islamizimi i shqiptarëve ishte mbrojtja nga ata që donin deshqiatarizim. Të vetëdijshëm për këtë, shumica e shqiptarëve, duke kuptuar se Islami si kulturë dhe mësim religjioz, kërkonte vetëm devotshmërinë fetare, e njëkohësisht e bënte të lirë ithtarëve të vetë, vazhdimësinë në kultivimin e vlerave fisnore e kombëtare, u konvertuan dhe në këtë mënyrë ruajtën identitetin e vet.¹

Feja islame si kulturë dhe besim është një e vërtetë që s'mund të shmanget. Festat islame luajtën një rol të madh në formimin e identitetit dhe ruajtjen e tij. Në realizimin e Bajramit të Fitrit dhe Kurbanit, që festoheshin në këto treva, tashmë në mënyrë tradicionale festohen në mbarë tokat shqiptare, duke krijuar një atmosferë festive që i përgjigjet natyrës së këtyre festave. Gjatë këtyre momenteve festive shohim gjurmë të mëdha në ndihmën për forcimin e lidhjeve familjare, duke krijuar lidhje me miq, shokë për të formuar një shoqëri të shëndoshë. Këto festa ishin suksese të arritura pas problemeve të ndryshme shoqërore, duke lënë menjëanë problemet, inatet e vëllavrasjet. Aty shtrihej dora e pajtimit, e këto momente krijonin mundësinë që te njerëzit të pasqyrohej një shoqëri e shëndoshë me vlera të larta morale e shoqërore. Andaj ne duhet të jemi një hallkë e vazhdueshme e ruajtjes së këtyre traditave, përderisa këto çaste formonin ura lidhëse mes njerëzve duke ruajtur në mënyrën më të mirë të mundshme identitetin tonë, familjen dhe shoqërinë. Ne nuk duhet të harrojmë se bota ku ne jetojmë çdoherë na ofron diçka të re në jetën tonë. Njëra anë e saj na ofron mundësi e na krijohen ide, ndërsa në anën tjetër të saj kemi sfida e probleme të shumta me të cilat ballafaqohemi çdo çast. Koha në të cilën jetojmë është treguesi më i mirë se jemi të vendosur përpara një dëshire pa personalitet, që krijon një krizë identiteti, jemi shndërruar në imitues të traditave dhe kulturave të huaja, kemi krijuar një botëkuptim të mangët perëndues. Është

Në epokën tonë janë prodhuar aq shumë festa globale ku një numër i madh i tyre nuk përkon me identitetin tonë fetar.

krijuar hapësira ku pushtuesit kulturorë funksionojnë në vendin tonë deri në atë masë që ne po ndihemi të huaj, kurse mendimet tona tashmë janë njësuar me mendësinë që na ofrohet, kemi mbetur larg personalitetit për të cilin jemi krenarë. Nëse elementi njerëzor prishet moralisht, të gjitha institucionet zyrtare e jo zyrtare do të ngrihen nga dështimi i synimeve që ëndërronin.

Jemi dëshmitarë se në epokën tonë janë prodhuar aq shumë festa globale ku një numër i madh i tyre nuk përkon me identitetin tonë fetar. Nëse e shohim nga këndvështrimi se këto festa janë një kulturë tejet e bukur, kjo na tregon vështirësitë që kemi për të definuar se cila është kultura jonë. Zoti na ka dhuruar mendjen për të kuptuar, vrojtuar e analizuar. Këto aftësi poseduese te ne duhet të ndikojnë për të kuptuar ose medituar rreth asaj që disa e quajnë “vlerë dhe kulturë”. Sfondi kulturor dhe intelektual ka ndikim të madh në mënyrën se si ne i perceptojmë gjërat, gjithashtu ai ka ndikim edhe në cilësinë e vendimeve që i nxjerrim. Ajo që kam për qëllim të them me shprehjen “sfond kulturor” janë postulatet, aksiomat, sjelljet, bindjet, zakonet, traditat dhe vlerat mbizotëruese në një ambient të caktuar. Sfondit kulturor patjetër duhet t’ia bashkëngjisim edhe sfondin e dijes, d.m.th. të njohurive ose informatave që janë në dispozicion të çdonjëri prej nesh rreth çështjes ose problematikës që është subjekt i mendimit tonë.² Në shoqërinë tonë kemi mendime se ajo që është duke ndodhur në vendin tonë në aspektin kulturor është nga

faktorë të jashtëm dhe se shtetit tonë i imponohet çdo gjë pa pasur në dorë mundësinë e refuzimit për shkak të fuqisë ndikuese të faktorëve të ndryshëm të jashtëm. Edhe pse jemi besimtarë të mirë e me devocion të lartë, në të njëjtën kohë kemi mendimin tjetër që çdo gjë e mirë ose e keqe është si pasojë e asaj se çka veprojmë ne. Nga kjo kuptojmë se në shoqërinë tonë po shfaqen plasaritje dhe copëza të shkatërrimit tonë, kjo është sprovë e kësaj bote, por ne duhet të tregohemi të kujdesshëm e të mos krijojmë grupacione që cenojnë identitetin kombëtar e fetar. Problem kryesor siç e përmendëm më lartë është pasimi dhe pranimi i kulturave të huaja që një ndihmë të madhe ia ka mundësuar edhe zhvillimi i teknologjisë dhe mëshira e tepruar përball gabimeve. Andaj nevojë imediate është ruajtja e fesë dhe menaxhimi i diversitetit kulturor, etnik dhe sektar.

1 Idriz Vuçitërrna, “Aspekte fetare dhe kulturore, përmbledhje punimesh”, botoi: Dituria Islame, Prishtinë, 2011, f. 57-58

2 Abdulkerim Bekkar, “Menaxhimi i diversitetit”, përktheu: Vedat Shabani, botoi: Fakulteti i Studimeve Islame, Prishtinë, 2021, f. 34.



Arabizmat në përkthimin e Kuranit famëlartë

Mulaim Shehu

Gjuha arabe, lirisht mund të themi se është gjuhë e mbijetuar semitike, e për këtë, meritohet është Kurani që e ruajti autencitetin e saj. Për këtë, Allahu i Madhërishtëm thotë: *“Me të vërtetë Ne e kemi shpallur Kurandin dhe vërtet Ne do ta ruajmë atë.”* (El Hixhr, 9).

Andaj, përderisa Kurani famëlartë është i ruajtur, atëherë edhe gjuha arabe është e ruajtur nga çfarëdo ataku, si në të kaluarën, po ashtu edhe në ditët tona, dhe ajo do të jetë e ruajtur deri në Ditën e Gjykimit.

Këtë gjuhë sot e flasin mbi 400 milionë njerëz, respektivisht është gjuhë zyrtare në 24 shtete arabe. Mirëpo, po të shtohen edhe ata që e njohin si gjuhë të dytë në botë, sikur që është rasti ynë, atëherë ky numër është shumë më i madh. Kjo gjuhë është e lehtë për t'u mësuar, sepse siç shkruhet ashtu edhe lexohet. Ndoshta vështirësia qëndron në atë sepse është gjuhë tejet e pasur me sinonime, antonime, idioma dhe një gjuhë që ka mbi 10 milionë fjalë. Gjuha arabe është një nga gjashtë gjuhët zyrtare të pranuar në OKB. Së këndejmi, karakteristika është se gjuha arabe i ka vetëm 28 shkronja (bashkëtingëllore), prej tyre 14 quhen “shkronja diellore” dhe 14 të tjera “shkronja hënore”. Po ashtu, veçori e alfabetit arab është se 14 shkronja kanë pika, kurse 14 të tjera janë pa pika. Në gjuhën arabe nuk ka zanore, si shkronja të veçanta, siç është në gjuhën tonë, por në vend të tyre përdoren vetëm disa shenja, që shënohen në Kuran, hadithe dhe zakonisht shënohen për fillestarët, që të mos gabojnë gjatë leximit. Gjuha arabe, thuajse nuk ka gjuhë në botë, të cilës nuk i ka dhuruar fjalë a terme shkencore, në një anë, kurse në anën tjetër, ajo thuajse nuk ka nevojë nga asnjë gjuhë tjetër. Kështu, edhe në gjuhën tonë, ka me mijëra fjalë a shprehje që janë të gurrës arabe, të cilat ende i përdorim, meqë jemi mishëruar me to, dhe

Andaj,
përderisa
Kurani
famëlartë është
i ruajtur,
atëherë edhe
gjuha arabe
është e ruajtur
nga çfarëdo
ataku, si në të
kaluarën, po
ashtu edhe në
ditët tona, dhe
ajo do të jetë e
ruajtur deri në
Ditën e
Gjykimit.

thuajse nuk mund të zhvillohet muhabeti pa to. Megjithatë, kjo ishte vetëm një hyrje, por motivi i përpilimit të këtij artikulli modest, është arabizmat në përkthimin e Kuranit nga gjuha angleze, të përkthyer nga prof. Faton Osmani. Andaj, pas leximit të këtij përkthimi, thënë trazeologjikisht “me një frymë”, jam fascinuar nga kureshtja e përkthyesit, i cili gjatë përkthimit ka sjellë mbi 120 fjalë të gurrës arabe, siç janë: Allah, adet, ahiret, ajet, akraba, ama, amanet, arabe, arabisht, Arafat, ashik, ashikëri, Bedr, beduin, bela, budalla, budallëk, dakik, din, dinar, dynja, fajde, fidje, fiqir, fitme, fukara, gajle, gjynah, gjynahqar, haber, hair, hajdut, hajn, hak, hallë, hallka, hala, hall, hallall, haram, harxhim, hata, hatër, hava, hazër, haxh, hesap, hise, hisedar, hisetar, hyzmet, iblis, ibrik, imam, iman, inat, Islam, jesir, jetim, jexhuxh, mexhuxh, kader, karar, kasavet, katran, këmishë, kiamet, kibla, Kuran, kurban, lezet, mall, marifet, mashallah, medet, matuf, mejdan, merxhan, muhaxhir, mysliman, mysafir, Qabe, qejf, Ramadan, rehat, risk, ruku, ryshfet, sabah, sahat, sakat, saltanet, selam, selamet, sexhde, siklet, sure, shafran, shejtan, sherr, tabiat, tahmin, takat, taksirat, takva, tamam, tamahqar, tebdil, telashe, teveqel, umre, vaki, vakt, ymër, xhalil, xhami, xhehenem, xhenet, xhevap, xhin, xhunup, xhenabet, zahnet, zaptim, zenit, zekat, zina, zor.

Mirëpo, fjalori FGjSSH¹ pohon frymën tendencioze, se të gjitha këto fjalë dhe shumë të tjera, janë fjalë a shprehje vetëm e ligjëritimit bisedor apo janë fjalë të vjetra. Kështu, këto fjalë janë bërë tabu nga FGjSSH, andaj ndoshta është motiv që nuk i hasim te përkthimi i h. Sherif Ahmeti, prof. Hasan Nahi, dr. Feti Mehdiu apo madje as te përkthimi i dr. Selim Sylejmani nga gjuha boshnjake. Prandaj, këtë paprekshmëri, përkthyesi Faton Osmani, e thyen me një kërshtëri dhe sjell fjalët e gurrës

arabe dhe orientale në një anë, kurse në anën tjetër, ai shumë ajete i ka përkthyer në rimë. Megjithatë, ne nuk do të fokusohem dhe nuk do të flasim nga aspekti drejtshkrimor, sintaksor apo nga aspekti i përkthimit të tij, por do t'i shtjellojmë vetëm disa nga këto 120 fjalë e kusur, që janë më karakteristike, radhitur sipas alfabetit, duke sjellë për secilën fjalë nga një ajet kuranor, mbështetur në përkthimin nga anglishtja.

Andaj, po fillojmë: Në emër të Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëmadhit!²

ALLAH (الله) Është emri i përveçëm i Zotit në Islam. Është Një i Vetmi, Krijues dhe Sundues i Ditës së Gjykimit. Ky emër nuk ka gjini femërore, as shumës.³ Emri Allah gjendet në të gjithë fjalorët shqip-shqip apo shqip në ndonjë gjuhë tjetër, sikur që gjendet dhe në fjalorët e gjuhëve botërore. Emri i Allahut në Kuran është përmendur 2697,⁴ ndërsa ne do të theksojmë vetëm këtë: *“Thuaj: Ai, Allahu është Një. Allahu është Ai të cilit i drejtohen çdo krijesë për çdo nevojë. As s’ka lindur kë, as nuk është i lindur. Dhe askush nuk është i barabartë me Të.”* (El Ihlas, 1-4).

ADET m. (عادة) shprehi, traditë, zakon, doke. “Mandej adetet e caktuara le t’i plotësojnë.” (22-29).

AHIRET m. (الآخرة) Botë e përtejme, e përjetshme. “E cilido që fenë e vet e shet, dhe si jobesimtar vdes, këta janë ata punët e të cilëve shkojnë huq dhe dynja dhe ahiret.” (2-217).

AJET m. (آية) Kjo fjalë në gjuhën arabe është tejetpolisemike si p.sh. shenjë, simbol, tregues, provë, dëshmi, argument, shpallje, mrekulli, çudi, mësim, shembull, pjesë kuranore, ajet kuranor etj.. Fjala ajet në Kuranin famëlartë është theksuar 380⁵ herë me shumëkuptimësi. “E ata që nuk besojnë dhe ajetet tona i mohojnë, ata në Zjarr do të banojnë.” (2-39).

AMANET m. (أمانة) mirëbesim, porosi. “Ata prej jush që janë kah vdesin dhe lënë pas vetes gra, ata me amanet duhet t’u lënë grave të tyre jetesë për një vit, pa i nxjerrë nga shtëpia.” (2-240).

BELA f. (بلاء) sprovë, kokëçarje, hall etj.. “Dhe ti një burrë e pate vra, e Ne të shpëtuam që të mos biesh në bela...” (20-40) ..

BUDALLA mb. (بدلاء) nga njëjësi bedil بدیل, d.m.th. zëvendësues. Mirëpo këtu, sipas Abdullah Shkaliqit,⁶ paraqet se budalla بدلاء ka ardhur përmes metatezës shumësit arabisht buleda بدلاء, njëjësi belid بلید d.m.th. i trashë nga mendja, që me të njëjtin kuptim përdoret në turqisht, në gjuhën boshnjake

Gjuha arabe,
thuajse nuk ka
gjuhë në botë,
të cilës nuk i
ka dhuruar
fjalë a terme
shkencore, në
një anë, kurse
në anën tjetër,
ajo thuajse
nuk ka nevojë
nga asnjë
gjuhë tjetër.

etj.. “E fenë e Ibrahimit kush e lëshon, pos atij që veten e budallon.” (2-130).

DIN m. (دين) fe, simbiozë e religjionit dhe e jetës praktike. Tërësia e urdhrave, kërkesave, porosive, të cilat Allahu ia ka zbuluar Muhamedit a.s., që t’ia kumtojë botës. Din në arabisht ka kuptim edhe religjion, devotshmëri, dëgjueshmëri, mendim etj.. “Kush ka din më të mirë sesa ai që i dorëzohet Allahut me ka krejt...” (4-125).

DINAR m. (دينار) monedhë ari; njësi monetare bazë e disa vendeve, siç janë: Iraku, Jordania, Jemeni, Algjeri, Bahreini, Kuvajti, Tunizia, Libia etj.. Disa janë të mendimit se kjo fjalë është e përbërë nga دين dhe اري d.m.th. që fjala e parë ka kuptim fe, kurse e dyta ka kuptim turp, d.m.th. fe-turp. Kështu, meqë atëbotë këto dy vlerësoheshin më së shumti, atëherë njësinë monetare të tyre e quajtën دينار dinar d.m.th. monedhë ari. Kjo fjalë në Kuran është përmendur vetëm një herë, në Suren Ali Imran, ajeti 75. “E ndër ta ka edhe asi që edhe

një dinar po ia besove, pa i ndenjur mbi krye ai nuk ta kthen.” (3-75).

DYNJA f. (دنيا) botë, jeta në këtë botë, rruzulli, gjithësia etj.. “Sa për ata që nuk besojnë, Unë ata do t’i dënojë me dënimin e rëndë në dynja dhe në ahiret...” (3-56).

FAJDE f. (فائدة) fitim, dobi, shumë në të holla që merr fajdexhiu mbi borxhin e dhënë. “Ajo që ju e jepni me fajde që në pasuritë e njerëzve të shtohet, tek Allahu nuk shtohet...” (30-39).

FIDJE f. (فدية) shpagim për mëkate ose për mungesa të tjera, sikur është dhënia ushqim të varfërve ose agjërimi i ditëve të caktuara. “... e për ata që nuk mund të agjërojnë është fidja, të ushqyerit e një fukaraje...” (2-184).

FIQIR m. (فقر) mendim, përsiatje, meditim, opinion; mendje etj.. “Kështu Allahu ajetet e Veta juve ua sqaron që ju të fiqironi.” (2-266).

FITME f. (فتنة) spica, kalla, grindje, trazira. Megjithatë kjo fjalë më shumë përdoret me bashkëtingëlloren “n” d.m.th. fitne. “... sepse fitneja kundrejt vrasjes është më e rëndë.” (2-191).

FUKARA m. (فقر) nga njëjësi فقر skamnor, skamës, i varfër, varfanjak, i vobektë etj.. Është një karakteristikë se shumë fjalë të cilat i kemi përvetësuar nga gjuha arabe janë në trajtën e shumësit, kurse ne i përdorim si njëjës siç janë: ulema, evlat, evlija, tuxhar, eshkija, evrak, astar, nafaize etj.. “Thuaju: Çfarëdo të mire që ju harxhoni duhet të jetë për prindër dhe akraba, për jetimë dhe fukara, dhe për udhëtarë.” (2-215).



GJYNAH m. (جناح) gjynah, mëkat; gabim; faj; keqardhje. "... gjynah kanë vetëm ata që e kanë ndryshuar." (2-181).

HAJN m. (حائى) në fjalorët e vjetër këtë fjalë e sjellin me kuptimin parë d.m.th. vjedhës, ndërsa kuptimi dytë d.m.th. i pabesë, tradhtar. Kurse në fjalorët bashkëkohor, kuptimi i parë thuhet të jetë lënë në harresë, sepse për të përdoret përdorët sinonimi apo سارق vjedhës. Kështu tani shohim në këta fjalorë vetëm kuptimin me d.m.th. i pabesë, tradhtar. Andaj, mund të konkludojmë se fjala حائى qëmoti është përvetësuar në gjuhën tonë. "Sa për mashkullin hajn dhe hajneshë, atyre pritni dorën." (5-38).

HAKMARRJE f. (أخذ الثأر) kjo fjalë është e përbërë nga ar. hak d.m.th. e drejtë dhe shq. marrje d.m.th. shpagim për ndonjë padrejtësi. "Prandaj Ne atyre ju hakmorëm..." (7-136).

HALA ndajf. (حالا) ende, akoma, "Ata që mbasi besuan nuk besojnë, dhe mandej hala mosbesimin e shtojnë..." (3-90).

HALL m. (حال) gjendje e vështirë, shtrëngesë, breng, dert, gajle. "Juve ju ka ardhur pejgamberi prej juve vetë, që për vuajtjet tuaja i vjen rëndë, për ju ka hall..." (9-128).

HALLALL m. (حلال) vepra e lejuar, e lirë, e pagabueshme. Ajo që është e lejuar me Kuran, Sunet. "Unë hallall ta paça bërë." (18-77).

HARAM m. (حرام) vepër e ndaluar, jo e lirë, e gabueshme; ajo që është e ndaluar me Kuran, Sunet. "Këto janë haram për besimtarë." (24-3).

HAXH m. qëllimi i haxhiut që të udhëtojë në Meke për kryerjen e ritualeve të caktuara, në kohë dhe kushte të caktuara. "Dhe, për Allahun kryeni haxh dhe umre..." (2-196).

IBLIS m. (البلس) emri vetjak për shejtanin, djalli, dreqi. "Përveç Iblisit. Ai refuzoi që të jetë ndër ata që sexhde bënë." (15-31).

IBRAHIM m. (إبراهيم) emri i pejgamberit Ibrahim, i cili bashkë me të birin e tij, Ismailin, ndërtoi Qabenë. Ibrahim a.s. në Kuran përmendet 69 herë.⁷ "E fenë e Ibrahimit kush e lëshon, pos atij që veten e budallon." (2-130).

IMAM m. (امام) prijës në namaze, udhëheqës i namazit të përbashkët. Prijës i një bashkie, i një shteti. Imam ka kuptim edhe të ndonjë dijetari që ka lënë gjurmë në histori në fushën

e caktuar të dijës. "Unë ty të paça caktuar imam për njerëzim." (2-124).

IMAN m. (إيمان) iman do të thotë besim, besim në Një Zot absolut, mbinatyror, i Cili ka krijuar, ka drejtuar dhe drejton tërë gjithësinë. "Ne e kemi dëgjuar thirrësin që në iman ka ftuar." (3-192).

INAT m. (عناد) kokëfortësi, kryeneçësi etj.. "Kur ata ju takojnë thonë: Ne besojmë, por kur vetëm janë, ata majat e gishtave e tyre i hanë nga inati që për ju kanë. Thuaju: plasni nga inati." (3-119).

ISA m. (عيسى) emër i pejgamberit të Zotit, Isa a.s.. Kurani pohon se Isai a.s. nuk është kryqëzuar, as gozhdur në kryq, por Allahu e ka shpëtuar duke e ngritur në qiell. Në Kuran, pejgamberi Isa është përmendur 25 herë. Te ne ka mjaft persona që kishin dhe kanë emrin Isa. "Kur Allahu tha: O Isa. Unë të paça marrë ty dhe të paça ngritur tek Unë..." (3-55).

ISLAM m. (الاسلام) nënshtrim, bindje, dorëzim i vetëdijshëm, i ndërgjegjshëm, i qëllimshëm ndaj vullnetit të Zotit, Një dhe i Vetëm. Islami në aspektin besimor është po ai qysh prej Adem a.s. e deri te Muhamedi a.s., por në aspektin e ritualeve, format e Islamit kanë ndryshuar gjatë historisë. "Ai atij gjoksin për Islam ia zgjeron..." (6-125).

JETIM m. (يتم) bonjak, fëmijë i mitur pa prind. "Dhe të pyesin ty për jetimët. Thuaju: Më së miri është që hisen t'ua keni shtuar e në bashkofshi me tuajën, atëherë janë vëllezër tuaj." (2-220).

KËMISHË f. (قميص) këmishë. "Nëse këmisha e tij është e shqyer përpara, atëherë ajo e thotë të vërtetën e ai rrenë." (12-26).

KIBLA f. (قبة) orientim drejt Mekës, përkatësisht drejt Qabesë, gjatë kryerjes së namazit për të gjithë myslimanët e botës. "Ti atyre që u është dhënë Libri, edhe nëse çdo lloj ajeti ua shtron, ata kiblën tënde nuk e pranojnë, e as ti të tyren nuk e pranon, por as kiblën e njëri-tjetrit ata - jehudët dhe të krishterët - nuk e pranojnë." (2-145).

KURBAN m. (قربان) sakrificë, prerje e një kafshe në emër të Zotit për dobinë e njerëzve. "Dhe, për Allahun kryeni haxh dhe umre. E në qoftë se u kanë ndaluar, atëherë sipas takatit

çoni kurban, dhe mos i rruani kokat tuaja pa arritur në vendin e therjes ai kurban.” (2-196).

MUHAXHIR m. (مهاجر) refugjat, i shpërngulur, i persekutuar, i dëbuar etj. “Edhe për muhaxhirët e varfër, të cilët u përzunë nga shtëpitë dhe pasuria e tyre...” (59-8).

MUSLIMAN m. (مسلم) mysliman, pjesëtari i Islamit. Ai që pranon dhe zbaton urdhrat e Zotit në Kuran dhe shpjegimet e Muhamedit a.s. “O ju që besoni. Druani Allahut ashtu qysh ju takon, dhe mos vdisni, pos si myslimanë.” (3-102).

RAMADAN m. (رمضان) Ramazan është emri i muajit të nëntë të kalendarit hënor islam. Muaji i agjërimit. Në këtë muaj ka filluar t'i shpallet Kurani Muhamedit a.s. “Muaji Ramadan në të Kurani është shpall, udhëzim i njerëzimit.” (2-185).

RISK m. (رِزْق) Fjala risk sipas fjalorëve tanë ka kuptim vetëm fat, nafakë, short, kismet. Ndërsa fjala رِزْق risk në gjuhën arabe është tejetpolisemike, që ka mbi 20 kuptime: nozullim, furnizim; ushqim, ngrënie; pjesë, porcion, racion; pagë, pagesë, mëditje; dhuratë, dhunti; talent; zotësi, aftësi; pasuri, pronë, pronësi; mirësi, mirëbërësi, bamirësi; shi etj.. Andaj, sipas kësaj konkludojmë se ne kemi të përbashkët vetëm si falë رِزْق, e kurrësi në kuptim e saj. Kjo është e ngjashme sikur fjala مسافر mysafir, që në gjuhën arabe ka kuptim udhëtar, ndërsa te ne e ka kuptimin: mik që vjen (për ushqim, për të bujtur) në shtëpi, që arabisht përshtatet me fjalën دَافٍ ضيف. Megjithatë, kam një përshtypje se gjuhëtarët nuk i kanë vjelë sa duhet kuptimet e fjalëve, sikur që është me fjalën rizk, meqë kur ndahen vëllezërit thuhet: Secili morën rizkun e vet, d.m.th. secili morën pjesën a hisen e vet. Fjala risk رِزْق me trajtat e saj të ndryshme në Kuran është theksuar 90 herë. “Ata riskun të Zoti i tyre e kanë.” (3-170).

RUKE m. (رُكُوع) pozita në namaz, kërrusje. “Oj Merjem! Bindu Zotit tënd, bë sexhde dhe ruku me ata që bëjnë ruku.” (3-43).

RYSHFET m. (رِشْوَة) mitë. “Dhe mos ia hani hisen njëritjetritin padrejtësisht, as mos e jepni si ryshfet që t'i përfitoni gjykatësit qëllimisht...” (2-188).

SABAH m. (صباح) mëngjes, agim, namazi i parë para lindjes së diellit. “Dhe ti përmende Zotin tënd në qetësi, me përlulësi dhe me frikë, e me zë pak sabah e aksham.” (7-205).

SELAM m. (سلام) paqe, shëndet, besnikëri, përshëndetje islame. “Dhe selam për të në ditën që në jetë ka dalë, në ditën që vdes dhe në ditën kur ka për t'u ringjallë.” (19-15).

SEXHDE f. (سجدة) pjesë e namazit kur falësi bie me ballë, duar, gjunjë dhe këmbë në tokë për Zotin e para Zotit. “Oj Merjem! Bindu Zotit tënd, bë sexhde dhe ruku me ata që bëjnë ruku.” (3-43).

SHEJTAN m. (شیطان) djalli, i kundërt me engjëjt. Është krijuar nga zjarri dhe është mallkuar nga Allahu për shkak të mendjemadhësisë dhe refuzimit të përkuljes. “Po shejtani ata i shtyri të rrëshqasin prej tij dhe i nxori prej tij.” (2-36).

TAKVA (تقوى) devotshmëri, përkushtim, kujdes i përhershëm që të bëhet mirë dhe të mos bëhet keq. “O njerëz,

adhurojeni Zotin tuaj, i Cili juve dhe ata para jush krijuar ju ka, ashtu e të jeni takva.” (2-21).

XHAHIL m. (جاهل) njeri i paditur, njeri i trashë, injorant etj.. “...unë kah do të anoj dhe si xhahil do të përfundoj.” (12-33).

XHEHENEM m. (جهنم) skëterra, vendi ku do të vendosën të gjithë ata që kanë merituar dënimin pas Ditës së Gjykimit. Mësimi islam thotë se ka disa lloje xhehenemesh. “Kënaqësi jetëshkurtër, mandej Xhehenemin do ta kenë strehë vendprehe e mjerë.” (3-197).

XHENET m. (جنة) kopsht i Xhenetit, vend në të cilin njerëzit në Ditën e Gjykimit do të shpërblehen dhe do të shijojnë të mirat amshueshmërisht. “E ata që Zotit të tyre ia patën dronë, kah Xhenet në gropë i çojnë, e aty kur mbërrijnë dhe hapen dyert e tij, rojet e tij u thonë: Selam alejkum!” (39-73).

XHIN m. (ح) qenie e padukshme shpirtërore, e mirë ose e keqe. “Dhe te Sulejmani ushtritë e tij të xhinëve dhe njerëzve dhe shpendëve, bashkë u patën tubuar dhe rreshtuar.” (27-17).

ZEKAT m. (زكاة) sadakë, tatim detyrues vjetore, me një shumë të caktuar prej 2.5 për qind nga pasuria që i nënshtrohet zekatit, të cilin e paguan çdo mysliman i pasur në arkën e shtetit islam (Bashkësisë Islame) për qëllime të përcaktuara me Kurani. “Falni namazin dhe jepni zeqatin, e çfarëdo të mire që ju për shpirtat tuaj përpara çoni, ju tek Allahu do ta gjeni.” (2-110).

ZOR m. (زور) detyrim, dhunë, forcë, zor. Këtë fjalë shpeshherë e përdorin banorët e Shamit, si për shembull: بالزور që përshtatet plotësisht me shprehjen tonë: Me zor. “...kur krejt çka ka në qiej dhe në tokë Atij i janë dorëzuar, me hatër a me zor, dhe Atij i kthehen domosdo.” (3-83).

Dhe në fund, këto ishin fjalët e gurrës arabe, që i ka përfshirë përkthyesi në përkthim nga anglishtja. Ndërsa për fjalët perse apo turke, që janë përfshirë në përkthimin e Kuranit, meqë nuk kemi hapësirë të mjaftueshme, atëherë ato vetëm do t'i shënojmë pa ndonjë shtjellim, si vijon: ashiqare, aksham, barabar, bash, bataqçi, bile, bojë, boll, bollëk, borxh, borxhli, çehre, çengel, çift, dert, divan, goxha, hadje, hajdeni, hajgare, hiç, horr, jastëk, kamxhik, kandar, kollaj, kurdisje, myzhde, myzhdexhi, namaz, nishan, odë, ortak, pejgamber, pishman, qorr, sall, terezi dhe turli, përndryshe do të ndryshonte titulli në: Orientalizmat në përkthimin e Kuranit!

1 Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, Prishtinë, 1981.

2 Kur'ani Madhështor, Kuptimi në shqip, 416 faqe, Tetovë 2022, përktheu nga anglishtja: Faton Rushit Osmani

3 Nexhat Ibrahim, Leksikoni islam, Prishtinë, 2008.

4 Dr. Ruhi el Balebeki المورد المفهرس لالفاظ القرآن الكريم El Mavrid, Bejrut, 1999.

5 Dr. Ruhi el Balebeki المورد المفهرس لالفاظ القرآن الكريم El Mavrid.

6 Abdullah Skaljic, Turcizmi u srpskohrvatskom-hrvatskosrpskom jeziku, Sarajevo, 1985.

7 Dr. Ruhi el Balebeki المورد المفهرس لالفاظ القرآن الكريم El Mavrid.

“Ëndrra ime më e madhe është të bëhem hafëze...”

INTERVISTË ME NXËNËSEN E AKADEMISË SË KURANIT “HIFDH KIDS”, ESMA KOPRANIN

Esma Koprani është një vajzë 9-vjeçare e klasës së 4-të në shkollën fillore “Zenel Hajdini” në Prishtinë. Ajo është një nxënëse e shkëlqyer jo vetëm në shkollë, por në të gjitha aspektet, si në dije, ashtu edhe në edukatë.

Esma është vijuese e Akademisë së Kuranit “Hifdh Kids”, e cila për një interval të shkurtër kohor ka arritur të përfundojë mësimin e shkronjave të Kuranit dhe qysh në këtë moshë të vogël ka arritur të përvetësojë lexim të rrjedhshëm të Kuranit famëlartë dhe jo vetëm. Ajo deri më tani ka arritur të memorizojë 50 faqe të Kuranit famëlartë (afër 3 xhuza).

Esma a mund të na tregosh pak për sukseset tua të deritanishme?

Po, patjetër. Së pari falënderoj Allahun për çdo gjë që më ka dhuruar deri më tani në jetën time, sepse falënderimi ndaj Tij dhe angazhimet e mia të mëdha në mësim më kanë ndihmuar të arrij suksese të shumta. Unë jam 9-vjeçare dhe deri më tani në çdo vit shkollor kam arritur të kem sukses shembullor me të gjitha notat 5, elhamdulillah. Përveç kësaj, mësuesit më zgjedhin shumë herë që të marrë pjesë në gara të ndryshme të diturisë, në të cilat përveç që kënaqem me pjesëmarrje, ato më bëjnë të mësojë më shumë dhe të mos



ndalem asnjëherë. Deri më tani kam arritur të grumbullojë mirënjohje të shumta.

Si është një ditë e zakonshme te ti?

Ditën time unë e filloj me faljen e namazit të sabahut, i cili më bën të ndihem shumë mirë dhe të jem shumë e përqendruar në mësimet dhe aktivitetet e mia ditore. Paraditen e kaloj duke i përfunduar obligimet e mia shkollore, duke lexuar dhe përgatitur për në shkollë, pasi mësimet i vijoj pasdite. Pasi të kthehem nga shkolla, me entuziazëm të madh, mezi pres të nisem në pjesën e ditës ku unë kënaqem më së shumti, për në Akademinë e Kuranit “Hifdh Kids”, ku unë mësoj Kuran përmendsh. Dhe çuditërisht për ndryshe nga shumë bashkëmoshatarë të mi, të cilët me padurim presin të çlodhen duke pushuar apo duke lozur lojërat e tyre të preferuara, unë pushimin tim më të madh e gjej në Akademi, duke mësuar Kuran dhe në aktivitetet e shumta që na i realizojnë dy mësueset e arta, të cilat na bëjnë ta duam edhe më shumë mësimin. Ndiem se më zgjerohet kraharori nga kënaqësia kur ajetet i mësoj dhe mësueset me shumë dashuri i përqafoj dhe mendoem t’ua ndiej aromën që me vete ta mbaj gjithmonë dhe do të doja që ky rrugëtim afër tyre të mos më përfundonte kurrë.

Cili është hobi yt?

Hobi im më i madh është leximi, e dua aq shumë leximin, sa që kaloj shumë kohë duke lexuar dhe ndonjëherë hutohem shumë në libra dhe më duket vetja se jam pjesë e çdo libri.

Cila është lënda mësimore jote e preferuar?

Librat shkollorë i dua të gjithë, matematika më duket shumë e lehtë, ngase i zgjidhi problemet matematikore pa

**Ëndrra ime
më e madhe
është të bëhem
hafëze si babai
im dhe të
ndihem njeriu
më i lumtur në
botë që Allahu
më zgjodhi
mua ta mbaj
në kokë dhe
mendje
Kuranin e
kësaj feje kaq
të pastër e të
bukur.**

ndonjë problem. Njeriu dhe natyra është lënda më me qejf që unë e mësoj, sepse çdo proces të saj fizik ma shpjegon nëna, ndërsa lëndët shkencore i dua pa masë, mendoj që dashurinë e tyre e kam të mbjellë nga nëna ime.

Cila është ëndrra jote më e madhe?

Ëndrra ime më e madhe është të bëhem hafëze si babai im dhe të ndihem njeriu më i lumtur në botë që Allahu më zgjodhi mua ta mbaj në kokë dhe mendje Kuranin e kësaj feje kaq të pastër e të bukur. Ndërsa si profesion dua të bëhem mjeke, dua t’iu ndihmoj njerëzve, t’ua lehtësoj çdo dhimbje dhe vështirësi shëndetësore, t’iu përgjigjem atyre në formën më të mirë, ashtu siç na mëson Kurani dhe feja islame dhe të ndjekë çdo këshillë të prindërve dhe të mësueseve të mia, që Kurani të jetë çdoherë me ne, jo vetëm në mendjet tona, por edhe në çdo hap që ne e bëjmë, nëse duam të kemi një jetë të mirë dhe të kënaqshme.

Cili është mesazhi që do të dëshiroje të përcillje

te bashkëmoshatarët tu?

Unë ju them të gjithë bashkëmoshatarëve të mi të mësojnë sa më shumë, sepse mësimi është dritë, dhe sa më shumë që ata mësojnë, ndriçimi në jetën e tyre do të jetë edhe më i madh. Kohën e lirë ju them të kënaqen me familjen e tyre, me prindërit, gjyshërit e dashur, motrat e vëllezërit dhe të mos e kalojnë kohën më të madhe me lojëra, nëse dëshirojnë të rriten shpejtë dhe të bëhen të suksesshëm në jetë.

Përgatitën: Mësueset hfz. Rineta Nitaj & hfz. Fatime Nitaj



Dhuna në familje dhe interpretimet boshe rreth kësaj problematike

Emine A. Vezaj – Ciroka

Një në tre gra do të abuzohet gjatë jetës së saj nga burri i saj ekzistues. Kjo statistikë befasuese duhet të ngre shqetësimin e të gjithëve pa përjashtim, duke filluar nga shteti, kleri fetar dhe shoqëria civile. Meqë kjo temë do të shtjellohet në aspektin socio – fetar, do të mundohem të ndalem në atë që respektivisht e trajton feja islame. Atëherë, çfarë roli luan feja në ndalimin e dhunës në familje? Për shtetin ligjor, dënimet e natyrës së dhunës - vrasjeve duhet të jenë në limitet e fundit. Komunitetet dhe udhëheqësit fetarë, nga ana tjetër, mund të ofrojnë burime themelore për të rritur ndërgjegjësimin për dëmet dhe papranueshmërinë e dhunën në familje dhe të ofrojnë mbështetje për viktimat. Pastaj hapi tjetër dhe më i rëndësishëm në këtë drejtim përfshinë kthimin në vetë shkrimin e shenjtë. Islami nuk është strukturë shoqërore, e as shumësi besimesh, dokesh e vlerash heterogjene morale, ose me një fjalë, shumësi praktikash. Që do të thotë, Islami duhet shmangur nga një përkufizim të një besimi ose disa praktikave të myslimanëve. Islamit duhet lexuar si burimin më të pastër hyjnor dhe larg çdo interpretimi që do të dëmtonte vetë besimin. Sot, risitë e ndryshme të ardhura nga praktika dhe ide perëndimore rreth martesës, rolit të grave në shoqëri dhe dinamikës brenda familjes së fragmentuar, ua kanë shkatërruar shumë

myslimanëve, e sidomos në qytete të mëdha, mësimet e kahershme të Islamit mbi raportin burrë – grua, që nga aspektet metafizike e shpirtërore, deri tek ato më të jashtme. Kur kësaj i shtojmë edhe faktin se çështja e “grave” në Islam ka lëvizur në maje të agjendës së Perëndimit në studimin dhe raportimin e tij mbi Islamit, bëhet posacërisht e nevojshme të rivendoset pikëpamja islame tradicionale. Për këtë, duhet filluar me parimet metafizike që drejtojnë natyrën njerëzore dhe marrëdhënien ndërplotësuese që ekziston midis mashkullit dhe femrës në nivelin më të lartë, e rrjedhimisht në jetën e përditshme këtu në tokë. Dallimi ndërmjet dy gjinive nuk mund të jetë vetëm biologjik e fizik sepse, në perspektivën tradicionale, niveli trupor i ekzistencës e ka parimin e vet te gjendja subtile, subtile te shpirtërore, dhe shpirtërore te vetë realiteti hyjnor.

Ekzistojnë dy mënyra kryesore të interpretimit që janë zhvilluar nga studiuesit për të kuptuar Kuranin. Forma e parë përfshin shpjegimin e Kuranit brenda tekstit, ose me fjalë të tjera, lejimin e ajeteve të ndryshme nga Kurani për të sqaruar njëri-tjetrin. Forma e dytë përfshin interpretimin e Kuranit bazuar në shembullin e Profetit, i cili u referua nga gruaja e tij si një “Kuran i gjallë”, madje sikur për të argumentuar sjelljet dhe fjalët e hz. Hatixhes për moralin dhe lidhjen e tij me vetë Hatixhen r.a.. Muhamedi a.s.

Islami e sheh dashurinë e burrit dhe gruas si të pandashme nga dashuria për Zotin, e cila në nivelin më të lartë shpie te Zoti. Respekti reciprok në një marrëdhënie bashkëshortore vetëm se shton harmoninë brenda familjes dhe njëkohësisht bëhet burim dashurie dhe shembull edhe për fëmijët.



është shembull se si menjëherë pas zbritjes së parë nga Xhibrili a.s., ai u drejtua i frikësuar dhe i lodhur për të kërkuar mbështetje pikërisht te gruaja e tij. Asaj ia besoi edhe frikën dhe sekretin më të madh.. Duke përdorur këto dy mënyra të hermeneutikës, tani mund t'i drejtohem burimeve tona për të kuptuar se si Islami e ka dënuar vazhdimisht dhunën në familje.

Në qendër të ajeteve që diskutojnë marrëdhënien ideale ndërmjet burrit dhe gruas në Kuran është vargu i mëposhtëm: ***“Dhe nga faktet (e madhërisë së) Tij është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vet lloji juaj palën (gratë), ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe në mes jush krijoi dashuri dhe mëshirë. Në këtë ka argumente për ata që mendojnë.”*** (Kuran, 30:21).

Zoti gjithashtu i urdhëron burrat në një varg tjetër që ***“çoni jetë të mirë me to...”*** (4:19). Për më tepër, këto ajete që njohin natyrën plotësuese të martesës duke i përshkruar bashkëshortët ***“...ato janë prehje për ju dhe ju jeni prehje për ato.”*** (2:187) dhe duke u kujtuar besimtarëve se burrat dhe gratë janë ***“mbrojtës të njëri-tjetrit”*** (9:71).

Këto ajete vendosin standardin dhe paradigmen e dashurisë, dhembshurisë dhe reciprocitetit për marrëdhëniet bashkëshortore. Islami e sheh dashurinë e burrit dhe gruas si të pandashme nga dashuria për Zotin, e cila në nivelin më të lartë shpie te Zoti. Respekti reciprok në një marrëdhënie bashkëshortore vetëm se shton harmoninë brenda familjes dhe njëkohësisht bëhet burim dashurie dhe shembull edhe për fëmijët.

Interpretimet mediatike dhe stereotipat e gabuar për t'ia mveshur besimit islam dhunën në familje

Gjatë një fjalimi radiofonik të 17 nëntorit 2001, atëherë zonja e parë, Barbara Bush, u përpoq të mblidhte mbështetje për luftën në Afganistan, duke e inkadruar luftën kundër terrorizmit si “një luftë për të drejtat dhe dinjitetin e grave”.

Urdhri ekzekutiv i presidentit Donald Trump që kufizon udhëtimet nga 6 vende me shumicë myslimane përmban një dispozitë që kërkon regjistrimin e të ashtuquajturave “*vrasje nderi*” në Shtetet e Bashkuara. Mbrojtësit e të drejtave të njeriut që kritikuan urdhrin argumentuan se përdorimi i termit “*vrasje nderi*”, kundrejt thjesht adresimit të vrasjeve në familje në përgjithësi, ishte një sulm i fshehtë i hollë ndaj myslimanëve si të prirë ndaj dhunës ndaj grave, dhe për këtë arsye shërbeu si një justifikim për këtë - i quajtur “*ndalimi i myslimanëve*”.

Të dy këta shembuj, të cilët në shikim të parë mund të duken përpjekje për të mbrojtur gratë myslimane nga kultura e tyre, në fakt janë të lidhura me politika dhe ideologji që në thelb i lëndojnë pikërisht këto gra. Dhe në fakt, asgjë në lidhje me këtë nuk është e re. Përbuzja e kulturave myslimane si të prira ndaj mizogjinisë dhe dhunës ndaj grave dhe si për të justifikuar shtypjen anti-myslimane, duke përfshirë dhunën shtetërore ndaj grave, ka qenë një taktikë e fuqive perëndimore dhe medias islamofobike për shekuj. T'i marrim shembull britanikët dhe francezët, të cilët, prej kohësh kanë përdorur “çlirimin e grave” dhe kinse të drejtat e tyre, ndërkohë që edhe sot e kësaj dite, në këto vende evropiane, gruaja ende nuk ka një pagesë të barabartë me burrin, nuk ka një përparësi në punësim, dhuna në familje është në forma të ndryshme.

Një medie e cila është e frikësuar për të ardhmen e saj mediatike dhe qëndrimin e saj më të gjatë në treg, bën përpjekje nga më të djallëzuarat, më të shëmtuarat. Ndërkohë, që lajmet e tilla islamofobike ose të pabaza dhe të paqëndrueshme ekzistencialisht vetëm se mund të shkaktojnë frustrim te besimtarët e vërtetë. Fatmirësisht, shoqëria dhe kultura jonë kombëtare nuk ka asnjë ngjashmëri me atë arabe, dhe përderisa një gjë e tillë nuk duket në horizont nuk duhet të ngacmohet për të dalë në pah. Vërehen tendencat që të nënçmohen myslimanët dhe të provokohen ndjenjat e tyre sado jo frontale, por qetësia e tyre nuk do të thotë se janë të gatshëm të pranojnë nënçmimin e vazhdueshëm. Në një mjedis të ngarkuar politikisht, objektivi i medias i përqendruar te “myslimanët ekstremist” ose bëmat e tyre, vetëm se bëhet një patericë e politikës së keqe dhe zhvendosje e vëmendjes te të “bëmat” e “ekstremistëve myslimanë” nga ku objektivizon myslimanët dhe jo politikën e keqe. Për rrjedhojë, mungesa e ekuilibruar në lajme të tilla rrit islamofobinë. Me të drejtë Edaurd Said këtë fenomen e quan “Islami si lajm”. Dhe, për rrjedhojë interpretimet mediatike që mbulojnë dhunën në

familje kanë qasje me dy standarde sa i përket terminologjisë për dhunuesin që përcakton dhunuesin mysliman dhe dhunuesin e një besimi ose kulture tjetër joislame. Kjo është veçanërisht e dukshme kur të gjitha aktet e dhunës ndaj grave të kryera nga një mysliman emërtohen si “krime nderi”, ndërsa sulmet e ngjashme kundër grave në kulturën dominuese në demokracitë perëndimore quhen “dhuna në familje”. Shoqëria moderne dhe shteti modern ia arrijnë të krijojnë botën e tyre – botën dytësore, botën e “zgjedhjeve” dhe të “premtimeve” shërpe – si realitet të vetëm në të cilin nuk ka vend për realitetin mbinatror, për realitetin hyjnor. Për shkak të këtij horizonti ideor, thjesht bëhemi të paafte, të kapemi për realitetin hyjnor, ta dëgjojmë dhe ta kuptojmë Fjalën Hyjnore. Myslimanët sot janë të detyruar të jetojnë në botën e kulturave, religjioneve dhe ideologjive të ndryshme, në shoqëri pa horizont unik shpirtëror, pa moral të gjithëvlefshëm dhe etik të gjithëpranuar, d.m.th. në të ashtuquajturën shoqëri pluro – pluraliste në një shtet me bazë sekulare, të cilët zyrtarisht nuk e pranojnë sheriatin islam si normë të jetës publike. Në gjuhën zyrtare të shoqërisë moderne nuk paraqiten fjalë apo nocione të natyrës religjioze, si shpallja, mëshira, mëkati, ndëshkimi, jeta e amshueshme, shpëtimi etj..

SI DUHET VEPRUAR?

Së pari, ata që punojnë (shteti, kleri fetar, shoqëria civile), për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave duhet ta trajtojnë problemin si një sëmundje universale njerëzore, jo një sëmundje ndaj së cilës është veçanërisht e prirë ndonjë komunitet.

Së dyti, kur bëhet fjalë për komunitetet myslimane, udhëheqësit fetarë mund dhe duhet të jenë pjesë e zgjidhjes. Është nevojë emergjente gjetja e një grupi punues, i cili promovon projekte madhore dhe afatgjate dhe punon për të trajnuar imamët se si të trajtojnë në mënyrë efektive çështjet e dhunës në familje në komunitetet e tyre. Ata duhet të jenë aty që me çdo rast t'u tregojnë besimtarëve cili është identiteti i tyre, cilat janë vlerat themelore shoqërore të dedikuara vetëm për ata, ndërsa të privuar për të tjerët.

Së fundi, çështja kritike e dhunës ndaj grave minohet kur ekspertët ose politikanët e shfrytëzojnë dhe e keqinterpretojnë atë për të justifikuar politikat antimyslimane që në fund të fundit dëmtojnë vetë gratë për të cilat ato pretendojnë se janë të shqetësuara.

Përfundimisht sipas dijetarit irakian, Abdukerim Zejdan, lëndimi ose dhuna ndaj grave është e ndaluar, sepse, si e tillë bien në kundërshtim me aktin ligjor ku Zoti i urdhëron besimtarët të jetojnë në mirësi e dashuri. Dëmtimi i tjetrit, shton ai, është një formë shtypje, e shtypja si e tillë është e ndaluar dhe e urryer te Zoti.¹

PËRFUNDIMI

Kjo tokë e jona nuk është tokë lumturie, sepse këtu lumturitë nuk gëzohen. Në të gjithë pesë raportet kyçe që njeriu në përgjithësi i ka – raportin ndaj vetvetes, ndaj Zotit, ndaj të afërmit, ndaj natyrës dhe ndaj të parëve – tregohet se ai është tjetërsuar. Në qoftë se nuk ka vetëdije për identitetin e vet, nëse në të ka “vdekur zoti”, nëse tjetrin e shikon si rrezik, nëse e ka ndotur natyrën dhe i ka harruar të vdekurit – ai nuk ka shpëtim. Nëse kjo është kështu, e shumë hulumtime e dëshmojnë këtë, atëherë na kanoset rënia në një barbarizëm të ri. Shoqëritë tona janë të sëmura për vdekje – të gjithë ne gjendemi buzë humnerës. Shikuar përmes syrit të një teologe, pamja e shqiptarëve nuk dallon shumë nga ajo e fundit të shekullit nëntëmbëdhjetë: mjerim, mos arsimim, kulturë e ulët shëndetësore, imoralitet, dhunë. Cituar sipas studiuesit prof. Milazim Krasniqi, barbaritë si këto ndaj femrës ndër shqiptarë, të evidencuara nga Nopça dhe nga studiues e vëzhgues të tjerë, janë të shumta, të tmerrshme. Fatkeqësisht, disa nga normat e Kanunit të Lekë Dukagjinit kanë qenë aktive edhe në hapësirat e Kosovës, veçmas në sferën e gjakmarrjes dhe të diskriminimit brutal të femrës. Regjimi serbomadhi do ta ketë nxitur të mbahej Kanuni sa më aktiv, sepse prodhonte dhunë, tragjedi dhe fragmentim social ndër shqiptarë, me çka mbajtja e tyre nën okupim sigurisht ka qenë e lehtësuar. Pra, edhe gjatë periudhës së gjatë të sundimit serb e jugosllav (1999-1912), shqiptarët e Kosovës nuk kanë pasur mundësi të duhura të shpëtimit nga trashëgimia primitive ndaj femrës, as liri veprimi për transformimin dhe emancipimin e mirëfilltë të individit, të familjes e të shoqërisë.²

Çështja e dhunës në familje përfundimisht i kapërcen shqetësimet e besimit fetar dhe shikuar në aspektin psikologjik e ka origjinën në zhvillimin personal të vetë dhunuesit. Prandaj, na takon neve si individë dhe si komunitete fetare të sigurojmë rrjeta sigurie për viktimat e abuzimit dhe të edukojmë besimtarët tanë mbi dëmet dhe ndalimet e dhunës në familje. Këto thirrje për ndryshim dhe ndërgjegjësim kanë rezultuar të frytshme. P.sh. në Filadelfia, një komunitet myslimanë ekspozon abuzuesit e dënua dhe refuzon të celebrojë martesat e tyre të ardhshme. Organizata të tjera dhe udhëheqës myslimanë janë zotuar të qëndrojnë kundër dhunës në familje dhe kanë punuar për të ndërtuar strehimore dhe shërbime të ndryshme sociale për të marrë pjesë drejtpërdrejt në ndihmën ndaj viktimave të abuzimit dhe dhunës në familje.³

1 Abdulkarim Zaydan, El Mufasssal ft ahkam el mar'a wa-al-bayt al muslim (Bejrut: Mu' assasah al-risalah, 1993).

2 Milazim Krasniqi, “Burimet e dhunës ndaj grave”. Shih; (<https://www.epokaere.com/burimet-e-dhunes-ndaj-grave/>).

3 Shih: Salma Abugideiri, “A Perspective on Domestic Violence in the Muslim Community,” www.faithtrustinstitute.org, 2010.

Reagimet e sundimtarëve ndaj letrave të Pejgamberit Muhamed a.s.

Mimoza Sinani

Ka pasur qindra mijëra pejgamberë, heronj, udhëheqës, pushtues, luftëtarë dhe bamirës. Ndoshta emrat e shumë prej tyre sot nuk njihen prej nesh, disa prej tyre jetojnë vetëm në faqet e historisë. Qindra libra janë shkruar për disa prej tyre. Megjithatë, është i pakundërshtueshëm fakti se numri i librave të shkruara për jetën e Pejgamberit Muhamed, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, e tejkalon numrin e librave të shkruara për jetën e çdonjërit, të marra të gjitha së bashku. Nga të gjithë njerëzit spikat një personalitet i vetëm, unik dhe i papërsëritshëm, për të cilin mijëra e mijëra njerëz nga e mbarë bota i drejtohen Allahut për ta bekuar. Kurdoherë që një mysliman dëgjon të përmendet emri i Pejgamberit a.s., ai dërgon salavate (paqja dhe bekimi i Allahut) për të. Kur fjalët: “*Rafāna leke dhikrek*” – “Ne e lartësuam vlerën tënde!” (Kuran 94:4), iu shpallën Pejgamberit a.s., kurejshët i kishin bërë myslimanët objekt të poshtërimeve dhe përbuzjeve më të ulëta, tiranisë më të skajshme dhe egërsisë çnjerëzore, me shpresë se myslimanët do të dorëzoheshin nga shtypjet e tyre barbare dhe askush, përveç tyre, nuk do të mund ta besonte se Pejgamberi a.s., do të ishte njeriu i lavdëruar më së shumti, në një të ardhme shumë të afërt. Dhe vetëm pas pak vitesh më vonë, vetë kurejshët filluan ta lavdërojnë atë më së tepërmi prej të gjithëve.

E tërë jeta e Pejgamberit a.s., i ngjan një libri të hapur përpara botës. S’ka fazë të jetës së tij, që nga lindja deri në vdekje, qoftë ajo private apo publike, që të jetë e fshehur prej kërkimeve të hollësishme të njerëzve. Çdo minutë e jetës së tij ka qenë e ruajtur me imtësi, saktësi, përpikëri, saqë asnjë kritikë nuk mund të zbulojë ndokund ndonjë zbrazëti.

Pejgamberi
a.s., u drejtoi
letra
mbretërve,
sundimtarëve
dhe
guvernatorëve
të vendeve
fqinje, prijësve
të një numri
fisesh dhe
klanesh,
liderëve të
shtresave të
ndryshme të
popullit, duke
i ftuar ata të
përqafonin
Islamin.

Shënime voluminoze, dokumente dhe gojëdhëna të shumta janë shkruar dhe vazhdojnë të shkruhen, madje edhe rreth detajeve më të vogla të jetës së tij. Asnjëherë nuk është shkruar kaq shumë me respekt të ndonjë tjetri, sado madhështor apo i rëndësishëm mund të ketë qenë ai. Madje datat dhe orët e shumë ngjarjeve të jetës së tij njihen me saktësi.

Me qëllim që mesazhi i Islamit të mund të shtrihej në të gjitha vendet, kombet, fiset dhe popujt, Pejgamberi a.s., u drejtoi letra mbretërve, sundimtarëve dhe guvernatorëve të vendeve fqinje, prijësve të një numri fisesh dhe klanesh, liderëve të shtresave të ndryshme të popullit, duke i ftuar ata të përqafonin Islamin.

Letrat dhe dokumentet e Pejgamberit a.s., përfshijnë traktate, marrëveshje dhe pakte të përfunduara me fise dhe klane të ndryshme, letra drejtuar perandorëve, mbretërve, sundimtarëve dhe guvernatorëve, letra dhe vendime drejtuar udhëheqësve të fiseve, kryetarëve dhe prijësve të klaneve, si edhe urdhra, vendime dhe dokumente drejtuar udhëheqësve të fiseve, grupeve dhe individëve.

Traktatet dhe paktet janë shprehje e paqes, e lirisë, e barazisë dhe e drejtësisë. Nëpërmjet tyre, Pejgamberi a.s. u dha qytetarëve jomyslimanë të drejtat e tyre themelore. Këto ishin në realitet statusi dhe baza e shumë parimeve politike elementare të shëndosha, prej të cilave u formuluan më vonë ligjet dhe rregullat për jomyslimanët. Kjo është vërtetuar në pllakën përkujtimore të Muzeumit të Linkolnit, në të cilën emri i Pejgamberit a.s., duket në krye.

Pejgamberi a.s. është pa dyshim ligjdhënësi më i shquar i botës, pasi ai dha kushtetutën e parë të shkruar, në formën e Kartës së Medinës, ku u përfshinë 51 nene. U themelua një sistem i mbështetur plotësisht në drejtësi, barazi dhe devocion dhe jo në bazë të racizmit, ngjyrës apo gjuhës. Pa dyshim ai i dha botës një leksion të shkëlqyer, fisnik, madhështor dhe të frymëzuar.

Letrat janë shkruar me një gjuhë tepër të thjeshtë, faktike, realiste, efektive dhe janë krejtësisht pa retorikë, fjalë të shumta dhe teprime. Megjithatë, ato janë mbresëlënëse, bindëse dhe një komunikim i ngrohtë zemrash. Marrësi ftohet të heqë dorë nga ajo që është e gabuar dhe që të pranojë atë që është e drejtë – rrugën islame. Letrat tregojnë qartë drejtësinë, ndershmërinë, qëndrueshmërinë dhe bindshmërinë e thellë dhe lënë përshtypje thellësisht në zemër e në shpirt.

Karakteristikat më dalluese të të shkruarit të letrave janë: Letrat fillojnë në mënyrë konstante me: “Bismil-lahil’r-Rrahmani’r-Rrahim”, (Meemrin e Zotit, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit”). Pas kësaj, letrat tregojnë që janë nga: “Muhamedi a.s., i Dërguari i Allahut.” Më pas, vjen emri ose pozita e letërmarrësit dhe më pas vazhdon mbiemri i tyre. Letrat hapen ose me një fjali në të cilën madhërohet Allahu, ose me një lutje për mëshirën e Tij, pastaj vazhdon shkurtimisht përmbajtja e temës, në të cilën vihet në dukje fuqia dhe përpunimi i lartë i fjalive. Në fund duket vula, në të cilën emri i Allahut është në krye, poshtë Tij është emri Resul dhe më poshtë vjen emri i Pejgamberit Muhamed a.s..

Letrat që Pejgamberi a.s. ua adresoi mbretit të Etiopisë, sundimtarit të Egjiptit, perandorit të Iranit dhe guvernatorit të Bahrejnit kanë mbërritur deri në ditët e sotme në original.


Konfirmimi dhe identifikimi i teksteve të letrave i siguruar nga burime të ndryshme, me tekstin e gjetur në “hadithe”, provojnë që letrat na kanë mbërritur neve në përputhje me tekstet origjinale.

Në vijim do të japim reagimet e disa sundimtarëve ndaj letrave të Pejgamberit Muhamed a.s..

REAGIMI I NEGUSIT, MBRETTIT TË ETIOPISË

Në vitin e 6-të para Hixhretit, apo më 614 e.s., Pejgamberi a.s. i lejoi myslimanët të migronin përkohësisht në Etiopi, ku ai shpresonte për një trajtim të mirë nga ana e Negusit, mbretit të Etiopisë. Kur karvani i dytë shkoi në Etiopi, Pejgamberi a.s., i adresoi një letër mbretit të Etiopisë. Mbreti i Etiopisë u prek shpirtërisht së tepërmi prej fjalimit mbresëlënëses që Xhaferi r.a. mbajti para tij dhe shpalli hapur se ai nuk do të lejonte që këta njerëz kaq të devotshëm të ktheheshin përsëri nën tiraninë e tyre.

Myslimanët, pas kësaj, gjithmonë kanë pasur një respekt të thellë për Etiopinë. Ata pushtuan shtete të mëdha, si Irani,



por kurrë nuk e prekën shtetin fqinj të Etiopisë. Në letrën e dytë që Pejgamberi i drejttoi Negusit, ndërkohë që vazhdonte të dëgjonte mesazhin e shenjtë, Negusi filloi të ndikohej prej tij. Kur teksti ishte në mbarim e sipër, ai e puthi pergamenën me dashuri të jashtëzakonshme dhe e vendosi atë sipër kokës së tij. Ai zbriti në dysheme dhe dëshmoi besimin e tij në Islam. Negusi i ruajti letrat në një kuti të fildishtë dhe për sa kohë që letrat ishin atje, populli i Etiopisë do të ishte i sigurt dhe i qetë.

REAGIMI I HERAKLI ÇEZARIT, UDHËHEQËSIT TË PERANDORISË ROMAKE

Herakli Çezari gjendej në Jeruzalem në kohën kur e mori letrën e Pejgamberit a.s.. Çezari zotëronte një oborr të madh mbretëror. Ai kishte vënë kurorën mbretërore dhe ishte ulur në fronin mbretëror. Duke iu drejtuar arabëve, ai pyeti se kush prej tyre ishte më i afërt me personin, i cili e quante veten Pejgamber. Ebu Sufjani, i cili rastësisht ishte duke qëndruar në Gaza me mallrat e tij, tha se ai kishte lidhje familjare me Pejgamberin a.s..

Kur Herakliu dëgjoi letrën e Pejgamberit a.s. dhe e pyeti Ebu Sufjanin për cilësitë dhe mesazhin e Pejgamberit, ai pranoi se Muhamedi a.s., ishte vërtet Pejgamber i Allahut. Ai tha: “Nëse ajo që thua ti (Ebu Sufjan) është e vërtetë, atëherë ai është Pejgamber dhe së shpejti do të zërë vendin poshtë këtyre dy këmbëve të mia. E dija që do të dilte, por nuk e mendoja se do të ishte nga mesi juaj. Nëse do ta dija se mund ta arrija, patjetër, do të kisha bërë të pamundurën për ta

takuar dhe po të isha me të, do t'i laja këmbët.” Kur dëgjoi lajmin se Negusi u bë mysliman, tha: “Pasha Allahun, po të mos ishte për hir të mbajtjes së mbretërisë sime, do të kisha bërë atë që ka bërë ai.”

Dashuria për kurorën dhe fronin mbretëror, si dhe kundërshtimi i oborrtarëve nuk e lejuan Çezarin të pranonte Islamit dhe të shpërngulej te Pejgamberi. Por dialogu i tij me Ebu Sufjanin dhe pyetjet e tij të hollësishme tregojnë qartë se ai u bind për vërtetësinë e Islamit, pasi ai gjykoj saktësisht se nëse një person, i cili s'ka gënjyer kurrë në jetën e tij, e ka të vështirë të thotë diçka të pavërtetë rreth Allahut. Ai gjithashtu ishte i sigurt se pasuria materiale, shkëlqimi dhe pushteti nuk ishin qëllime dhe synime të Pejgamberit a.s., por misioni i tij ishte komunikimi i mesazhit islam mbarë botës. Kur Çezari ishte gati të kthehej në Kostandinopojë, ai përsëri i këshilloi oborrtarët e tij të pasonin Pejgamberin a.s., pasi ishte ai, të cilin ata ishin duke e pritur. Ai përveç kësaj përmendi faktin se në librat e tyre gjendej përshkrimi i Pejgamberit a.s. dhe ato hapur dhe qartë tregonin se ai ishte Pejgamberi i vërtetë i Allahut. Si rrjedhim, ishte në interesin e atyre vetë që të pranonin udhëzimin e Pejgamberit a.s.. Por oborrtarët thanë se duhej të kihej parasysh edhe pëlqimi i tyre për të dërguarin arab, pasi mbretëria e tyre ishte mbretëria më e madhe e botës dhe kombi i tyre ishte kombi më i shquar i botës. Çezari tha se nëse ata nuk ishin të përgatitur të pranonin Islamit, atëherë ata shumë shpejt do të mposhteshin prej arabëve. (Sahihu i Buhariut, vol. 1. f. 5).

İbën Xheuziu, një hulumtues i mirënjohur dhe kritik i historisë islame, bëri një zbulim interesant në biografinë e Umerit r.a.. Ai kishte zbuluar se Dahiu r.a., i cili ia kishte dorëzuar Çezarit letërën e Pejgamberit a.s., kishte parë një numër të madh pikturash në të gjitha anët e pallatit të Çezarit. Ky i fundit e njoftoi atë se ato ishin pikturat e pejgamberëve dhe e pyeti atë se cila prej tyre ishte piktura e Pejgamberit a.s.. Pasi i vëzhgoi me kujdes pikturat, Dahiu r.a. tregoi në drejtim të një pikturë dhe tha se ajo ishte piktura e Pejgamberit a.s.. Çezari tha: “Vërtet! Kjo është piktura e Pejgamberit a.s.” Çezari i bëri të ditur se pikturat kishin ardhur në zotërimin e tij nëpërmjet pejgamberit Daniel. Është e qartë se disa piktorë me përvojë duhet të kenë shqyrtuar hollësisht përshkrimin e Pejgamberit a.s. te Tora dhe te Bibla dhe më pas e kanë pikturuar portretin. Ky supozim vërtetohet prej Kuranit të Shenjtë, i cili thotë: “Atyre që u kemi dhënë Librin e njohin atë (Pejgamberin) siç i njohin bijtë e vet. Por një grup prej tyre për

**Bashkë me
letrën drejtuar
Çezarit,
Pejgamberi a.s.
i dërgoi një
letër edhe
Papës. Ky i
fundit e
dëshmoi
pejgamberinë
e tij dhe
vërejtë: “Pa
dyshim, ai
është
pejgamber i
vërtetë.”**

shkak të armiqësisë dhe smirës me çdo kusht e fshehin të vërtetën, edhe pse e dinë.” (Kurani 2:146).

REAGIMI I MUKAUKISIT, MËKËMBËSIT TË EGJIPTIT

Mukaukisi ishte emëruar si mëkëmbës i Egjiptit prej Perandorisë Romane. Ai ishte një njohës i mirë i fesë së vet. Mukaukisi u prek tepër prej sinqeritetit të letrës, dhe vuri në dukje se ishte koha që Pejgamberi i prituri të shfaqej. Prej Torës dhe Biblës, ai kishte arritur të mësonte se Pejgamberi nuk pranonte lëmshë, por pranonte dhuratat. Ai urdhëroi që letra të vendosej në një kuti fildishi dhe të ruhej e sigurt në thesarin qeveritar.

Letra, e cila ishte vendosur në kutinë e fildishtë prej Mukaukisit, e gjeti rrugën e vet në një manastir kristian të Ahimit në Egjipt. Atje një oshënar e kishte ngjitur atë në Biblën e vet. Letra ishte shkruar në një pergamenë. Prej atje një orientalist francez e mori dhe ia shiti Sulltan Abdul Mexhid Hanit për një shpërblim prej 300 sterlinash. Sulltani e kishte ruajtur atë në thesarin e pallatit mbretëror, së bashku me relikte të tjera të shenjta. Studiuesit myslimanë kanë pohuar se Letra është shkruar prej sahabiut të njohur dhe të shquar, Ebu Bekër es Sidikut r.a..

REAGIMI I HARIS GASSANIT, MBRETIT TË SIRISË

Harisi i përkiste familjes Gasani nga Arabia, që ishte vendosur në Siri në fund të shekullit të 2-të e.s. dhe që gradualisht kishte vendosur sundimin e vet në tërë vendin. Pas leximit të letrës së Pejgamberit, mbreti Haris u egërsua dhe tha: “Kush guxon madje të shohë në drejtim të vendit tim?” Ai urdhëroi ushtrinë e tij të bëjë përgatitjet. Pejgamberi a.s., pasi u njoftua për qëndrimin e tij, tha: “Me arrogancën e tij prej mbreti ai refuzoi të pranojë Islamit, por sundimit të tij do t'i vijë fundi.” Nën udhëheqjen e Çezarit, Harisi filloi të luftojë kundër Islamit, menjëherë pas fitores së Mekës, por, më në fund, sundimi i Gasanitëve u fshi prej Sirisë në vitin e 14-të Hixhri, apo 625 e.s. (Tabekat Ibën Sa'd, vol.3, f. 17).

REAGIMI I PAPËS SË ROMËS

Bashkë me letrën drejtuar Çezarit, Pejgamberi a.s. i dërgoi një letër edhe Papës. Ky i fundit e dëshmoi pejgamberinë e tij dhe vërejtë: “Pa dyshim, ai është pejgamber i vërtetë.” Pas kësaj, ai drejtoi një kongregacion në katedrale dhe i njoftoi njerëzit se kishte marrë një letër prej pejgamberit arab Ahmed a.s., i cili i ftonë ata të pranonin besimin e vërtetë tek Allahu, i cili është Një. Ai pastaj dëshmoi se s'ka Zot përveç Allahut

dhe se Ahmed i a.s. ishte rob dhe i dërguar i Allahut. Njerëzit u zemëruan së tepërmi kur dëgjuan këtë deklaratë të vërtetë dhe e goditën aq shumë, sa që ai vdiq. (Tabekat Ibën Sa'd, vol.3, f. 28).

REAGIMI I HUSRO PERVEZIT, PERANDORIT TË PERSISË

Letra e Pejgamberit që iu dërgua Husro Pervezit, i cili e konsideronte veten si gjysmëperëndi, e zemëroi së tepërmi këtë të fundit, sepse emri i Pejgamberit i paraprinte emrit të tij në letër. Mbretëria e Husro Pervezit ishte mjaft e madhe, pasuria dhe shkëlqimi i pallateve të tij ishin përrallorë. Ai nuk mund ta përfytyronte se si një njeri i zakonshëm, të cilin ai e konsideronte si të nënshtruarin e tij, mund të shkruante emrin e vet, përpara emrit të perandorit dhe të mund të guxonte t'i kërkonte atij të pranonte Islamin. Ai u tërbua kaq shumë sa që e grisi letrën dhe bërtiti: "Si një skllav guxon të na dërgojë neve një letër të tillë?"

Ai urdhëroi Bazanin, guvernatorin e Jemenit, ta kapte Pejgamberin a.s. dhe ta sillte atë në oborrin e tij mbretëror. Bazani caktoi Bebojën dhe Ker Kasrën në Medinë për të përmbushur urdhrat. Të dy u paraqitën te Pejgamberi a.s. dhe me respektin e duhur e njoftuan se perandori Husro i ka dërguar për të. Përveç kësaj ata sqaruan se nëse urdhrat e perandorit nuk do të përmbusheshin më vonë ai do ta shkatërronte atë (Pejgamberin) dhe vendin e tij. Por të dërguarit e Bazanit u sprapsën kur dëgjuan Pejgamberin të thoshte: "Fati i ka rrotulluar tavolinat e mbretërisë suaj. Husro ka për t'u vlarë prej djalit të tij, Sherojas. Ju çojani të rejtat zotërisë suaj. Gjithashtu njoftojeni atë se ai shumë shpejt do të bindet se shteti islamik do të shtrihet në kryeqytetin e mbretërisë së Kirsasë."

Kështu ndodhi që Çezari e mundi Kusron dhe ushtria bizantine u tërhoq në kryeqytetin e Iranit. Në këtë kohë shpërthyen trazira në familjen Kusro, i cili ishte burgosur prej djalit të tij, Sheroja. Është shkruar në historinë e Taberit që Sheroja e vrau babanë e tij në natën e 13-të të Xhumadë'l-Ula, të vitit të 7-të Hixhri, pra në vitin 628 e.s.. Të dërguarit e guvernatorit të Jemenit ishin shumë të impresionuar prej karakterit dhe sjelljes së lartë të Pejgamberit a.s., si dhe mënyrës jashtëzakonisht të thjeshtë të jetës së tij dhe e shokëve të tij. Me të arritur në Jemen ata treguan përshtypjet e tyre dhe pejgamberinë e Muhamedit a.s.. Bazani u ndikua gjithashtu tepër prej këtyre fjalëve dhe tha: "Sipas fjalëve të tij, ai nuk duhet të jetë mbret i kësaj jete, por sigurisht një i dërguar i Allahut. Do të duhet të presim ende të verifikojmë pejgamberinë."

Kur Beboja dhe Ker Hasra u kthyen në Jemen, Bazani mori një mesazh prej Sherojas, se Husro ishte vlarë për shkak të veprimeve të tij shumë tiranike. Ai gjithashtu tregonte se Pejgamberi arab a.s. nuk ishte përzier në këtë çështje. Më në

fund Bazani u bind në vërtetësinë e Pejgamberit a.s. dhe e përqafoi Islamin, bashkë me një numër të madh të popullit të tij. (Historia e Taberit, vol. 3, faqe 91).

Pavarësisht prej faktit se letra dërguar Husro Pervezit ishte grisur prej tij, ishte një mrekulli që ajo i rezistoi zhdukjes për më tepër se trembëdhjetë shekuj. Kur Husro e grisi dhe e hodhi tutje, dikush e ngriti dhe dalëngadalë ajo e gjeti udhën në një koleksion të një familjeje kristiane të Libanit dhe së fundi u zbulua prej ministrit të jashtëm të dikurshëm të Libanit, Henri Paraoh. Studiuesit, të cilët e shqyrtuan letrën hollësisht, vërtetuan se ajo ishte letra e vërtetë e Pejgamberit Muhamed a.s. drejtuar Husro Pervezit.

REAGIMI I FARVAHUT, GUVERNATORIT TË MAANIT

Farvahu ishte emëruar si guvernator i Maanit prej qeverisë bizantine. Maani, që tani është pjesë e Jordanisë, ndodhet në veriperëndim të Arabisë. Kur Çezari mësoi për pranimin e Islamit prej Farvahut, ai i tërhoqi vërejtjen dhe e urdhëroi të heqë dorë prej besimit të tij të ri, përndryshe e paralajmëroi se do ta hiqte prej detyrës së tij. Por Farvahu kundërshtoi me vendosmëri. Si pasojë Çezari e burgosi atë, por duke parë se madje edhe vuajtjet e burgut nuk e shmangën prej vendosmërisë, ai urdhëroi që Farvahu të ekzekutohet me vdekje. Fjalët e tij të fundit ishin: "Njoftojeni Pejgamberin (paqja qoftë mbi të) se edhe eshtrat e mia do të mbeten të përlulura ndaj Allahut."

MËSIMET NGA LETRAT E PEJGAMBERIT A.S.

Letrat dhe mesazhet përbëjnë një metodë të rëndësishme daveti për Allahun. Nëse është dikush me të cilin dëshironi të flisni për Islamin, por për një arsye ose një tjetër nuk mund të takoheni me të, dërgojini një mesazh. Pejgamberi a.s. la një shembull për të gjithë udhëheqësit myslimanë që të jenë të pasionuar për përcjelljen e mesazhit të Allahut tek udhëheqësit e kombeve të tjera. Përdorimi i letrave nga Pejgamberi a.s. u tregua shumë i frytshëm; dy mbretër të mëdhenj e përqaftuan Islamin. Edhe ata që refuzuan ftesën e Pejgamberit a.s. e njohën të vërtetën dhe e trajtuan mesazhin e Pejgamberit a.s. me respektin dhe mirësjelljen e duhur.

Literatura

- Muhammad Hamidullah, *The Life and Work of the Prophet of Islam*, Publisher: Adam Publishers, India, 2007.
Imam Bukhari, *Sahih Al-Bukhari*, Translator: Dr. Muhammad Muhsin Khan, Publisher: Kitab Bhavan, India, 1984.
Muhammad Ibn Sa'd, *Kitab At Tabaqat Al Kabir (English)*, Translator: Aisha Bewley, Publisher: Ta-Ha Publishers, UK.
History of Al-Tabari, Publisher: State University of New York Press, edited by Ehsan Yarshater (Editor), 2007.
Sulltan Ahmed Kureshi, *Letrat e Muhamedit a.s.*, përktheu Mimoza Sinani, (Logos –A, Shkup, 2004).

Plani për organizimin ushtarak të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit

Msc. Drin Aliu

Përmes këtij punimi të shkurtër dhe konstruktiv, për nder dhe në kujtim të 146-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, do të trajtojmë planin për organizimin ushtarak të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit mes viteve 1878-1881.

Më 10 qershor të vitit 1878, 146 vjet më parë, në Prizren, në “Bajrakli Xhami” (Xhaminë e Bajrakut apo Flamurit), u mbajt Kuvendi Kombëtar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Qëllimi i këtij Kuvendi ishte kundërshtimi i vendimeve të padrejta në raport me trojet shqiptare, të cilat dolën nga Traktatit famëkeq i Shën Stefanit (03.03.1878), i nënshkruan mes Rusisë dhe Perandorisë Osmane (pas luftës së ashpër që këto dy perandori zhvilluan kundër njëra-tjetrës mes viteve 1877-78, luftë kjo e cila përfundoi me një humbje katastrofale për Perandorinë Osmane). Në anën tjetër, Kuvendi i Lidhjes së Prizrenit (10.06.1878), u mbajt qëllimisht tre ditë më herët para se të fillonte punën Kongresi i Berlinit (13.06.1878), me qëllim që të hartoheshin kërkesat e shqiptarëve drejtuar këtij Kongresi, që si për qëllim kishte rishikimin e vendimeve të Traktatit të Shën Stefanit. Shqiptarët e mbajtën Kuvendin e Prizrenit pikërisht në prag të Kongresit të Berlinit, me qëllim dhe shpresë që kërkesat e tyre të shqyrtoheshin dhe të rregulloheshin vendimet e padrejta të Traktatit të Shën Stefanit dhe për të kundërshtuar çdo vendim eventual që mund të ndërmernte Kongresi i Berlinit në dëm të trojeve shqiptare.¹

Lidhja Shqiptare e Prizrenit si organizatë politiko-ushtarake, krahas organizimit politik, e kishte të rregulluar me dekretligj edhe organizimin e saj ushtarak. Dekretligji për organizimin ushtarak të Lidhjes së Prizrenit kishte gjithsej 19 nene, përmes së cilave parashihej organizimi dhe funksionimi i ushtrisë shqiptare të Lidhjes së Prizrenit.

Duke u bazuar në “Dekretligjin e Lidhjes së Prizrenit mbi formimin dhe organizimin e ushtrisë shqiptare” do të mundohemi t'i nxjerrim disa veçori specifike të planit për

organizimin e ushtrisë shqiptare në kuadër të Lidhjes së Prizrenit.

Sipas nenit XIX të ligji në fjalë, Ushtria e Lidhjes së Prizrenit parashihej të ndahej në: çeta, batalione ose tabore, regjimente dhe brigada.

Njësia më e vogël ushtarake parashihej të ishte çeta, e cila do të drejtohej nga një nëntoger, një kapiten dhe një shkruer (sekretar). Çdo çetë duhet të kishte së paku 100 ushtarë këmbësorë dhe një kalorës.

Njësi tjetër ushtarake më e madhe se çeta parashihej të ishte batalioni apo tabori. Pesë çeta të bashkuara mes vete do të formonin një batalion. Duke pasuar parasysh faktin që çdo çetë duhet të kishte së paku 100 ushtarë, një batalion duhet të kishte së paku 500 ushtarë dhe 5 kalorës. Batalioni apo tabori parashihej që të drejtohej nga një major, një kapiten, një imam, një shkruer (sekretar).

Njësi ushtarake më e madhe se batalioni sipas këtij neni (XIX) ishte regjimenti. Regjimentin do ta formonin 4



batalione (siç shihet, çetat shkriheshin dhe formonin batalione, ndërsa batalionet formonin regjimente). Regjimenti do të drejtohej nga një kolonel ose një kajmekan dhe një shkruer (sekretar). Në bazë të asaj që shpjegoam më lartë që çdo batalion duhet të kishte së paku 500 ushtarë dhe së paku 5 kalorës, një regjiment duhet të kishte së paku 2000 ushtarë dhe 20 kalorës.

Ndërsa njësia më e madhe ushtarake parashihej të ishte brigada, e cila planifikohej të përbëhej nga 2 regjimente ose 8 tabore. Brigada parashihet të kishte mbi 4000 ushtarë dhe së paku 40 kalorës nën drejtimin e një gjenerali.

Po ashtu me nenin XIX të Dekretligjit për formimin dhe organizimin e ushtrisë shqiptare të Lidhjes së Prizrenit parashihej që *“Ushqimi dhe pagesa do t’u jepet ushtarëve nga arka e të ardhurave të vendit”*. Krahas kësaj, ushtarët e Lidhjes së Prizrenit e kishin të lejuar edhe plaçkën e luftës, e cila rregullohej dhe garantohet qartë me nenin XIII të këtij Dekretligji në të cilin thuhej se: *“Në fushë të luftës do të formohet një këshill i posaçëm ushtarak për të regjistruar dhe ndarë midis ushtarëve bagëtinë (plaçkën e luftës D.A) që do ta marrin nga armiku.”*

Rregullorja e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit mbi organizimin dhe funksionimin e ushtrisë shqiptare për kohën dhe rrethanat ishte e jashtëzakonshme dhe kishte një rëndësi shumë të madhe, ngase shqiptarët deri në këtë kohë nuk kishin një plan të tillë për organizim ushtarak, prandaj jo rastësisht Lidhja e Prizrenit cilësohet si organizatë politiko-ushtarake, e cila e drejtoi Lëvizjen Kombëtare mes viteve 1878-1881. Krahas kësaj, kjo rregullore ishte shumë strikte, e kjo më së miri shihet në nenin IX, përmes së cilit parashihej se: *“Çdo njeri, që është zgjidhur ushtar prej rrethit të vet, lypset të shkoj menjëherë në fushë të luftës. Në qoftë se ndonjë ushtar i tillë nuk shkon, ose duke shkuar në rrugë ua bën ndonjë dëm banorëve, apo largohet nga fusha e luftës, do të dënohet sipas fajit që bën: do t’i digjet shtëpia, ose do të pushkatohet ose do të internohet në vende të largëta...”*

Ky Dekretligj për organizimin e ushtrisë së Lidhjes së Prizrenit ishte miratuar dhe votuar nga 44 delegatë më 2 korrik 1878 dhe i pari që e kishte nënshkruar dekret ligjin në fjalë ishte Iliaz Dibra.³

Organizimin decidiv të paraparë sipas Dekretligjit në fjalë e pamundësuan shumë faktorë të brendshëm dhe të jashtëm. Krahas kësaj, Ushtria e Lidhjes së Prizrenit, e organizuar në kushte shumë të vështira, luftoi me heroizëm në mbrojtjen e trojeve shqiptare kundër Malit të Zi, Serbisë, Fuqive të Mëdha dhe Perandorisë Osmane, duke e bërë kështu të njohur popullin shqiptar edhe në arenën ndërkombëtare deri në fund të ekzistimit të saj. Në fund të vitit 1880 dhe në fillim të vitit 1881, Perandoria Osmane pas presionit të madh ndërkombëtar të shteteve evropiane, të cilat e kërcënuan që

Sipas nenit XIX të ligji në fjalë, Ushtria e Lidhjes së Prizrenit parashihej të ndahej në: çeta, batalione ose tabore, regjimente dhe brigada.

Njësia më e vogël ushtarake parashihej të ishte çeta, e cila do të drejtohej nga një nëntoger, një kapiten dhe një shkruer (sekretar). Çdo çetë duhet të kishte së paku 100 ushtarë këmbësorë dhe një kalorës.



ose ta shkatërronte Lidhjen e Prizrenit (e cila ishte bërë pengesë e madhe për t’u realizuar vendimet e padrejta të Kongresit të Berlinit) ose shtetet evropiane do ta pushtonin Izmirin. Duke e pasur parasysh këtë kërcënim serioz, Perandoria Osmane ndërmori një fushatë të madhe ushtarake dhe e shkatërroi përfundimisht ushtrinë e Lidhjes së Prizrenit në prill të vitit 1881, duke i vrarë, burgosur dhe internuar jashtë vendit udhëheqësit kryesor të Lidhjes së Prizrenit dhe kështu pushoi së ekzistuari Lidhja më e madhe e shqiptarëve gjatë shekullin XIX.

1 Më gjerësisht rreth Lidhjes së Prizrenit shih: Xhafer Belegu, *Lidhja e Prizrenit e veprat e saj 1878-1881*, (Tiranë, 1939); Skender Rizaj, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1877-1885)*, (Prizren: Drita, 1998); Halil Alidema, *Paqja e Shën Stefanit dhe Kongresi i Berlinit: vendimet dhe reflektimet e tyre*, (Prizren: NGLB “Kosova”, 2004); Aleks Buda, Kristo Frashëri et.al, *Historia e Popullit Shqiptar: Rilindja Kombëtare, vitet 30-të, shek. XIX 1912, vëllimi II*, (Tiranë: Toena, 2002).

2 Iliaz Rexha, *Lidhja e Prizrenit në dokumente osmane 1878-1881*, (Prishtinë: Arkivi i Kosovës, 1978), 26-29.

3 Më gjerësisht rreth dekretit ligjit shih: Iliaz Rexha, *Lidhja e Prizrenit në dokumente osmane 1878-1881*, (Prishtinë: Arkivi i Kosovës, 1978), 26-29.

Abdumexhid ez Zindani

1942-2024

(VDEKJA E DIJETARIT QË BËRI NDËRLIDHJEN E TEKSTEVE
FETARE ME SHKENCAT BASHKËKOHORE)

Mr. Arton Musliu

Që nga viti 1975 ishte themelues dhe drejtues i Zyrës për Këshillime dhe Udhëzime Arsimore, përmes së cilës arriti që të zhvillonte një sërë aktivitete në nivel botëror, e që kryesisht kishin karakter edukativo-arsimor.

Abdumexhid ez Zindani ishte njëri prej dijetarëve të njohur të këtij shekulli. Thirrës dhe politikan me mjaft ndikim, si brenda Jemenit, po ashtu edhe jashtë tij. Ai ishte themeluesi i Universitetit “El Iman” në Jemen, themelues i Organizatës Botërore për Mrekullitë Shkencore në Kuran dhe Sunet, me seli në Mekë, po ashtu ishte themelues dhe drejtues i partisë Bashkimi Jemenas për Ndryshime, ishte njëri prej themeluesve të Lëvizjes Vëllezërit Myslimanë në Jemen dhe anëtar i Këshillit të Përgjithshëm për Vendimmarrje pranë të njëjtës lëvizje.

Abdumexhid ez Zindani lindi më 1 janar të vitit 1942 në fshatin Dhehebij të provincës Abë të Jemenit, edhe pse origjina familjare është nga Sana e Jemenit.

Hapat e parë të shkollimit i mori në qytetin Aden të Jemenit, pastaj udhëtoi drejt Egjiptit, për të vazhduar shkollimin universitar. Në Egjipt u regjistrua në Fakultetin e Farmacisë, ku vijoi mësimet për dy vjet, por i ndërpreu ato për të vazhduar me lexim autodidakt rreth njohurive fetare, gjë të cilën e kishte në gjak që nga vegjëlia. Në Egjipt, e në veçanti në Universitetin e Az’harit, iu dha mundësia që të takojë me dijetarë të njohur të asaj kohe.



Paskthimit të tij në Jemen, Abdumexhid ez Zindani ishte njëri ndër aktivistët e njohur të revolucionit të vitit 1962. Ai më vonë shpërngulet për në qytetin Aden, por në vitin 1967, pas suksesit që pati Abdurrahman el Irbabi në grushtshtetin e organizuar kundër Abdullah Selalit, Abdumexhid ez Zindani kthehet përsëri në Sana të Jemenit dhe merr udhëheqjen e Ministrisë së Arsimit. Ishte kontribuues i madh në zhvillimin dhe reformimin e metodave të arsimit në Jemen, por edhe mësimdhënës i shumë lëndëve shkencore, në disa qytete të Jemenit. Që nga viti 1975 ishte themelues dhe drejtues i Zyrës për Këshillime dhe Udhëzime Arsimore, përmes së cilës arriti që të zhvillonte një sërë aktivitete në nivel botëror, e që kryesisht kishin karakter edukativo-arsimor. Përmes kësaj zyre, Abdumexhid ez Zindani kishte arritur që të sjellë dijetarët dhe mendimtarët më të njohur të botës arabe.

Më vonë përsëri kthehet për të punuar në Ministrinë e Arsimit dhe merr pjesë në përpilimin e metodave edukativo-arsimor për Jemen.

Pastaj, shpërngulet për në Mbretërinë e Arabisë Saudite, ku punoi si mësimdhënës, ligjërues e themelues i Organizatës Botërore për Mrekullitë Shkencore në Kuran dhe Sunet me qendër në Mekë. Pastaj kthehet në Jemen dhe themeloi Universitetin “El Iman”, e po ashtu vazhdoi me shkrimin e librave, ligjërimit dhe kërkimet e tij shkencore. Titullin doktor e mori nga Universiteti Islamik “Umu Derman” të Sudanit.

Gjatë viteve 80, mori pjesë në luftën kundër komunizmit sovjetik në Afganistan dhe ishte organizator e thirrës i të rinjve jemenas për pjesëmarrje në këtë luftë. Kjo ishte arsyeja që u mor më vonë si pretekst për ta akuzuar për terrorizëm. Ai kishte deklaruar haptas përkrahjen e tij ndaj të rinjve revolucionar të Jemenit, revolucion ky që ishte organizuar kundër presidentit Ali Abdullah Saleh.

Abdumexhid ez Zindani, gjatë një interviste të tij të dhënë për televizionin e

Abdumexhid ez Zindani, gjatë një interviste të tij të dhënë për televizionin e njohur të Al-Jaziras, e kishte bërë të ditur se ka bërë zbulimin e ilaçit për shërimin e virusit të HIV-AIDS-it. Këtë ilaç e përfitoi përmes bimëve natyrore me ç ‘rast i bëri thirrje Organizatës Botërore Farmaceutike pranë Kombeve të Bashkuara për ta vizituar Jemenin dhe për të mësuar më shumë rreth rezultateve të këtyre testeve, duke mos dhënë më shumë detaje rreth këtij zbulimi, e as rreth vendndodhjes së bimëve, në mënyrë që ta mbrojë të drejtën e tij mbi zbulimin. Ky zbulim nuk ishte i rastësishëm, ai erdhi si rezultat i një pune 15-vjeçare.

njohur të Al-Jaziras, e kishte bërë të ditur se ka bërë zbulimin e ilaçit për shërimin e virusit të HIV-AIDS-it. Këtë ilaç e përfitoi përmes bimëve natyrore me ç ‘rast i bëri thirrje Organizatës Botërore Farmaceutike pranë Kombeve të Bashkuara për ta vizituar Jemenin dhe për të mësuar më shumë rreth rezultateve të këtyre testeve, duke mos dhënë më shumë detaje rreth këtij zbulimi, e as rreth vendndodhjes së bimëve, në mënyrë që ta mbrojë të drejtën e tij mbi zbulimin. Ky zbulim nuk ishte i rastësishëm, ai erdhi si rezultat i një pune 15-vjeçare. Abdumexhid ez Zindani kishte themeluar një grup profesionistësh në Medinë dhe për 15 vjet punë kishte arritur që të mjekonte 15 veta, shërimi i të cilëve zgjati një deri tre vjet pas përdorimit të ilaçit. Ky zbulim bazohet në studimin që i është bërë mjekësisë profetike dhe mrekullive shkencore në traditën profetike.

Është bashkautor i shumë teksteve shkollore, ligjërues i njohur, thirrës i shquar dhe një dialogues i dalluar, sidomos në polemikat e bëra me jobesimtarët. Ka të incizuar një mori video-emisione e ligjërata dhe është autor i disa librave, shumë prej të cilëve janë përkthyer në gjuhë të ndryshme të botës.

Prej veprave të tij më të njohura mund të përmendim:

- 1- Te’sil el Ixhaz el Ilmi.
- 2- El Iman.
- 3- Tarik el iman.
- 4- Tevhid el halik, 3 vol.

Abdumexhid ez Zindani është një figurë e njohur edhe për shqiptarët pasi që disa prej veprave të tija janë të përkthyer edhe në gjuhën shqipe. Po ashtu, ai ishte i njohur edhe për ndihmën që ua kishte ofruar shumë prej studentëve shqiptarë që kanë studiuar në Universitetin El Iman të Jemenit.

Ai vdiq më 22.04.2024 në Stamboll të Turqisë. Ndërsa, humbja e tij është një humbje e madhe, jo vetëm për botën islame, por për njerëzimin në përgjithësi.

Doli në pension imami, mulla Reshat ef. Mexhiti

Më 2 prill 2024, imami i Xhamisë Qendrore të Prizrenit, “Gazi Mehmet Pashës” (Bajraklisë), mulla Reshat ef. Mexhiti i mbushi 65 vjet, dhe sipas normativës ligjore në fuqi të Republikës së Kosovës, i plotësoi kushtet për dalje në pension.

Imami, mulla Reshat ef. Mexhiti, lindi më 2 prill 1959 në fshatin Kuklibeg (treva e Opojës), komuna e Dragashit. Pas kryerjes së shkollës fillore, në vitin 1974, u regjistrua në Medresenë e Mesme “Alauddin” në Prishtinë, të cilën pas pesë vjetëve ndjekjeje të mësimin të rregullt, me sukses e përfundoi në vitin 1979. Pas kryerjes së Medresesë u regjistrua në Universitetin e Al Az’harit në Kajro të Egjiptit, në fakultetin “USULID-DIN” në degën e Tefsirit, në të cilin përfundoi studimet me sukses në qershor të vitit 1985.

Më 1987 filloi punën si imam, me ç’rast u caktua në pozitën e imamit, hatibit dhe vaizit në Xhaminë Qendrore të Prizrenit, atë të “Gazi Mehmed Pashës” (Bajraklisë), në të cilën shërbeu me plot sukses 37 vjet pa ndërprerë, gjer në pensionimin e tij më 2 prill 2024. Njëherësh, krahas punës si imam, punoi edhe si mësimdhënës i rregullt në Medresenë “Alauddin” - paralelja e ndarë në Prizren, që nga themelimi i saj. Shërbeu plot 30 vjet si mësimdhënës i rregullt në lëndën e Kuranit dhe Tefsirit, që nga viti shkollor 94/1993 e gjer në ditën e pensionimit. Në këtë shkollë të mesme fetare, pos të tjerash ishte edhe një ndër kujdestarët aktiv të mirëmbajtjes së saj në



aspektin infrastrukturor, falë përkrahjes së Këshillit të Bashkësisë Islame në Prizren dhe xhematit bujarë prizrenas, që nuk kursyen ndihmën e tyre sa herë që imami kërkonte prej tyre.

Kujdesej në vazhdimësi për nxënësit dhe nxënëset e tij, për mësimin dhe nevojat e tyre, për literaturë, gjë që e dëshmojnë nxënësit e tij se u siguronte librat dhe materialin tjetër mësimor falas, duke thënë se këtë e keni dhuratë nga Prizreni, vetëm për hir të dashurisë suaj dhe të prindërve tuaj për Medresenë.

Krahas kësaj, ushtroi edhe funksione të tjera në kuadër të Bashkësisë Islame të Kosovës. Ishte koordinatori i paraleles së ndarë të Medresesë “Alauddin” në Prizren, prej vitit 2011 e gjer në vitin 2016. Po ashtu ushtroi edhe detyrën e kryeimamit të Këshillit të Bashkësisë Islame në Prizren prej prillit 1994 e gjer në janar të vitit 1997. Po ashtu ka ligjëruar edhe lëndën e Tefsirit në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë për vitin e parë dhe të dytë nga viti 1995 e gjer në vitin 2005. Ka qenë edhe anëtar i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës që nga viti 1992 e gjer në vitin 2000 në periudhën me delikate të vendit, para luftës, pastaj përsëri zgjidhet anëtar i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës nga viti 2008 gjer në vitin 2023. Në momente të caktuara, sipas udhëzimit të myftiut, ka ushtruar detyrën si zëvendëskryetar i Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës.

Në historikun e xhamisë së Bajraklisë, do të mbetet në kujtim si imami, i cili më së gjati qëndroi në pozitën e imamit me kohëzgjatje 37 vjet. Përgjatë shërbimit të tij si imam në xhami ka pasur fatin të jetë edhe shumë herë udhëheqës i haxhilerëve në kuadër të Bashkësisë Islame të Kosovës, ku njëherë nga këto udhëtime të haxhit e destinoi për të bërë haxhin bedel për ndërtuesin e xhamisë në të cilën shërbeu, pra për Gazi Mehmed Pashën - Haxhi Gazi Mehmed Pasha. Zoti e shpërbleftë këtë njëri për këtë vepër kolosale që i la Prizrenit tonë të bukur që akoma më shumë i shtohet bukuria dhe vlera historike qytetit tonë dhe kësaj xhamie, sepse në të u vendos fati i kombit tonë dhe trojeve tona shqiptare!

Mulla Reshat ef. Mexhiti, do të mbetet në kujtim edhe si imam me një disiplinë dhe vetëbesim të pamohuar. Një karakteristikë tjetër e mulla Reshat ef. Mexhiti ishte se ka qenë i përpiktë në faljen dhe udhëheqjen e namazeve dhe në veçanti në namazin e sabahut në xhami, gjë që nuk mbahet mend që ndonjëherë ta ketë rënduar gjumi e që të mos këtë qenë prezent në xhami për të udhëhequr xhematin në faljen e farzit të namazit të sabahut nga pas lufta e këndeje, gjer në pensionimin e tij.

Meritat e tij janë të shumta si në aspektin fetar, kombëtar e humanitar në bamirësi dhe ndihma të ndryshme për njerëzit, qoftë në meremetim shtëpish, elektrifikim, mobilim si dhe ndihma të ndryshme për shërim dhe sigurim ilaçesh për të sëmurët, sigurim ushqimesh e veshmbathje për nevojtarët në

Në historikun e xhamisë së Bajraklisë, do të mbetet në kujtim si imami, i cili më së gjati qëndroi në pozitën e imamit me kohëzgjatje 37 vjet.

përgjithësi, por edhe për refugjatët në veçanti, si dhe dhënie bursash për nxënës dhe studentë dhe shumë e shumë punë të tjera, për të cilat nuk pranon të flitet për to, ashtu si nuk pranon të shënohen detaje për këto që u theksuan më lartë, edhe pse dihen botërisht nga njerëzit që dëshmojnë për to.

Imami, duke e arsyetuar veten se janë bërë për hir të të Madhit Zot xh.sh., nuk dëshiron që të detajohen të tilla gjëra. E veçantë ishte se gjatë viteve nëntëdhjeta të shekullit të kaluar, ka udhëhequr punimet në restaurimin dhe renovimin e tërësishëm të xhamisë dhe oborrit të xhamisë së "Gazi Mehmet Pashës" (Bajraklisë) në Prizren, dhe që edhe pas përfundimit të kësaj gjer në ditën e fundit të pensionimit e ka mirëmbajtur dhe menaxhuar dhe ishte një përkujdesës "per excellent" i xhamisë në mirëmbajtjen e saj, pastrimin, rregullimin e oborrit dhe gjelbërimit të tij.

Krahas kësaj ka mbajtur edhe mësim-besimin që nga ditët e para të punësimit të tij me fëmijë dhe të rriturit në xhami, ku dhe u siguronte doracakët e mësimi falas, ashtu që

do të mbetet në kujtim të veçantë të gjeneratat e hershme, si të fëmijëve po ashtu edhe të rriturve, përgjatë viteve të nëntëdhjeta të shekullit të kaluar që kanë ndjekur mësim-besimin, përveç të tjerash edhe mësimin përmendsh të sures (kapitullit) Jasin të Kuranit famëlart.

Në fund po shënoj edhe këtë të dhënë se imami po ashtu ishte ai, i cili pati fatin dhe nderin që të jetë nga të parët që theu akullin dhe hapi rrugën në media pas luftës në qytetin tonë që nga themelimi i Radio BESA, ku me prezencën e tij ishte aktiv në emisionet e radios për çështje fetare, gjë që ka vazhduar pastaj edhe pas themelimit të TV BESA si televizion, ku nuk ka munguar me kontributin e tij në këtë drejtim. Po ashtu janë transmetuar edhe hytbet e tij të xhumasë rregullisht gjer në pensionimin e tij në këtë televizion. Meritë e gjithë kësaj pune natyrisht që është RADIO & TV BESA dhe pronari i saj, Muamer Fusha, i cili nuk kurseu ndihmën e tij në këtë drejtim të cilën edhe sot e kësaj dite e bënë me shumë dashuri.

Në fund të këtij përshkrimi si përfundim do të thosha se kjo është një biografi e shkurtër dhe këto janë disa aktivitetet e pakta të imamit nga shumë të tjera që nuk po i përmendim. Nuk më mbetet gjë tjetër përveç se për imamin e xhamisë së Bajraklisë, mulla Reshat ef. Mexhiti, t'i dëshiroj jetë të gjatë e shëndet! Amin!

Faik Miftari



Kaloi në botën e amshueshme imami veteran i Dukagjinit, mulla Smajl efendi Januzi

SHËRBEU SI IMAM MBI GJYSMË SHEKULLI NË FSHATRAT E DUSHKAJËS

PREJARDHJA FAMILJARE

Mulla Smajli lindi më 01.12.1935 në fshatin Radoniq, Komuna e Gjakovës, nga nëna Xhemilja dhe babai haxhi, mulla Ahmet efendi Januzi. Familja e tij kishte ardhur nga Krahina e Bytyqit, Malësia e Gjakovës. Ky fshat kishte edhe xhaminë e vet, e cila ishte ndërtuar në vitin 1666, por për shkak të vjetërsisë ishte rindërtuar.

Rindërtimi kishte zgjatur dy vjet, d.m.th., rindërtimi kishte përfunduar në vitin 1832. Xhamia në fjalë nuk kishte minare. Imami i kësaj xhamie kishte qenë mulla Januzi, i cili njëherësh kishte qenë edhe iniciator për ndërtimin e saj, ndërsa trualli ku ishte ndërtuar xhamia ishte pronë e familjes Cenaj të këtij fshati. Kjo familje, kryesisht e kishte ndihmuar ndërtimin e xhamisë. Familja, e cila sot jeton në Pejë, i posedon edhe tapitë (otomane) të xhamisë. Pas tij vjen i biri, mulla Hasan ef. Januzi, të cilin, bashkë me disa xhematli, në atë kohë i kishin arrestuar malazezët, me pretekst të posedimit të armëve. Pas torturave, mundimeve dhe rrahjeve i kanë sjell në Gjakovë dhe te fabrika e tjegullave – saktësisht te vendi i quajtur “Shllaku”, i kanë pushkatuar. Më pas vjen djali tjetër i tij, mulla Ahmet ef. Januzi, deri në vitin 1965. Pas tij vjen djali i tij, mulla Ismajl ef. Januzi.



Mulla Ahmeti ishte fëmija i katër i mulla Januzit, prej djemve, ku prej tyre njeri kishte qenë hoxhë. Haxhi, mulla Ahmet efendi Januzi, ishte burrë i urtë, i ditur, i ndritur, shumë i matur dhe me sjellje shembullore. Për këto cilësi, të gjithë e donin dhe e respektonin.

SHKOLLIMI

Mulla Smajli mësimet e para fetare i mori nga babai i tij, mulla Ahmeti, kurse katër vjet të shkollës fillore (në vitin 1950) i kreu në vendin e lindjes, në fshatin Radoniq, për të vazhduar më pastaj (në vitin 1954) edhe katër vite në Medresenë e Ultë “Alauddin” në Prishtinë, e pastaj edhe katër vite ka vazhduar vetëm lëndët fetare dhe gjuhë shqipe, dhe në vitin 1958 e merr ixhazetin – diplomën për imam. Kjo ishte gjenerata e parë pas Luftës së Dytë Botërore.

PUNËSIMI

Në vitin 1959 emërohet në punët dhe detyrat e imamit, hatibit (predikues) dhe mualimit (mësues), në fshatin Radoniq. Këtë detyrë vazhdoi ta kryejë deri në vitin 1985, kur xhamia mbyllet për shkak të ndërtimit të basenit artificial akumulues. Xhamia e Radoniqit ka përfshirë këto fshatra: Ratkoc, Palabardh dhe Zhdrellë. Xhamia dhe prona e saj janë eksproporuar nga ana e Kuvendit Komunal të Gjakovës,



Xhamia e fshatit Radoniq

prandaj u desh të gjendet një vend tjetër i përshtatshëm, për ndërtimin e xhamisë së re. Mjetet financiare që u dhanë në emër të eksproporimit të xhamisë së Radoniqit, që do të përmbytej, në bazë të vendimit të Këshillit të Bashkësisë Islame të Gjakovës dhe pëlqimit të xhematlive të territorit të kësaj xhamie, u vendos që xhamia e re të ndërtohet në fshatin Shqiponjë – ish Jabllanicë të Dushkajës.

Xhamia e re filloi të ndërtohet në vitin 1986 dhe ka përfunduar në vitin 1988. Kjo xhami ka përfshirë këto fshatra: Zhabel, Bardhaniq dhe Maznik. Pas inaugurimit të xhamisë së re në fshatin Jabllanicë, mulla Smajli vazhdoi punën si imam i rregullt. Pas luftës së fundit, mulla Smajli e kishte edhe fshatin Deve. Gjatë luftës 1998-99 kjo xhami ishte dëmtuar pjesërisht dhe është rinovuar nga një shoqatë amerikane. Pas renovimit është ndërtuar minarja prej themelit dhe janë shtuar tre kupola të vogla, është ndërtuar shatërvani, është hapur bunari dhe është instaluar ujësjellësi.

Në vitin 2000, sipas ligjit, mulla Smajli pensionohet, mirëpo hoxha edhe pas pensionit ka vazhduar ta kryejë detyrën e imamatit, deri në vitin 2015, ku për shkak të moshës tërhiqet përfundimisht nga detyra e imamatit, ku shërbeu më shumë se gjysmë shekulli.

Kur e shihje nga larg, të rrëmbente me pamjen e tij burrnore. Ajo çka e bënte madhështor këtë plak bujar dhe tejet pedant, ishte shpirti i tij fisnik dhe vullneti i tij për të respektuar dhe nderuar të gjitha moshat.

Mulla Smajli ishte një personalitet i jashtëzakonshëm. Kur e shihje nga larg, të rrëmbente me pamjen e tij burrnore. Ajo çka e bënte madhështor këtë plak bujar dhe tejet pedant, ishte shpirti i tij fisnik dhe vullneti i tij për të respektuar dhe nderuar të gjitha moshat. Ndoshta nuk kishte dije teorike të ekzagjeruar qysh sot kanë shumë nga të diplomuarit në universitetet e mëdha prestigjioze ndërkombëtare, por praktikën dhe shëmbëlltyrën e kishte pejgamberike – e cila s'merret me diplomë, por me rrësk nga Zoti i Gjithësisë.

Mulla Smajli ka qenë shëmbëlltyrë e një besimtari të vërtetë, myslimani të çiltër, burrit të madh, patrioti të patrembur.

Ai la pas vetës pesë fëmijë: djemtë Faikun, Fahriun, Feimin, Fehmiun dhe vajzën Fatimren. Ishte i përpiktë, korrekt dhe i sinqerte në punët dhe detyrat e imamatit, ndërsa i pa kompromis në çështjet fetare. Mulla Smajli ndërroi jetë në muajin e bekuar Ramazan, në dhjetënetëshin e fundit, pikërisht në natën e Fitër Bajramit, më 8 prill 2024.

Varrimi i tij është bërë në varrezat e fshatit Osek Hile. Në varrim morën pjesë stafi i imamëve të KBI-së në Gjakovë, në krye me kryetarin dr. Valon ef. Myrta, imamë nga komunat e tjera të Kosovës, si dhe një numër i madh i xhematlive nga Dushkaja dhe fshatrat e tjera të Dukagjinit, e më gjerë.

Namazin e xhenazes ia fali mulla Rasim efendi Bytyqi, nga Deçani, ish-kryetar i KBI-së në Deçan.

“O ti shpirt i bindur plotësisht! Kthehu te Zoti yt i vetëkënaqur e i pranuar (dhe Ai i kënaqur me ty.) Hyn në turmën e robërve të Mi! Dhe hyn në Xhenetin Tim!”

E lusim Allahun xh.sh. që hoxhën e nderuar ta marrë në rahmetin e Tij dhe ta shpërblejë me Xhenetin Firdevs! Amin!

Esat Rexha

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM ZËVENDËSMINISTRIN E KULTURËS DHE TURIZMIT TË TURQISË, Z. SERDAR ÇAM

Më 6 maj 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim zëvendësministrin e Kulturës dhe Turizmit të Republikës së Turqisë, z. Serdar Çam.

Fillimisht Myftiu Tërnavë i uroi mysafirit mirëseardhje në institucionin e Bashkësisë Islame të Kosovës, e më pas e njohu atë me aktivitetet dhe jetën fetare në Kosovë, e cila organizohet nga Bashkësia Islame e Kosovës. Gjatë këtij takimi, Myftiu Tërnavë, shfrytëzoi rastin që të falënderojë presidentin e Turqisë, Rexhep Taip Erdogan, DIJANET-in e Turqisë, si dhe Drejtorinë e Vakëfeve për ndihmat dhe përkrahjen e vazhdueshme që kanë pasur.

Myftiu Tërnavë tha se me Drejtorinë e Vakëfeve, Bashkësia Islame e Kosovës ka një bashkëpunim të shkëlqyer, ku vetëm deri më tani janë finalizuar 14



projekte dhe 10 të tjera janë afër që të startojnë.

Në anën tjetër, zëvendësministri i Kulturës dhe Turizmit në Turqi, z. Serdar Çam, falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen dhe bashkëpunimin e shkëlqyer që kanë. Ai tha se shteti turk dhe qeveria turke kanë një simpati të

veçantë për Prishtinën, duke premtuar kështu përkushtimin e tyre për thellim të bashkëpunimit.

Po ashtu, ai gjatë këtij takimi tha se ruajtja e trashëgimisë fetare është e rëndësishme dhe për këtë arsye shteti i Turqisë dhe Drejtoria e Vakëfeve, kësaj i kushton një rëndësi të veçantë.

MYFTIU TËRNAVA MORI PJESË NË SAMITIN KONUSLTATIV TË ULEMAVE MYSLIMANË NË STAMBOLL

Më 13 maj 2024, nën organizimin e DIJANET-it të Turqisë, në Stamboll, u mbajt Samiti konsultativ i ulemave islamë, në të cilin morën pjesë delegacione nga e mbarë bota.

Hapja e këtij Samiti u bë në Pallatin “Dolmabahçe” në Stamboll, me fjalën hapëse të presidentit të Turqisë, z. Rexhep Tajip Erdogan. Ai shprehu kënaqësinë e tij për pritjen e ulemave nga vendet e ndryshme të botës, duke thënë se e përgëzon Kryesinë e Çështjeve Fetare të Turqisë për organizimin e këtij takimi kaq të rëndësishëm. Z. Erdogan, shprehu mirënjohjen e tij për secilin pjesëmarrës dhe kontributet e tyre. Në fjalën e tij hapëse, ai foli edhe për gjendjen aktuale në botë, me theks të veçantë për gjendjen e rëndë në Gaza të Palestinës, duke ftuar kështu që të ndalet gjakderdhja sa më parë.



Pas tij, të pranishmit i përshëndeti kryetari i DIJANET-it, dr. Ali Erbash.

Ky Samit zgjati dy ditë, dhe në sesionin e dytë u paraqit edhe Myftiu Tërnavë me kumtesën e tij me titull:

“Ndërtimi i ndërgjegjes së ymetit përballë sfidave bashkëkohore”.

Myftiun Tërnavë në këtë Samit u shoqërua nga kryeimami Vedat ef. Sahiti dhe shefi i kabinetit të tij, Besim ef. Mehmeti.

MYFTIU TËRNAVA: “UNITETI, MJETI KRYESOR PËR KAPËRCIMIN E SFIDAVE”



Më 14 maj 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka paraqitur në Samitin konsultativ të ulemave myslimanë në Stamboll, kumtesën e tij me titull “Ndërtimi i ndërgjegjes së ymetit përballë sfidave bashkëkohore”.

Ai në fjalën e tij tha se, individët, komunitetet dhe vendet sot po përballen me sfida të ndryshme, të cilat po prekin të ardhmen e jetës së tyre, e ndonjëherë po kërcënojnë edhe gjithë ekzistencën e tyre. “Tejkalimi i sfidave të brendshme është porta e natyrshme për të kapërcyer sfidat e jashtme. Bota islame duhet të shërohet nga sëmundjet e saj të brendshme dhe t’i kapërcejë sfidat e brendshme, për të qenë në gjendje që ajo shoqëri t’i kapërcejë edhe sfidat e jashtme. Në veçanti, në vitet e fundit kemi qenë dëshmitarë të zhvillimit të frikshëm të fenomeneve të rrezikshme, si fanatizmi, ekstremizmi e radikalizmi, të cilat kanë tentuar që ta shkatërrojnë shoqërinë, shpeshherë edhe nën një slogan islamik dhe me thirrjet se “Zoti është më i Madhi”.

Myftiu Tërnavë nuk la pa përmendur edhe sfidat dhe vuajtjet që ka përjetuar populli shqiptar në shekullin e kaluar nga dhuna e padrejtësia mbi 100-vjeçare e Serbisë. “Unë vij nga një vend i cili ka përjetuar shumë sfida, dhunë e padrejtësi. Ata u munduan vazhdimisht, përmes presioneve të shumta e të llojllojshme, të na largojnë nga ndërgjegjja jonë, nga dinjiteti ynë fetar e kombëtar. Nga këto sfida e nga ky presion, vetëm në Turqi janë shpërngulur miliona shqiptarë, e sot numri i tyre arrin në mbi gjashtë milionë.”

Për të arritur zgjidhje për problemet dhe sfidat, të cilat kanë kapluar botën në përgjithësi, e ymetin islam në veçanti, Myftiu Tërnavë, përmendi se sot, si asnjëherë më parë, bota ka nevojë për bashkëpunim për t’i shmangur luftërat dhe gjakderdhjet. Ai tha se Zoti në ajetin e dytë të sures El Maide, porositi që të ndihmohemi mes vete në punë të mira e të mbara, e assesi në mëkate e armiqësi.

“Ymeti kërkon një unitet të fortë dhe një bashkëpunim solid ndërmjet vendeve e popujve të tij. Nuk ka dyshim se ky unitet është thelbësor për arritjen e rritjes, zhvillimit dhe prosperitetit të vërtetë për myslimanët. Unë e di se rruga drejt unitetit nuk është e shtruar me trëndafila, pasi që një nga sfidat më të rëndësishme me të cilat po përballlet shoqëria jonë islame është diversiteti kulturor dhe gjuhësor, që po konsiderohet si një sfidë për arritjen e këtij uniteti. Ndarjet etnike dhe sektare, gjithashtu konsiderohen sfidë e madhe për unitetin e shoqërisë islame. Por, ashtu siç porositë Allahu në Kuranin fisnik, me të tilla porosi e përmbylli edhe unë fjalimin tim, që të bashkohemi ndërmjet vete e të ndërgjegjësohemi me mësimet, vlerat dhe moralin e Islamit. “Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kuranin) dhe mos u përçani! Kujtoni dhuntitë e Allahut për ju, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja, e në saje të dhuntisë së Tij, ju u bëtë vëllezër.” (Ali Imran, 103).

FAKULTETI I STUDIMEVE ISLAME PROMOVOI PROGRAMIN E RI “AKADEMIA – STUDIME ISLAME DHE LIDERSHIP”

Më 2 maj 2024, Fakulteti i Studimeve Islame, promovoi programin e ri, “Akademia – Studime Islame dhe Lidship”. Akademia synon të trajnojë imamët dhe predikuesit fetarë që kthehen pas studimeve nga vende të ndryshme. Ky program do të jetë në shërbim të të gjithë të diplomuarve jashtë vendit që njohuritë e tyre duan t’i shpërndajnë në Kosovë.

Në hapje të këtij programi mori pjesë edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë.

“Kjo Akademi synon përhapjen e frymës tolerante, frymës së dialogut e paqes, duke luftuar mendjet e mbyllura intelektuale dhe të gjitha manifestimet diskriminuese mes njerëzve. Ajo promovon mendimin e moderuar dhe mesatar që urdhëron feja islame, duke mishëruar kështu përkushtimin e besimtarëve islam “për fe e atdhe”, dhe duke sjellë gjithëherë në mendje si burim frymëzimi rrënjësorjen e frymës evropiane në mesin e shoqërisë sonë. Ajo sjellë në pah të gjithë besimtarët se Islami është një besim, i cili pajtohet me zhvillimet e reja të qytetërimit shqiptar dhe i mbështet ato pa



mëdyshje, si rrugë të drejtë për t’u bërë pjesë thelbësore jo vetëm e së djeshmes, por edhe e së sotmes, dhe e së ardhmes së kombit tonë”, tha Myftiu Tërnavë.

Dekani i FSI-së, dr. Islam Hasani, tha se qëllimi i programit është t’i ndihmojë të diplomuarit me sistemin arsimor në Kosovë.

“Është një program njëvjeçar për të diplomuarit dhe të tjerë të interesuar. Përmes këtij programi të diplomuarit jashtë vendit do të informohen për sistemin arsimor në Kosovë dhe sistemin e Bashkësisë Islame të Kosovës”, tha ndër të tjera dekani Hasani.

Drejtori i Agjencisë së Akreditimit të Kosovës, z. Naim Gashi, u shpreh i lumtur me bashkëpunimin me FSI-në, teksa tha se po punojnë së bashku edhe në programe të tjera.

“Ne si shoqëri dhe si shtet krenohemi me vlerat tona kombëtare, fetare dhe ato institucionale, prandaj kemi qëllim që këto cilësi t’i ndajmë edhe më të tjerët. Fakulteti i Studimeve Islame e ka pasur përkrahjen e plotë dhe do ta ketë edhe në vijim. Gjithashtu, jemi duke diskutuar për zgjerimin e gamës së programeve të FSI-së”, tha ndër të tjera z. Gashi.

U PËRURUA RESTAURIMI I XHAMISË “ALAUDIN” NË PRISHTINË

Më 13 maj 2024, nën organizimin e DIJANET-it të Turqisë, në Stamboll, u mbajt Samiti konsultativ i ulemave islamë, në të cilin morën pjesë delegacione nga e mbarë bota.

Hapja e këtij Samiti u bë në Pallatin “Dolmabahçe” në Stamboll, me fjalën hapëse të presidentit të Turqisë, z. Rexhep Tajip Erdogan. Ai shprehu kënaqësinë e tij për pritjen e ulemave nga vendet e ndryshme të botës, duke thënë se e përgëzon Kryesinë e Çështjeve Fetare të Turqisë për organizimin e këtij takimi kaq të rëndësishëm. Z. Erdogan, shprehu mirënjohjen e tij për secilin pjesëmarrës dhe kontributet e tyre. Në fjalën e tij hapëse, ai foli edhe për gjendjen aktuale në botë, me theks të veçantë për gjendjen e rëndë në Gaza të Palestinës,



duke ftuar kështu që të ndalet gjakderdhja sa më parë.

Pas tij, të pranishmit i përshëndeti kryetari i DIJANET-it, dr. Ali Erbash.

Ky Samit zgjati dy ditë, dhe në sesionin e dytë u paraqit edhe Myftiu

Tërnavë me kumtesën e tij me titull: “Ndërtimi i ndërgjegjes së ymetit përballë sfidave bashkëkohore”.

Myftiun Tërnavë në këtë Samit u shoqërua nga kryeimami Vedat ef. Sahiti dhe shefi i kabinetit të tij, Besim ef. Mehmeti.

KRYESISË SË XHAMISË “BALKAN” – MINHEN, GJERMANI TELEGRAM NGUSHËLLIMI

“Të Allahut jemi dhe tek Ai do të kthehemi!”

Me dhimbje të thellë morëm lajmin për kalimin në Ahiret të hoxhës, dijetarit, aktivistit të madh të mërgatës tonë në Minhen të Gjermanisë, h. Jakup ef. Muhamedit, Allahu e mëshiroftë!

Me këtë rast na lejoni që në emër të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, organeve dhe institucioneve të saj, t'i shprehim ngushëllimet tona më të sinqerta familjes Muhamedi, Kryesisë së xhamisë dhe xhematit të Qendrës

Shqiptare “Balkan” në Minhen të Gjermanisë.

Lusim Allahun e Plotfuqishëm që rahmetliun ta shpërblejë me të mirat e Tij të pakufishme në Xhenet, ndërsa familjes, miqve dhe farefisit të tij t'i falë durim.

Me respekt,

Kryetari

Myftiu, Naim ef. Tërnavë



MINISTRI I MINISTRISË SË HAXHIT DHE UMRES SË ARABISË SAUDITE, TEUFIK BIN FEUZAN BIN REBIAH I KA DËRGUAR NJË LETËR MYFTIUT TËRNAVA

Ministri i Ministrisë së Haxhit dhe Umres së Arabisë Saudite, Teufik bin Feuzan bin Rebiah, i ka dërguar një letër kryetarit të Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiut Naim ef. Tërnavë, nëpërmes së cilës njofton gjithë besimtarët myslimanë të Kosovës, se organizimi i shkuarjes në haxh i takon vetëm institucionit zyrtar në Kosovë, pra Bashkësisë Islame të Kosovës.

Në këtë letër thuhet se Këshilli i Lartë i Dijetarëve të Mbretërisë së Arabisë Saudite, ka nxjerrë një fetva drejtuar të gjithë myslimanëve për ndalesën e kryerjes së haxhit pa leje, kjo me qëllim të realizimit të objektivave të së mirës së përgjithshme dhe të mos dëmtimit të haxhilerëve të rregullt.

Ai ka njoftuar se në rast të mos zbatimit të kësaj fetvaje, do të ketë pasoja me gjobë për të gjithë ata që tentojnë të kryejnë haxhin pa leje, si dhe ndalim të hyrjes në Mbretërinë e Arabisë Saudite për një afat të pacaktuar.



TELEGRAM FALËNDERIMI NGA EMIRI I SHTETIT TË KATARIT, TAMIM BIN HAMAD AL THANI

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, përmes Ambasadës së Katarit në Shqipëri, ka pranuar një telegram falënderimi për urimin me rastin e festës së Fitër Bajramit nga emiri i shtetit të Katarit, Tamim bin Hamad al Thani.

Emiri i Katarit me këtë rast ka përcjellë urimet më të sinqerta për Bashkësinë Islame të Kosovës dhe për Myftiun Naim ef. Tërnavë me rastin e kësaj feste.

Në këtë telegram urimi ndër të tjera thuhet: “Duke lutur Zotin e Plotfuqishëm ta kthejë këtë festë për të gjithë, me begati dhe mirësi të shumta, duke i dëshiruar vendit tuaj mik vazhdimësi të zhvillimit dhe prosperitetit.”

Po ashtu në këtë mesazh është bashkangjitur edhe telegram urimi nga emiri i shtetit të Katarit, Tamim bin Hamad al Thani.



KRYESIA E BASHKËSISË ISLAME MBAJTI MBLEDHJEN E RREGULLT TË SAJ

Më 23 maj 2024, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, ka mbajtur mbledhjen e saj të rregullt, të cilën e hapi dhe e kryesoi kryetari i saj, Myftiu Naim ef. Tërnavë.

Në këtë mbledhje u diskutua për raportin mbi aktivitetet e muajit Ramazan, ku edhe u prezantua një raport i detajuar i këtyre aktiviteteve. Më pas u diskutua edhe për raportin me të hyrat nga zekati dhe sadakatul-fitri.

Po ashtu gjatë kësaj mbledhje në rend të ditës që edhe përgatitja për Haxhin 2024, e që tashmë përgatitjet për organizimin e tij janë në fazën finale.

Në fund, Kryesia diskutoi edhe çështje të ndryshme dhe mori vendime në bazë të kompetencave të cilat i takojnë kësaj Kryesie.



U MBAJT CEREMONIA E ABSOLVENTIADËS SË GJENERATËS SË 29-TË TË FSI-SË

Më 30 maj 2024, në ambientet e Fakultetit të Studimeve Islame u mbajt ceremonia e absolventiadës për 20 studentë, të gjeneratës së 29-të.

Në këtë ceremoni, përveç studentëve dhe profesorëve të FSI-së, pjesëmarrës ishte edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë me bashkëpunëtorë.

Djem dhe vajza që studiojnë për katër vjet me radhë përmbyllën sot ciklin e studimeve në FSI.

Ceremonia e absolventiadës filloi me recitim të Kuranit për të shënuar më pas një prej momenteve më të bukura për studentët. Studentët e diplomuar u shprehën jashtëzakonisht të nderuar që kishin fatin të studionin në këtë fakultet.

Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë u shpreh i lumtur me suksesin e

studentëve të FSI-së. Ai shtoi se këta studentë janë të pajisur me dije që do t'i japin shkëlqim trojeve shqiptare me Islam.

Dekani i Fakultetit të Studimeve Islame, Islam ef. Hasani tha se që nga themelimi i fakultetit, FSI nxjerr studentë që edukojnë gjenerata të tëra në frymën islame.

Kjo ishte gjenerata e 29-të që diplomuan në këtë fakultet.



KANË FILLUAR PËRGATITJET PËR NISJEN E BESIMTARËVE TANË PËR NË HAXH

Këshillat e Bashkësisë Islame anekënd Kosovës kanë filluar përgatitjet për nisjen e besimtarëve tanë për në haxh. Në të gjithë Këshillat e BI-së, nga përgjegjësit e këtyre Këshillave, besimtarët myslimanë, që këtë vit kanë vendosur ta kryejnë haxhin, janë duke i marrë edhe këshillat dhe mësimet e duhura se si duhet të kryet ky ritual.

Me udhëzimet për durim, forcë dhe sakrificë, ata janë duke u përgatitur për ta kryer edhe kushtin e pestë të Islamit – haxhin. Karshi mësimëve dhe këshillave, në të gjithë Këshillat e BI-së është duke u organizuar edhe dua ja e haxhit, në të cilën besimtarët lusin të Madhin Zot që t'u japë shëndet e t'ua pranojë adhurimet e haxhit.

Këtë vit nga Kosova për ta kryer haxhin do të udhëtojnë 1576 besimtarë, ndërsa grupi i parë i besimtarëve parashihet që të udhëtojë më 2 qershor 2024.



DREJTORI SIMNICA TAKOI NËNKRYETARIN E XHAMISË “MESXHID NUR” NË FRAUENFELD TË ZVICRËS, Z. XHABIR SHALA

Më 10 maj 2024, drejtori i Diasporës në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, ka pritur në takim nënkryetarin e xhamisë “Mesxhid Nur” në Frauenfeld të Zvicrës, z. Xhabir Shala.

Drejtori Simnica e falënderoi z. Shala dhe nëpërmes tij tërë mërgatën tonë shqiptare që gjendet në diasporë për kontributin e tyre dhënë për mirëqenien dhe jetën e përgjithshme fetare të shqiptarëve atje. Ai shprehu gatishmërinë e tij, por edhe të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës që bashkëpunimi i mirë që ka mbretëruar deri më tani, ndërmjet BIK-ut dhe diasporës të vazhdojë edhe më tutje.

Ndërkaq, z. Shala, falënderoi drejtorin Simnica për pritjen dhe për gatishmërinë e institucionit të



Bashkësisë Islame të Kosovës, që të vazhdojë bashkëpunimi i mirë që kanë me qendrat islame në diasporë. Ai gjatë kësaj vizite, dorëzoi edhe një sasi të

vitrave të tubuara gjatë muajit Ramazan nga mërgata jonë.

DREJTORI I DIASPORËS, EKREM EF. SIMNICA KA PRITUR NË TAKIM KRYETARIN E QKMSH-SË “HAXHI ZEKA” NË BELGJIKË, Z. MUSA MULAJN

Më 14 maj 2024, drejtori i Diasporës në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, ka pritur në takim kryetarin e Qendrës Kulturore Myslimane Shqiptare “Haxhi Zeka” në Namur – Belgjikë, z. Musa Mulajn.


Drejtori Simnica falënderoi z. Mulajn dhe nëpërmes tij tërë mërgatën tonë shqiptare që gjendet në diasporë për kontributin e tyre dhënë për mirëqenien dhe jetën e përgjithshme fetare të shqiptarëve atje. Ai falënderoi në veçanti z. Mulajn për kontributin e tij, në lidhje me përgatitjen për fillimin e ndërtimit të qendrës (xhamisë) së re në Namur, si dhe shprehu gatishmërinë e tij, por edhe të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës që bashkëpunimi i mirë që ka mbretëruar deri më tani, ndërmjet BIK-ut dhe diasporës të vazhdojë edhe më tutje.



Ndërkaq, z. Mulaj, falënderoi drejtorin Simnica për pritjen dhe për gatishmërinë e institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës, që të vazhdojë bashkëpunimi i mirë që kanë

me qendrat islame në diasporë. Ai gjatë kësaj vizite, dorëzoi edhe një sasi të vitrave të tubuara gjatë muajit Ramazan nga mërgata jonë.

RITET E HAXHIT TEMETUË





TREGIMET E KAFSHËVE NË KURAN | Ahmed Behxhet

Përktheu dhe përshtati nga arabishtja: Enes Koshi

Botues: Kryesia e Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës”, Shtëpia botuese: “Dituria Islame”

Për botuesin: Mr. Naim Tërnavë, Recensent: Muhamed Sytari, Lektor dhe korrektor: Dr. Irida Hoti

Redaktor letrar: Besnik Jaha, Ilustrimet: Ihab Shakir, Redaktor teknik & dizajni: Bashkim Mehani

DITURIA ISLAME • Nr. 403 QERSHOR 2024